


AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRIË
INSTITUTI I HISTORISË

THEOFAN POPA

**MBISHKRIMJE
TE KISHIAVE
NE SHQIPËRI**

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κονιτσας





Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

AKADEMIA E SHKENCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

• ΣΥΛΛΟΓΗ •
ΕΥΑΓΓΕΛΟΥ ΠΡΙΩΝΗ
ΔΩΡΕΑ ΑΠΟ ΤΟ ΣΥΛΛΟΓΟ
ΚΑΣΤΑΝΙΑΝΗΣ ΠΩΓΩΝΙΟΥ

THEOFAN POQA



MBISHKRIME TË KISHAVE
TË SHQIPËRISË

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

ΕΠΙΓΡΑΦΕΣ ΕΚΚΛΗΣΙΑΣΤΙΚΩΝ
ΣΤΗΝ ΑΛΒΑΝΙΑ

06 261,7661

Σωτηρία - Σεμηνή εν Σοφισ

TIRANË, 1998

Redaktorë:

Nestor Nepravishta
Kostandin Gjakumis

Menaxhimi dhe koncepti artistik:

Artion Baboçi

- Për shtypin e këtij vëllimi ka dhënë ndihmesë
Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Fondacioni SOROS)

Përgatiti për shtyp: Dega e Botimeve e Akademisë së Shkencave të RSH

Radhimi kompiuterik: Nermin Tola

© Copyright – 1999: Akademia e Shkencave e RSH.

Çdo riprodhim i plotë ose i pjesshëm i kësaj vepre është i ndaluar.

CIP – Katalogizimi në botim – B.K.Tiranë

Popa, Theofan

Mbishkrime të kishave në Shqipëri / Theofan Popa; Red. N. Nepravishta, K. Gjakumis

– T.: Shkenca, 1999, 355 f.: me il.; 18.6 x 26 cm. – (Akad. e Shkencave e RSH. Inst. i Historisë)

Bibl. - Indeks - ISBN 99927 - 600 - 8 - 7

1. Mbishkrimet – Shqipëri 2. Arti kristian dhe simbolet – Shqipëri – Historia

930.271 (496.5) : 726.5 +

726.5.024.4 (496.5) : 930.271



Parathënie

Burimet dokumentare të historisë sonë mijëvjeçare, të traditave të lashta të popullit tonë, janë relativisht të pakta në numër e me zbrazëti, sidomos përsa u përket disa periodave të caktuara të historisë. Kjo sikurse dihet, është rrjedhim i rrethanave historike të veçanta e shpesh herë të vështira, në të cilat është ndodhur vendi ynë gjatë shekujve. Për këtë arsye zbulimi, mbledhja e studimi i burimeve dokumentare ekzistuese historike fiton një rëndësi të veçantë për vendin tonë.

Ndër burimet dokumentare historike numërohen edhe materialet e ndryshme epigrafike, për të dhënat që ato ruajnë që prej epokave historike më të lashta.

Në vendin tonë ruhen mjaft materiale epigrafike. Më të herëshmet janë ato të qendrave antike si Durrës (Dyrahium), Pojan i Fierit (Apoloni), Butrint (Buthrotos) etj., si edhe në monumente mesjetare. Për arsye historike të caktuara dhe për pozitën e veçantë të Kishës, pjesa më e madhe e mbishkrimeve mesjetare të vendit tonë është e lidhur me Kishën e krishterë dhe ruhet ndër institucionet fetare të kësaj Kise (tempuj, manastire, shpella eremite dhe objekte të ndryshme të përdorimit kishtar). Përsa u përket materialeve epigrafike në gjuhët osmane¹ e nganjëherë në gjuhët arabe e persiane, këto i përkasin kohës së okupacionit osman dhe në përgjithësi kanë një origjinë jo më të hershme se shek. XVI.

Materiali epigrafik kishtar në vendin tonë, që, me siguri duhet të ketë qenë më i pasur gjatë shekujve më të hershëm, ka ardhur dalngadalë duke u dëmtuar e duke u pakësuar në numër. Kanë influencuar gjatë shekujve, luftat e shpeshta, invadimet e huaja etj. Nga këto rrethana të vështira janë zhdukur përgjithmonë edhe monumente të tëra me rëndësi historike, dokumente që takohen edhe sot në vendin tonë në formë rrënimesh.

Pa dyshim, në dëmtimin e materialit epigrafik kishtar kanë influencuar edhe pakujdesia e njerëzve e mungesa e rezistencës së materialeve të ndërtimit ose të pikturimit. Në shumë raste mbishkrimet janë mbuluar me suva, janë lyer me gëlqere ose është pikturuar rishtaz sipër tyre.

Botimet rreth materialeve epigrafike kishtarë të vendit tonë në përgjithësi janë të pakta dhe në pjesën më të madhe i përkasin shekullit të kaluar.

Të parët që u interesuan për këtë lloj materiali dhe kuptuan rëndësinë e tij për historinë e vendit qenë vetë shqiptarët. Kështu p. sh. Pjetër Bogdani nga fundi i shek. XVII kopjoi mbishkrimet e Kishës së Shirgjit pranë Shkodrës¹. Elbasanasit, duke botuar më 1690 Akolluthinë e Shën Gjon Vladimirit, botuan edhe mbishkrimin e madh të Karl Topisë, që ndodhet në Manastirin omonim pranë Elbasanit, në të cilin bëhet fjalë për rindërtimin e kishës nga princi shqiptar i lartpërmendur (30 f. e fund).

Në kohën tonë kanë botuar materiale epigrafike kishtarë të vendit H. Karmici nga Korça {19}, K. Skënderi nga Opari {54}, N. D. Naçi nga Korça {26}, E. Kurilla nga Devolli {22}, I. M. Qafzezi nga Korça {50} etj.

¹ A. Theiner. Relatio de statu ecclesiae in Albania et Serbia vetera, në të cilin i raportohet Vatikanit, nga një klerik i lartë i Serbisë e i Shqipërisë, bashkë me gjendjen e popullsisë së krishterë edhe për dy mbishkrimet e Kishës së Shirgjit të Shkodrës, duhet të jetë shkrojtur nga Pjetër Bogdani (59).

Ndër autorët e huaj që janë marrë me mbishkrimet e kishave tona numërohen emra si I. G. Hahn, A. Aleksudhi, S. Novakoviç, C. Patsch, C. Praschniker etj. Një kontribut të veçantë kanë dhënë Th. Ippen {17}, me botimin "Mbishkrime të kishave e të gërmadhave kishtare të Shqipërisë së Veriut" me komente dhe të dhëna nga historia e vendit tonë dhe P. I. Pulica {48} me botimin e 175 mbishkrimeve të kishave të rrethit të Gjirokastrës, Përmetit e Delvinës të mbledhura gjatë vitit 1915. Një punë sistematike dhe në shkallë të gjerë për zbulimin, regjistrimin dhe studimin e materialeve epigrafike ka filluar nga Instituti i Historisë pas çlirimit të vendit nga nazifashistët.

Në vëllimin që po paraqesim përfshihen, pothuajse të gjitha mbishkrimet që u përkasin institucioneve fetare të kultit të krishterë, që gjenden brenda kufijve politikë të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe mbishkrimet e botuara nga autorë të tjerë, vendas ose të huaj. Mendojmë se këto mbishkrime, rreth 1000, paraqesin pak a shumë të gjithë materialin epigrafik, nga institucionet e kultit të krishterë (kisha, manastire, shpella eremite dhe varre që gjenden brenda kishave ose nartekseve kishtare).

Materiali epigrafik që paraqitet në këtë vëllim është sistemuar në gjashtë pjesë, që u përkasin gjashtë juridiksioneve metropolitane të rëndësishme të vendit tonë gjatë shekujve të mesjetës, dmth. zonës së Durrësit, Beratit, Korçës, Gjirokastrës, Delvinë-Himarës dhe asaj të Shkodrës.

Për çdo zonë mbishkrimet ndjekin rendin kronologjik, por numërimi i mbishkrimeve vazhdon progresin në të gjithë vëllimin, pa dallim zonash. Mbishkrimet pa datë, në përgjithësi, janë renditur në fund të materialit epigrafik të zonës së cilës i përkasin, me përjashtim të rasteve, kur dihet me siguri periudha historike, së cilës mbishkrimi i përket, siç janë p. sh. mbishkrimet e piktor Onufrit në kishat e Shpatit të Elbasanit.

Një sasi e madhe mbishkrimesh jepen të fotografuara, të transliteruara (kur fotografia nuk është fort e qartë ose mungon), të transkriptuara e të përkthyer. Për çdo mbishkrim jepen shënime rreth vendit ku ndodhet, paraqitjes e rreth çdo rrethane që ka të bëjë me mbishkrimin. Për përcaktimin e kohës janë pasur parasysh burimet bibliografike dhe të dhënat nga gojëdhënat e vendit. Në vëllim paraqiten edhe disa mbishkrime, të pakta në numër, që janë grumbulluar e botuar nga të tjerë, por që sot nuk ekzistojnë më.

Trupi themelor i vëllimit është shoqëruar me tri indekse plotësuese, me indeksin kronologjik, me indeksin toponomastik dhe me atë të emrave të njerëzve.

Citimet e burimeve bibliografike të shfrytëzuara janë bërë në kllapa katrore dhe vetë burimet janë grumbulluar simbas rendit alfabetik në një listë të vetme në fund të veprës.

Me këtë rast falenderoj prof. A. Budën për ndihmën e madhe që dha në përgatitjen e vëllimit. Falenderoj gjithashtu Dh. Bedulin e K. Bozhori për vërejtjet e vlefshme që bënë sidomos për subtenimin e transteribimit dhe përkthimit shqip të teksteve të mbishkrimeve nga gjuha greke. Shpreh gjithashtu falenderimet e mia edhe fotografëve {M. Kallfa}, H. Gjiriti dhe N. Çurçiali për fotografitë që përfshihen në këtë vëllim.

Th. Popa

H y r j e

Mbishkrimet e kishave të vendit tonë në përgjithësi janë tekste të shkurtra me të dhëna rreth ndërtimit, rindërtimit, rreth pikturimit ose ripikturimit të kishave, rreth ktitorëve, piktorëve e mjeshtëreve të ndërtimit të këtyre kishave, rreth klerikëve ose laikëve, vendas ose të huaj, që kanë administruar në kohë të ndryshme institucionet fetare kristiane të vendit, ose kanë luajtur një rol të dalluar në sundimin e vendit, rreth pronarëve të objekteve mbi të cilët ato mbishkrime gjenden. Ka mbishkrime që japin të dhëna mbi ngjarje historike me karakter lokal ose më të përgjithshëm, që shënojnë ndonjë gojëdhënë të vendit me karakter fetar ose laik, që verifikojnë ndonjë datë ose ndonjë fakt më të lashtë. Shumë mbishkrime të tjera janë epitafe, janë tekste biblike ose liturgjike, nganjëherë të modifikuara janë lutje të formuluar nga ktitori ose piktori. Ka edhe mbishkrime më të shkurtra, që përfaqësohen vetëm nga një datë, që i referohet kohës së ndërtimit ose të pikturimit të kishës, kohës së pikturimit të ndonjë ikone, kohës së gdhendjes së ndonjë ikonostasi, kohës së derdhjes së ndonjë këmbane dhe ka mbishkrime që përfaqësohen vetëm nga një nënshkrim, që i përket piktorit, argjendarit, drugdhëndësit, gurëgdhëndësit etj.

Mbishkrimet me të dhëna rreth ndërtimit ose pikturimit të kishave, rreth ktitorëve ose piktorëve, që në përgjithësi janë edhe mbishkrimet kryesore të çdo kishe, zakonisht gjenden mbi portat perëndimore të pjesës qendrore të kishës që quhet anie (naos) ose të pjesës perëndimore të kishës (narteks), brenda ose jashtë tyre. Ka raste që ndodhen edhe mbi portat jugore ose veriore të naoseve, nganjëherë edhe mbi faqen e murit perëndimor të naosit, djathtas ose majtas portës. Shpesh takohen mbishkrime edhe në kungë, mbi faqen e murit lindor, përmbi vendin ku përgatitet mesha (prothes) ose brenda në të, mbi faqen e murit verior, gjithashtu pranë pothesit. Qëllimi i vendosjes së mbishkrimit këtu ishte që meshtari, sa herë kryente shërbesën e përgatitjes së meshës (proskomidhinë), të kujtohej të përmendte edhe emrin e piktorit.

Mbishkrimet që përmendin dhurata objektivsh kundrejt kishës e emra dhuruesish, zakonisht përmbajnë pak të dhëna e ndodhen mbi objektet e dhuruara, siç janë objekte argjendi të kultit kristian, mbi kapakë ungjijsh, bazamente kryqesh, potirësh ose enë temiani (thimiatonë), mbi doreza eksapergash, mbi kuti lipsanash ose enë kungate (artoforë). Ka mjaft mbishkrime të qendisura anëve të epitafëve (pëlhurë me Krishtin e qendisur ose të pikturuar të vdekur) ose amfiave jerarhike, (rrobeve priftërore), që përdoren për meshim, rreth kalimave (pëlhurave që mbulojnë kungatën) ose të stampuara rreth antiminsave, (pëlhurë e stampuar me Krishtin të vdekur etj.).

Pjesa më e madhe e mbishkrimeve të kishave tona gjenden mbi materiale të konsumueshme, siç është suvaja e thjeshtë gëlqerore e pikturave e janë të shkruara, në fillim, me ngjyrë të bardhë mbi sfond të zi e, në shekujt e mëvonshëm, me ngjyrë të zezë mbi sfond të bardhë ose të çelët. Por ka edhe mbishkrime që takohen të gdhendura mbi materiale të forta, mbi pllaka guri, mbi pllaka bronzi, mbi metale të ndryshme, kryesisht mbi argjend ose bronz, mbi dru. Mbishkrime të tjera janë të qendisura mbi pëlhurë ose të ndërtuara prej mozaikësh me copa të vogla tullash ose tjegullash të futura në mur.

Mbishkrimet e kishave mesjetare të vendit tonë janë në radhë të parë në gjuhët greke e latine.

Sikurse dihet, Shqipëria u përfshi qysh me ndarjen e Perandorisë Romake, në kuadrin e Perandorisë Bizantine. Ky fakt ushtroi një influencë të thellë jo vetëm mbi ngjarjet e historisë politike, por edhe mbi tiparet e strukturës ekonomike e shoqërore të vendit, mbi kulturën e tij. Krerët feudalë shqiptarë, midis tyre edhe klerikët, u rritën në kuadrin e klasës sunduese bizantine duke marrë prej saj jo vetëm titujt, por edhe mënyrën e jetesës, format e jashtme të organizimit shtetëror e kishtar. Kisha e krishterë në Shqipëri në pjesën më të madhe i nënshtrohej ritit lindor. Nëpërmjet kësaj kishe, bashkë me gjuhën greke, që u bë gjuha e kulturës, u shtri edhe ndikimi i letërsisë agjiografike, i arkitekturës dhe pikturës, që kishin një qendër të madhe e të rëndësishme Kostandinopojën.

Gjatë shekujve XIII e XIV vendi ynë, si edhe viset e tjera të Ballkanit, njohu një zhvillim të hovshëm të fuqive të veta ekonomike e shoqërore, me fuqizimin e klasës sunduese vendase, me rritjen e fuqizimin e qyteteve etj. Rrjedhim i këtij zhvillimi të gjithanshëm qe krijimi i principatave feudale shqiptare të pavarura ndonëse në një varg fushash ndikimi i shembullit bizantin vazhdonte të ishte i fuqishëm. Zhvillimi i gjithanshëm i vendit gjatë kësaj epoke dokumentohet edhe me një varg monumentesh arkitektonike e pikturash me vlef të rrallë që ruhen deri në ditët tona.

Edhe në këtë epokë historike interesante, ku vërehet fuqizimi në fusha të ndryshme i qendrave krahinore kundrejt autoritetit politik kulturor fetar të Bizantit, gjuha shqipe nuk qe ende në gjendje të zëvendësonte gjuhën greke të kishës. Por s'ka dyshim që kësaj gjuha jonë do t'ia kishte arritur, sikurse ndodhi edhe me gjuhë të tjera të disa popujve të nënshtroar Perandorisë Bizantine, po të mos e kishte ndërprerë zhvillimin katastrofa e madhe e pushtimit otoman të vendit. Në këto rrethana gjuha greke në Kishën Ortodokse e ruajti, bile e përforcoi pozitën e vet. Kjo është arsyeja e mbizotërimit të gjuhës greke në kishën ortodokse të vendit tonë deri në fillim të këtij shekulli, kur u krijua Kisha Autoqefale shqiptare.

Mbishkrimet në gjuhë latine, në përgjithësi të pakta, sepse më e kufizuar qe edhe zona e shtrirjes së Kishës katolike në Shqipëri, gjenden nëpër kishat e veriut të vendit.

Përsa u përket mbishkrimeve në gjuhën sllave, është interesant se në kishat e vendit tonë ruhen vetëm tri mbishkrime të tilla, nga të cilat p. sh. njëri në Kishën e Shën Mitrit në Bezmisht të Prespës dhe një tjetër mbi portën e Kishës së Manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, megjithëqë bullgarët dhe serbët, sikurse dihet, kanë sunduar në periudha historikisht të gjata në disa krahinat e vendit tonë dhe nuk ka munguar edhe veprimtaria e misionarizmit fetar-arsimor me gjuhën kishtarë sllave si në Devoll-Selasfor (Zvezdë) e në Glavenicë (Ballsh). Përsa u përket mbishkrimeve në gjuhën shqipe, deri më sot është takuar vetëm një i tillë me alfabet grek, mbi një ikonë të shën Mërisë së Manastirit të Ardenicës të gravuar në bronz (mb. 111). Shënojmë se në disa mbishkrime greqisht takohen edhe emra ose fjalë shqip, ose të shkruara ashtu si shqiptohen në gjuhën shqipe.

Në mbishkrimet e kishave tona vitet paraqiten simbas kronologjisë së ashtuquajtur prej "krijimit të botës"² ose simbas kronologjisë së ashtuquajtur prej "lindjes së Krishtit"³.

Me datë që prej krijimit të botës ndër mbishkrimet tona kemi ato më të vjetrit e deri në shek. XVIII, të gjitha në gjuhën greke, ndërsa me datë që prej lindjes së Krishtit⁴ kemi në përgjithësi mbishkrimet në gjuhën latine. Kronologjinë prej lindjes së Krishtit e takojmë edhe në mjaft mbishkrime në gjuhë greke të kishave ortodokse, duke filluar nga viti 1591 (mb. 95).

2 Kjo kronologji e përdorur në Kishën ortodokse

3 Kjo llogaritje e viteve është marrë

4 Anno Domini (viti i Zotit).

Në mbishkrimet greqisht datat figurojnë me gërma greke, kurse në mbishkrimet latinisht me shifra romake. Shifrat arabe shfaqen vonë në mbishkrimet e kishave tona, në fillim bashkë me shifrat greke (vështro mb. 567 të vitit 1666) dhe më vonë vetëm.

Viti që prej lindjes së Krishtit nganjëherë në mbishkrimet është përdorur edhe simbas mënyrës veneciane (more Veneto), simbas së cilës fillimi i vitit konsiderohej një marsi (mb. 2).

Disa mbishkrime përmbajnë edhe ciklin e diellit e të hënës për verifikimin e datave të tyre (mb. 2, 13, 522 etj).

Takohen edhe mbishkrime me data shumë të vjetra, por të shkruar me shifra arabe dhe me kronologji prej lindjes së Krishtit mbi portat ose mbi muret e kishave (mb. 517, 518 të Kishës së Shën Mërisë në Labovë të Kryqit, me datë 525, mb. 519 i Kishës së Shën Mërisë në Peshkopi të Sipërme me datë 619 etj.). Mendojmë se këto data duhet të jenë shkruar vonë, në bazë të traditës, sigurisht për të regjistruar ose përjetësuar ndonjë gojëdhënë të vjetër rreth kishës, së cilës i përkasin, ose të ndonjë kishe më të parë, mbi themelet e së cilës është ndërtuar kisha e re.

Lidhur me anën paleografike të mbishkrimeve, në radhë të parë shënojmë se pjesa më e madhe e tyre është shkruar me gërma të mëdha, megjithëqë ka edhe disa me gërma të vogla, siç është rasti i piktor Nikollës në Shën Mërinë Vlaherna të Beratit (mb. 93), dhe një pakicë me gërma të përziera, siç është ai i Onufër Kipriotit në Shën Kollë të Beratit (mb. 96). Mbishkrimi i kampanës së Manastirit të Shën Mërisë së Krorzit në veri të Sarandës (mb. 865) paraqitet si një përzierje gërmash greke e latine, ndërsa mbishkrimet sllavishte (mb. 4) paraqiten të shkruara me gërma cirilike.

Karakteristike për grafinë tek mbishkrimet e kishave tona është shkrimi i vijueshëm, pa ndarje fjalësh, si në tekstet e kodikëve të vjetër në gjuhën greke në dorëshkrim. Me këtë shkrim të vijueshëm i gjejmë mbishkrimet e kishave tona, përveç ndonjë përjashtimi të rrallë, deri në gjysmën e shek. XIX.

Përveç fjalëve të ngjitura, në mbishkrimet e kishave tona takohen shpesh edhe ligaturat, dmth. bashkimi i dy ose më shumë gërmave si psh. MN (αμν), FNMAH (μη' νη') (mb. 98, 117) etj. Mendojmë se këto ligatura shpjegohen në radhë të parë nga ngushtica e vendit, megjithëqë nuk përjashtohet ideja që të jenë përdorur edhe si ornamente.

Në shumë mbishkrime, qoftë në gjuhën greke, qoftë në atë latine, takojmë shpesh edhe sigla ose shkurtime konvencionale për fjalë të ndryshme si p. sh. (mb. 92) (mb. 92) (mb. 82, 97, 94), (No(m) i (n)e) (mb. 914) (D(omi)ni) (mb. 917, 914) etj.

Disa nga mbishkrimet latinisht të kishave tona janë me shkrime të tipit frakturë, si psh. ai i Manastirit të Shën Gjon Vladimirit (mb. 3) ai i kampanës së Sopotit (mb. 69), ai i portës jugore të Kishës së Dom Lleshit (mb. 928). Mënyra e shkrimit dëshmon për vjetërsinë e mbishkrimit dhe tërthorazi ndihmon në datimin e këtij të fundit, kur ky paraqitet pa datë (mb. 69, 929) Mbishkrimet në gjuhën latine të kohës së vonë paraqiten të shkruara me gërma kapitale të sotme.

Mbishkrimet e epokës osmane, sidomos duke filluar nga shek. XVI, paraqiten në fillim me gabime ortografike (mb. 13, 39) dhe gramatikore (mb. 96, 55, 815 etj.). Kjo është plotësisht e kuptueshme: zhvillimi normal i vendit tonë, qoftë në fushën politike, qoftë në atë kulturore, u ndërpre me katastrofën e pushtimit otoman në gjysmën e dytë të shek. XV. Shkatërrimet e tmerrshme që solli në vendin tonë ky pushtim, kushtet historike veçanërisht të rënda, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shek. XV dhe gjatë shek. XVI, e vështirësuan mjaft vazhdimësinë e zhvillimit dhe bashkë me prapambetjen ekonomike sollën në mënyrë të paevitueshme edhe prapambetjen kulturore, që shprehet ndër të tjera, edhe në njohjen e keqe të gjuhës së shkrimit greqisht ose latinisht.

Grafia e mbishkrimeve në shumë raste reflekton edhe tipare karakteristike të autorit. Kështu, p. sh. mbishkrimet e dorës së Onufrit paraqiten gjithmonë me një grafi të bukur e të rregullt, pa marrë parasysh ndonjë gabim ortografik ose ndonjë gabim që i ka shpëtuar artistit në kopjimin e teksteve biblike apo liturgjike.

Eshtë mjaft interesant fakti që në mbishkrimet e kishave tona të epokës postbizantine shpeshherë reflektohen elemente të gjuhës e kulturës sonë nacionale. Kështu, p. sh. në mbishkrimin e ikonës gravurë të Shën Mërisë të Ardenicës (mb. 111) lexohen fjalët shqip:

... Në mjaft raste emrat e njerëzve janë shënuar me formën shqipe të plotë ose të shkurtuar si psh. Todi (Theodor), Gjergji (Jorgji), Nasi (Thanas), Leka (Aleksandër), Ilo (Ilia), Dhimo (Dhimitër) etj. Janë gjithashtu shumë interesante përpjekjet e piktorëve shqiptarë për të riprodhuar në alfabetin grek tinguj të veçantë të gjuhës sonë që nuk i ka greqishtja. Kështu p. sh. në mb. 138 gj-ja e shqipes pasqyrohet prej dy gërmash greke, yx(gk) ose yy(gg), rr-ja prej dy r-ësh greke, pp(rr), (mb. 188) etj.

Në pjesën më të madhe mbishkrimet e kishave tona paraqiten me gjuhë të varfër e fraza stereotipe. Nganjëherë kopjohet integralisht një mbishkrim më i vjetër, duke i ndërruar vetëm emrin e piktorit, të peshkopit, të igumenit, datën dhe indiktet. Për mosnjohje të gjuhës greke, piktorët vendas në ndonjë rast në mbishkrim në vend që të flasin për pikturimin e bërë në kishë prej tyre, flasin për ndërtim të tempullit prej themeli, pa qenë aspak rasti (mb. 300). Në këtë rast piktori duhet të ketë kopjuar fjalë për fjalë ndonjë mbishkrim më të vjetër të kishës, duke i ndërruar vetëm datën, por me siguri pa e kuptuar aspak përmbajtjen e mbishkrimit të kopjuar.

Nga mbishkrimet dalin mjaft të dhëna që plotësojnë në një masë të rëndësishme dokumentacionin jo vetëm për njohjen e historisë së kishës së krishterë në vendin tonë, por edhe të kushteve të përgjithshme politike, shoqërore e kulturore, sidomos gjatë shekujve të fundit.

*

*

*

Mbishkrimet e institucioneve kishtare të vendit tonë, që janë përfshirë në këtë vëllim, fillojnë prej gjysmës së dytë të shek. IX (866) dhe arrijnë deri nga fundi i shek. XIX. Midis këtij materiali prej rreth 1000 mbishkrimesh, materiali që i përket periudhës së mesjetës së herët, periudhës paraturke, paraqitet tepër i vobektë, me rreth 35 mbishkrime. Ky numër, mund të thuhet me siguri, nuk mund të tregojë sasinë e vërtetë të mbishkrimeve të asaj periudhe në vendin tonë aq më tepër që kemi të dhëna të sakta për një numër të madh monumentesh rrënojat e të cilave ruhen edhe sot siç janë Shën Mëria e Devollit ose Selasforit pranë Korçës. Kisha e Shën Sergjit e Bakut pranë Shkodrës, Shën Mëria e Glavenicës pranë Ballshit etj. etj. si këto, të cilat pa dyshim duhet të kenë qenë pajisur me mbishkrime. Por luftërat e shpeshta, sidomos invadimi otoman dhe qëndresa luftarake e popullit tonë kundër pushtimit, e cila zgjati me kryengritje të vazhdueshme kanë qenë faktorët kryesorë për rrënimet katastrofale të vendit tonë, gjë që kontribuoi edhe në zhdukjen ose cungimin kaq të rëndë të materialit tonë epigrafik të asaj periudhe. Mobilizimi total i popullit tonë kundër pushtimit të huaj shpjegon ndërprerjen e çdo veprimtarie ndërtuese dhe, lidhur me këtë, edhe mungesën gati të plotë të mbishkrimeve gjatë shek. XV në vendin tonë.

Me gjithë pasojat e rënda të pushtimit të huaj, vendi ynë qysh prej shek. XVI e këtej filloi gradualisht të rimëkëmbej, gjë që shihet edhe në fushën e krijimtarisë kulturore, këtë fakt e dëshmojnë edhe mbishkrimet që po botojmë.

Diçka më e mirë është gjendja përsa u përket materialeve të epigrafisë kishtare në shek. XVII, këtu mbishkrimet arrijnë numrin 94-100. Megjithatë duhet thënë se ky shekull karakterizohet nga fushata e madhe e islamizimit me dhunë, që përshkoi në këtë periudhë vendin tonë, e cila zhduku përgjithmonë nga faqja e dheut një numër të madh kishash bashkë me veprat artistike dhe mbishkrimet e tyre, nga ana tjetër, edhe zhvillimin e lirë të veprimtarisë kulturore në pjesën tjetër të vendit që nuk u përfshi nga islamizmi.

Kushte të reja më të favorshme u krijuan në vendin tonë nga mesi i shek. XVIII, kur me fuqizimin e përqëndrimin e pushtetit të disa feudalëve shqiptarë u favorizua zhvillimi i zejtarisë e tregtisë, u ngrit niveli ekonomik e kulturor i vendit, u rritën dhe u zhvilluan qytetet. Njëkohësisht u krijuan kushte më të favorshme edhe për veprimtarinë e kishës së krishterë, duke qenë se pashallarët shqiptarë në Jug e në Veri, për të përforcuar pozitën e vet, hoqën dorë nga fushata e

islamizimit dhe në një varg rastesh u mbështetën mbi popullsinë e krishterë vendase. Një faktor tjetër i favorshëm u bë fakti se në një varg selish peshkopale të vendit qëndronin peshkopë shqiptarë, të varur nga Kryepeshkopata ose Patriarkia e Ohrit; si vendas dhe të lidhur me interesat e vendit, disa nga ata morën pjesë aktive në kryengritjet e shek. XVI e më vonë u kujdesën për ndërtimin e kishave dhe pajisjen e tyre si dhe për ngritjen e institucioneve kulturore-arsimore. Në këto kushte rritet edhe materiali epigrafik: në shek. XVIII kemi 316-320, kurse në shek. XIX 403 mbishkrime në kishat e vendit tonë.

Por edhe këto materiale epigrafike paraqiten me dëmtime, cungime e humbje të rënda. Për këto u bënë shkak veçanërisht ngjarjet luftarake që përshkuan vendin tonë në këto 50 vjetët e fundit dhe pushtimet e huaja lidhur me to si psh. lufta e parë botërore e sidomos Lufta e Dytë Botërore, gjatë së cilës pushtuesit fashistë italianë e gjermanë i shkaktuan dëme të pazëvendësueshme monumenteve tona të kulturës. Kështu shpjegohet p. sh. fakti që nga një botim mbishkrimesh të mbledhura para 50 vjetësh, në vitin 1915, nga P. I. Pulica mjaft prej tyre kanë humbur, sidomos ato që ndodheshin në objekte të lëvizshme të kultit.

*

*

*

Mbishkrimet e mbledhura në këtë botim, për vetë natyrën e karakterin e tyre, si mbishkrime të ndodhura në objekte kulti, rëndësinë e tyre të parë e kanë për historinë kishtare të vendit. Kjo natyrisht nuk do të thotë se ato nuk kanë edhe rëndësi për historinë e përgjithshme, politike e kulturore të vendit tonë.

Megjithëse të dhënat nga mbishkrimet e kishave tona që i përkasin historisë politike në përgjithësi janë të pakta, prapëseprapë disa prej tyre paraqiten me rëndësi të veçantë, sepse mbesin të vetmet burime për çështje të caktuara e të diskutueshme të historisë së vendit tonë.

Kështu, p. sh. nga mbishkrimet ktitoriale të Kishës së Manastirit të Shën Gjon Vladimirit pranë Elbasanit rezulton se Karl Topia, princi shqiptar i shek. XIV, e ka rindërtuar këtë kishë "prej të 22-tit deri në 24-tin vit të zotërimit të tij" (mb. 4). Nga dy mbishkrime të tjera po të kësaj kishe (mb. 2 dhe 3) rezulton se viti 22 i zotërimit të Karlit ishte viti 1381, nga kjo nxirret se Karli u bë zot i Shqipërisë së Mesme më 1359. Burimi më i vjetër historik arkival (1) e përmend Karl Topinë si sundimtar për herë të parë më 1362. Në këto rrethana mbishkrimi i Kishës së Shën Gjonit mbetet i vetmi burim historik që sqaron një datë të rëndësishme të historisë së vendit tonë. Nga mbishkrimi i epitafit të Glavenicës (mb. 90) përforcohet fakti historik që Gjergji I dhe Balsha II rreth vitit 1373 kanë sunduar jo vetëm mbi një pjesë të Arbërisë ku ishin zotërimet e Karl Topisë, por edhe mbi krahinat e Beratit, të Vlorës e në Romani, siç quhej pjesa qendrore e perëndimore e zotërimeve bizantine në Ballkan. Të dhënat e këtij mbishkrimi të rëndësishëm, nga të cilat ndër të tjera rezulton edhe se më 1373 Kalisti ka qenë njëkohësisht peshkop i Glavenicës e i Beratit, kombinuar me të dhënat e dy mbishkrimeve të tjera të gjetura në Ballsh të Mallakastrës (mb. 82 dhe 134) si edhe me të dhënat e një gojëdhëne të Beratit, sipas të cilës epitafi i Glavenicës ka ardhur nga Manastiri i Shën Mërisë së Ballshit, të çojnë në mënyrë të padiskutueshme në konkluzionin që Glavenica e lashtë s'është tjetër veçse Ballshi i sotshëm (38), gjë për të cilën zhvillohen akoma sot diskutime.

Nga një mbishkrim i Kishës së Maligradit (mb. 287) rezulton se në vitin 1369, në kohën e sundimit të Kral Velikashinit në Makedoni, zot i krahinës së Prespës ishte Kezar Novaku, kurse nga një mbishkrim i Kishës së Ristozit të Mborjes (mb. 290) rezulton se Amirali, i biri i Kezar Novakut, ka qenë zot i së njëjtës krahinë më 1389; ai duhet ta ketë shtrirë sundimin e vet deri në viset e Korçës, që të përmendet emri i tij si sundimtar në mbishkrimin e Mborjes. Për këtë mungojnë krejtësisht burime të tjera.

Edhe për periudha më të reja nuk mungojnë të dhëna historike interesante, siç është rasti i disa mbishkrimeve që lidhen me Ali Pashë Tepelenën. Kështu p. sh. mbishkrimi i Kishës së Shën Mërisë së Sopikut të Pogonit (mb. 597) përmend suvatimin e kishës nga priftërit Papa Kostandini, Papa Panajoti e Papa Jani "të cilët i vrau Ali Toska në Kakollako më 1772". Sipas

një gojëdhënë të Sopikut priftërit u vranë sepse nuk kishin pranuar të bëhej katundi çiflik i Kurt Pashës.

Sipas mb. 423 qyteti Vithkuq është prishur më 25 tetor 1823, kurse sipas mb. 428 Vithkuqi në vitin 1828 ende është krejtësisht i rrënuar, me shtëpi të prishura e pa njerëz. Po të kemi parasysh se në këtë kohë zhvillohej lufta çlirimtare e popullit grek, mund të mendojmë se prishja e Vithkuqit duhet të ketë të bëjë me një pjesëmarrje aktive të vithkuqarëve në këtë lëvizje, gjë që vërtetohet edhe nga burime të tjera.

Një mbishkrim i Kishës së Shën Kollit në Seljan të Pogonit (mb. 661) përforcon një gojëdhënë që tregohet lidhur me marrjen e Sulit nga Ali Pashë Tepelena dhe djegien e një kallogjeri në pirq të Kungjit me gjithë delegatët e Ali Pashës.

Nga një mbishkrim i Kishës së Shën Kozmajt në Kolkondas të Myzeqesë (mb. 275) rezulton se kisha është ndërtuar me urdhrin dhe nxitjen e Ali Pashës. Ky fakt vërtetohet edhe nga dy bujurulldi të asaj kohe të Vezirit të Janinës (2, f. 82).

Interesante janë edhe konkluzionet që mund të nxirren nga mbishkrimet për fazat e ndryshme të islamizimit në vendin tonë. P. sh. mbishkrimi i Kishës së Shën Mërisë së Dushanit të Oparit (mb. 302) tregon se deri në datën e pikturimit të kishës (1610), popullsia e këtij katundi ishte e gjithë e krishterë, kurse nga (mb. 127) rezulton se deri më 1751 Ballshi ka pasë ende popullsi të krishterë.

Mbishkrimi i kishës së Shën Mërisë së Dragotit në rrethin e Elbasanit (mb. 41) me datë 1782 dhe ai i pikturimit të kësaj kishe (mb. 42, 43) me datë 1785, kallzojnë se ky fshat i Dumresë deri nga fundi i shek. XVIII ka qenë gjithashtu i krishterë.

Në mbishkrimin e një potiri të Kishës së Shën Gjergjit në Kudhës të Himarës figuron emri i priftit Papa Zaho me datë 1826, kurse në mbishkrimin e një muri të kishës së Shën Mërisë së Qiparosë (mb. 855) e gjejmë po këtë emër me datë 1769. Sipas një komunikimi personal nga nipi i Papa Zaho ka pasë qenë prifti i Kuçit të Kurveleshit. Prifti u burgos nga Pasha për dy vjet në Janinë. Kur u lirua nga burgu, Papa Zaho e gjeti Kuçin të islamizuar, prandaj u vendos në Kudhës ku edhe vdiq më 1848 (Kjo datë gjendet mbi pllloçen e mbivorrshme).

Mbishkrime të kishave tona të periudhës osmane bëjnë fjalë edhe për esnafet (mb. 198, 199, 120). Kjo përforcon faktin e njohur të organizimit në esnafa të zejtarisë në vendin tonë gjatë shekujve të mesjetës. Esnafet përmenden në mbishkrimet për ndihmat që kanë dhënë në ndërtim kishash, stolisje kishash me vepra arti, piktura murale e ikona.

Nga mbishkrime të Kishës së Manastirit të Ardenicës (mb. 118, 119, 120) rezulton se pikturat murale dhe ikonat e kësaj kishe, që janë punë e piktorëve Kostandin e Athanas Zografit e të Jerodhiakon Kostandin Shpatarakut, janë porositur e paguar nga esnafet e Voskopojës.

Eshtë interesant fakti se në këto mbishkrime nuk bëhet fjalë vetëm për esnafa të qyteteve e qendrave më të mëdha si Korçë, Voskopojë, etj., por edhe për esnafë të Llëngës e Grabovës. Sikurse dihet, nga fundi i shek. XVII e gjatë shek. XVIII, u krijua mundësia për një farë mëkëmbje ekonomike, me anë të zhvillimit të zejtarisë e të tregtisë. Filluan kështu të forcohen komunitetet e krishtera në disa qytete, si Berati, Elbasani, Shkodra. Kjo situatë i dha mundësi zhvillimit edhe të disa katundeve të mëdhenj, si Voskopoja, Suhareka, Llanga, Grabova, Vithkuqi e Dhërmiu me zejtarë e esnafa aq sa mbishkrimet e kishave këto qendra të vogla i quajnë "politie", dmth. qytete (mb. 34, 167, 170, 172, 174, 828), megjithëse, përveç Voskopojës, asnjë nga këto katunde nuk mori tiparet e një qyteti me kuptimin e plotë të fjalës.

Eshtë e qartë se nga mbishkrimet dalin të dhëna në radhë të parë rreth kishës, që kontribuojnë për të sqaruar pozitën e saj si një faktor kryesor të rendit feudal, për rolin e saj aq të rëndësishëm si pronare e madhe tokash, për veprimtarinë e saj ekonomike e politike, si mbështetje ideologjike e rendit feudal në fuqi në periudhën paraturke, megjithëse në kushtet e pushtimit otoman ajo në disa raste qëndronte në opozition me regjimin politik otoman duke gëzuar mbështetjen e masave popullore, ajo e ruajti karakterin e saj si institucion i shfrytëzimit

klasor. Me rëndësi janë të dhënat rreth peshkopatave të vjetra dhe peshkopëve të vendit tonë dhe juridiksionit dhe administratës së tyre, rreth manastirëve dhe veprimtarisë së tyre.

Në mbishkrimet e kishave tona të periudhës paraturke të dhënat për peshkopatat e peshkopët janë më të pakta. Kjo mund të rrjedhë për arsye se shumë të pakta janë edhe mbishkrimet e ruajtura nga ajo kohë dhe sepse ktitorët e atyre kishave në pjesën më të madhe janë para së gjithash mbretër e princër të fuqishëm.

Në mbishkrimet e periudhës paraturke përmenden vetëm dy peshkopë të peshkopatave të vendit tonë, Kalisti i Glavenicës e i Beratit (mb. 90) dhe Nimfoni (mb. 290). Është interesant se këta dy emra nuk figurojnë në katalogët e peshkopëve botuar nga Aleksudhi (2), Gelzer (11) dhe Germanoi i Sardës (12). Nga mbishkrimi që përmend peshkop Kalistin, rezulton se Glavenica më 1373 ishte një qendër peshkopale kaq e rëndësishme, sa kishte në vartësi edhe peshkopatën e Beratit, qendër e njohur për traditat e saj kishtare.

Kryepeshkopata e Justinianës së parë (ose Ohrit) më 1369 përmendet në mbishkrimin kryesor të Kishës së Shën Mërisë së Maligradit (mb. 287), sepse aso kohe Prespa varej kishtarisht nga Ohri, por nuk përmendet në mbishkrim drejtuesi i kësaj qendre të madhe kishtare. Ka mundësi që në kohën që është shkruar mbishkrimi kryepeshkopata të ketë qenë provizorisht pa titullar (mb. 287).

Duke kaluar shek. XV, për të cilin mungojnë të dhëna, në shek. XVI ato pak mbishkrime që ruhen deri më sot nuk bëjnë fjalë për peshkopë e peshkopata, me përjashtim të dy mbishkrimeve (520 dhe 522), të të cilat përmendet Simeoni i Drinopojës më 1511 dhe më 1526.

Mosfigurimi i titullarëve të peshkopatave në mbishkrimet e kishave të vendit tonë në shek. XVI, ne mendojmë se duhet të shpjegohet me humbjen e ekuilibrit në administratën eparkiale kishtare për arsye të gjendjes së luftës e të mobilizimit kryengritës të popullit. Ka mundësi që edhe pas okupacionit osman peshkopatat e vendit tonë të kenë pas mbetur pa drejtues për një kohë pak a shumë të gjatë. Vetëm kështu mund të shpjegohet mungesa e emrit të prelatit në mbishkrimin e Kishës së Vllahernës (në kala të Beratit) me rastin e pikturimit të kësaj kisha, e cila ndodhet ngjitur me Mitropolinë e qytetit (mb. 92). Ka të ngjarë që mungesa e emrit të titullarëve në këto mbishkrime të rrjedhë në ndonjë rast edhe për arsye iniciativash lokale të kryera pa dijeninë e titullarëve kryesorë të dioqezave (vështro mbishkrimet 803, 804).

Në mbishkrimet e kishave tona të shek. XVII deri XIX përmenden peshkopatat e Durrësit, Beratit, Korçës, Drinopojës, Himarës e Delvinës, Gorës e Mokrës, Stefanakës dhe Bendës. Nuk dihet edhe sot se ku ishin qendrat e disave prej këtyre peshkopatave (peshk. e Drinopojës, Gorës, Mokrës, Stephanensis et Bendensis).

Lidhur me peshkopët që kanë drejtuar peshkopatat e ndryshme ortodokse të vendit tonë gjatë shekujve, nga mbishkrimet na dalin 42 prelatë. Nga këta 9 nuk figurojnë fare në katalogët peshkopalë të Aleksudhit (2), të Germanojt të Sardës (12), të Gelcerit (11), që zumë me gojë më sipër; këta janë:

Kalisti i Glavenicës e i Beratit - 1373 (mb. 90)

Nimfoni, pa titull - 1389 (mb. 290, 291, 292)

Simeoni i Drinopojës - 1510, 1526 (mb. 520, 522)

Lavrenti, pa titull - 1604 (mb. 16)

Elefteri i Beratit - 1630 (mb. 558)

Niqifori i Glavenicës(?) - 1751 (38 f. 235)

Meleti i Ohrit(?) - 1873 (mb. 461)

Vonga, pa titull(?) - 1826 (mb. 873)

Meka, peshkop i Stefanakës dhe i Bendës pa datë (mb. 926).

Rezulton gjithashtu se 10 peshkopë përmenden në data të reja që nuk figurojnë në katalogët peshkopalë të Aleksudhit, të Germanojt të Sardës e të Gelcerit e konkretisht:

Matheu i Drinopojës - 1614 (mb. 537), 1617 (mb. 540)

Egnati i Justinianës së parë - 1659 (mb. 306)

Gedeoni pa titull - 1659 (mb. 565)
 Mitrofani i Drinopojës 1754 (mb. 584), 1758 (mb. 586)
 Neofit Haxhikosta - 1756 (mb. 358), 1768 (mb. 359)
 Dositeu i Drinopojës - 1788 (mb. 627), 1793 (mb. 635)
 Gabrieli i Drinopojës - 1799 (mb. 668)
 Kirilli i Korçës, nga Veria - 1847 (mb. 440)
 Anthiu Aleksudhi - 1864 (mb. 246), 1883 (mb. 261), 1885 (mb. 265)
 Dorotheu i Korçës - 1868 (mb. 271)

Rezulton edhe se nga 42 peshkopët që përmendin mbishkrimet 9 janë shqiptarë e konkretisht:

Arsen Vako i Gorës Mokrës (1685-1714) (mb. 20), nga Potkozhani i Mokrës.
 Metodi i Beratit (1736-1751) (mb. 115) nga Bubullima e Myzeqesë.
 Joasafi i Beratit 1752-1760 dhe 1765-1801 (mb. 138), po nga Bubullima.
 Joasafi II i Beratit (1802-1855) (mb. 194), po nga Bubullima.
 Egnati i Justinianës së parë (1693-1695) (mb. 306), nga Berati. Joasafi i Korçës e Selasforit (1709-1745) (mb. 329, 331, 336, 345) nga Voskopoja.
 Neofit Kekezi i Korçës (1845-1874) (mb. 413, 440, 506), nga Gjirokastra.
 Joaniqi i Durrësit (1845-1858) (mb. 63), nga Elbasani.
 Visarioni i Durrësit (1867-1899) (mb. 63) i quajtur edhe Visarion Thahari ose Visarioni plak, nga Elbasani.

Prej këtyre prelatëve shqiptarë, peshkopi Arsen Vako në mbishkrim figuron pa titull, por katalogët peshkopalë e përmendin si të Gorës e Mokrës.

Këta prelatë shqiptarë në krye të peshkopatave të vendit, duke përfituar nga lëshimet që bënë pashallarët shqiptarë në shek. XVIII dhe nga mëkëmbja ekonomike e relative e popullsisë, u përpoqën të përfitojnë pozitën e kishës duke ndërmarrë një fushatë ndërtimesh kanë përkrahur ndërtues e artistë, punues të shquar të drurit e të metaleve. Me iniciativën e prelatëve shqiptarë janë rindërtuar kisha të vjetra ose janë ngritur nga themelet kisha e manastire të reja, disa nga të cilat, me pamje madhështore, janë meremetuar, pikturuar e pajisur me ikonostase e objekte të ndryshme argjendi të kultit të krishterë. Nga burime jashtë mbishkrimeve dihet se patriku shqiptar Joasaf Voskopojari ka pasë qenë një nga iniciatorët kryesorë për ndërtimet e mëdha kulturore-fetare të kryera në Voskopojë. Vetëm për një ditë Joasafi mblodhi të gjitha të hollat që duheshin për themelimin e Akademisë së Re, e cila u bë një qendër e rëndësishme kulturore për gjithë vendin.

*

*

*

Mjaft nga materialet epigrafike të vendit tonë kanë të dhëna që i interesojnë historisë së ndërtimit të kishave dhe të arkitekturës dhe pjesa më e madhe e autorëve që kanë botuar mbishkrime të kishave tona, janë preokupuar t'i nxjerrin në dritë këto të dhëna (2, 4, 13, 15, 17, 22, 26, 28, 32, 36, 41, 48, 52, 58).

Mbishkrimet që japin të dhëna për ndërtimet e kohës paraturke te ne janë të pakta. Datat më të vjetra të ndërtimit në vendin tonë i regjistron një mbishkrim i Labovës së Kryqit, që mban datën 525 (mb. 517), një mbishkrim i Shën Mërisë së Peshkopisë së sipërme, që mban datën 619 (mb. 519) dhe një i Shën Sergiut e Bakut në Himarë, që mban datën 786 (mb. 801). Këto mbishkrime duket se i referohen kohës së ndërtimit të kishave përkatëse, por ato me siguri janë shkruar në epoka shumë më të vona, ndofta në bazë të ndonjë gojëdhëne të lashtë ose të ndonjë mbishkrimi që ka pasë humbur; për origjinën e tyre të re flet përdorimi i kronologjisë prej lindjes së Krishtit, që është e vonë në Kishën Ortodokse, dhe, nga ana tjetër, përdorimi i shifrave arabe, që te ne kanë filluar të përdoren gjatë kohës së okupacionit turk. (1)

Për një ndërtim të shek. XI na informon një mbishkrim i vonë i piktor Terpo Zografit në Kishën e Shën Mërisë në Lubonjë të Kolonjës (mb. 398), me fjalët "Ka pasë qenë ndërtuar prej fillimi më 1015"; për një ndërtim të shek. XII (1159) na informon gjithashtu një mbishkrim i

Kishës së Shën Mitrit në Potkozhan të Mokrës (mb. 1), që është një datë me shifra arabe e gdhendur në një gur, me siguri në kohë më të vonë.

Materialet epigrafike flasin për dy ndërtime të shek. XIII, nga të cilët njëri (datë 1240) ka të bëjë me Kishën e Dom Lleshit në Lezhë (mb. 912) dhe tjetri (datë 1290) me kishën e Shirgjit të Shkodrës (mb. 913, 914). Mbishkrimi i parë duhet të jetë regjistrim i vonë i ndonjë gojëdhëne më të lashtë, mbasi kisha e Dom Lleshit që ruhet sot na duket shumë më e vonë se e shek. XIII. Mbishkrimi i Kishës së Sergjit e Bakhut flet për rindërtimin e Kishës nga mbretëresha Elenë e Serbisë. Gërmadhat e kishës që ruhen sot në Shirgj janë të rindërtimit të Kishës së Elenës nga ana e birit të saj të Uroshit II më 1318 (53).

Nga një datë e një guri (1250), murosur mbi apsidë të kishës së Manastirit të Shën Mërisë së Apolonisë (mb. 84), kuptohet se kisha duhet të jetë ndërtuar mbas kësaj date. Mbishkrimi i gurit në të cilin bën pjesë edhe data, paraqitet i konsumuar nga këmbët e njerëzve (përveç datës), ndofta sepse guri duhet të ketë qenë gur i përmbivorrshëm. Në këtë konkluzion të çon edhe grafia e hollë e mbishkrimit, e cila nuk mund të ketë qenë kurrësi një grafi për një mbishkrim themelor ndërtimi të një monumenti. Në zbërthimin e problemit të kohës së ndërtimit na ndihmon fakti se në pikturën murale të eksonartekstit të kishës si ktitor i kishës paraqitet Mihail Paleologu kur ishte bashksundues me të birin Andronikun II Paleolog (mb. 87). Në pikturë figuron edhe maketi i një kisha dhe nga ana tjetër Androniku (në plan të dytë) paraqitet me kurorë perandorake në krye, dmth. si sundues bashkë me të jatën. Duke qenë se është i njohur fakti që Mihail Paleologu VIII ka bashksunduar me të birin Andronikun II nga 1266 deri në 1282, data e ndërtimit të kishës së Manastirit të Shën Mërisë së Apolonisë duhet të kërkohet ndërmjet këtyre dy datave. Sa për atributin "Konstandini i ri" i përdorur nga piktori për Mihail Paleologun VIII kjo duhet kuptuar si një përsëritje e një zakoni jo fort të rrallë në historinë e perandorëve të Bizantit.

Kisha e Shirgjit, që sot ruhet në gërmadha dhe ajo e Apolonisë janë nga ndërtimet kishtarë më të rëndësishme të mesjetës së vendit tonë.

Sa për shek. XIV, mbishkrimet na flasin vetëm për tri ndërtime kishash të vogla, për ndërtimin e Shën Mërisë së Maligradit të Prespës (mb. 287), që është një paraklis i thjeshtë, për atë të Ristozit të Mborjes (mb. 290), që paraqitet katërkëndëshe me një kube, dhe për atë të Manastirit të Shën Gjon Vladimirit pranë Elbasanit (mb. 2, 3, 4), që ishte në stil bizantin me një kube (28, f. 222). Në Shën Mërinë e Maligradit ruhet data 1345 e pikturës së parë; ka shumë të ngjarë që kjo të jetë edhe data e ndërtimit të kishës, sepse po në atë kishë ruhet data 1369 (mb. 287) si datë e shtojcës së sipërme të kishës dhe e pikturës së dytë, të bërë me shpenzimet e Kezar Novakut. Në Kishën e Ristozit të Mborjes ruhet data 1389 si datë e ndërtimit prej themeli të Kishës nga peshkop Nimfoni. Në Kishën e sotme të Shën Gjon Vladimirit ruhet data 1381 e rindërtimit të kishës së vjetër nga ana e Karl Topisë. Kisha e ngritur nga ky princ shqiptar është prishur aty nga fundi i shekullit të kaluar.

Datat që jepen në mbishkrimet për ndërtime kishash në shek. XIV mund të konsiderohen si të sakta. Kjo lejon që duke u mbështetur në stilin e ndërtimit, të caktohet me përafërsi edhe data e ndërtimit të mjaft kishave të tjera, që i përkasin këtij shekulli, por që sot ruhen pa mbishkrime e pa data.

Gjatë shek. XV nuk takohen mbishkrime që të flasin për ndërrime kishash, përveç një date me shifra arabe gdhendur në gur (1465) në Kishën e Shën Markut në Kalanë e Vaut të Dejës (mb. 917), e cila simbas mendimit tonë duhet pranuar me mjaft rezervë. II. Karmici (19, f. 58) jep për Kishën e Manastirit të Shën Kollit të Boboshticës datën 1450, pa e kallëzuar burimin nga e ka marrë këtë datë. Edhe kjo neve na duket e diskutueshme.

Nga të dhënat e mbishkrimeve, ndërtimet e institucioneve fetare kristiane fillojnë prapë në vendin tonë aty nga mesi i shek. XVI, gjë që dëshmon për një rimëkëmbje të ngadalshme të vendit. Kishat e para të ndërtuara paraqiten të thjeshta, katërkëndëshe me çati dyujse, pa tholo e pa ndonjë rëndësi arkitektonike, siç janë Kisha e Shën Gjergjit në Leshnicë të sipërme të

Theologos me datë 1525 (mb. 803), Kisha e Shën Mitrit me datë 1526 në Poliçan të Pogonit (mb. 522), Kisha e Shën e Premtes në Valesh të Shpatit (mb. 13), data e pikturimit të së cilës (1554) ka të ngjarë të jetë edhe datë e ndërtimit ose e rindërtimit të saj, Kisha e Shën Todrit në Kala të Beratit, pa datë, e ndonjë tjetër.

Sipas të dhënave të mbishkrimeve, nga fundi i shek. XVI kemi në vendin tonë ndërtime kishash me arkitekturë më komplekse, me tholo e me kube sipas traditës së lashtë bizantine, por edhe me ndryshime që reflektojnë kushtet e kohës e të vendit. Ndërtime të tilla të fundit të shek. XVI janë p. sh. Kisha e Manastirit të Shën Mërisë në Driano, me datë 1569 (mb. 526), Kisha e Shën Mërisë në Kameno të Delvinës, me datë 1580 (mb. 806), ajo e Manastirit të Shën Mërisë mbi Vanistë, me datë 1582 (mb. 527), e Manastirit të Shpërfytyrimit në Çatistë të Pogonit, me datë 1584 (mb. 529), e Manastirit të Profet Ilisë mbi Jorgucat me datë 1586 (mb. 530) e Manastirit të Shën Qiriakut e Julitës mbi Dhuvjan, me datë 1588 (mb. 531).

Për shek. XVII, megjithëqë këtë e karakterizon fushata e madhe e islamizimit në masë të popullsisë dhe si rrjedhim rrënimi i shumë godinave të Kultit kristian, materialet epigrafike kishtarë dëshmojnë për shtimin e ritmit të ndërtimeve të kishave sidomos në zonat e rezistencës. Mbishkrimet flasin për 24 kisha të ndërtuara gjatë këtij shekulli, nga të cilat 10 të mëdha, me tholo e kube. Gjatë këtij shekulli në krahinën e Gjirokastrës, në traditën e vjetër, realizohet ndërtimi i disa monumenteve të rëndësishme arkitektonike, siç janë Kisha e Manastirit të Ravenës, me datë 1600, në formë kryqi në tri apsida anash (mb. 533), Kisha e Shën Mërtirëve në Tranoshishtë me datë 1617 (mb. 541), ajo e Manastirit të Profet Ilisë në Stegopull me datë 1624 (mb. 550), ajo e Manastirit të Spilesë me datë 1634 (mb. 559) etj. Gjatë këtij shekulli rriten ndërtimet edhe në zonën e Korçës; ndër këto për interesin arkitektonik shquhen Kisha njënefshe e Shën Mërisë së Barmashit, me datë 1610, në fillim me tri kube hemisferike e dy të tjera që janë shtuar më vonë (mb. 303), e cila paraqitet si ndërtim i parë në vendin tonë me kube hemisferike, Kisha e Manastirit të Shën Prodhromit në Voskopojë me datë 1634, me tri apsida anash dhe kube (mb. 306) Kisha e Shën Mëhillit në Vithkuq, me datë 1682, bazilika e parë trinefshe me kube hemisferike nga më madhështoret në vendin tonë (mb. 313), dhe katedralja e Shën Mërisë në Voskopojë, bazilikë trinefshe me tholo e kube hemisferike, ndofta e fundit të këtij shekulli. Në këtë shekull edhe në zonën e Durrësit takohen dy ndërtime, njëri në Valësh, me datë 1604 (mb. 16) dhe tjetri jashtë Kavajës, me datë 1690 (mb. 21).

Nga mbishkrimet rezulton se gjatë shek. XVIII veprimtaria e ndërtimeve të godinave të kultit kristian zgjerohet edhe më tepër. Vetëm nga mbishkrimet e ruajtura rezultojnë të ndërtuara përmbi 50 kisha gjatë këtij shekulli. Në pjesën më të madhe këto ndërtime paraqiten të mëdha nga ana arkitektonike, bazilika trinefshe me tholo e shumë kube hemisferike për çdo nef, me një ose dy hajate në drejtim gjatësor, nganjëherë edhe dy katëshe.

Lidhur me ndërtimet e rindërtimet e kultit kristian gjatë shekullit XVIII, duhet theksuar se pranë institucioneve fetare kristiane, sidomos pranë manastireve, merr hov edhe ndërtimi i shkollave, të cilat në fillim funksiononin në gjuhën greke. Disa nga godinat e këtyre shkollave janë ruajtur deri sot në ditët tona (shkolla e Manastirit të Shën Spiridhonit në Vuno, ajo e Manastirit të Ardenicës, e Manastirit të Shën Mëhillit në Nivan të Zagorisë, e Manastirit të Shën Pjetrit në Vithkuq etj.).

Këto shkolla siç e dëshmojnë mbishkrimet (mb. 834) si dhe shumë gojëdhëna, të trashëguara deri më sot, janë organizuar e janë udhëhequr nga klerikë të ditur, si Klimenti i Ardenicës, muzikant (mb. 138), igumeni i shumëditur Manasiu (mb. 138) etj. Nga këto shkolla kanë dalë figura që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në gjirin e komuniteteve të krishtera në atë kohë, si peshkopët shqiptarë Joasafi i Beratit (mb. 138, 144 etj.). Danieli i Korçës (mb. 326), Joasaf Voskopojari i Korçës dhe i Justinianës së parë të Ohrit (mb. 329, 331) etj.

Shkollat e manastireve në një varg rastesh kanë shërbyer për përhapjen e dijes dhe për të mbajtur gjallë ndjenjat kombëtare ndër fëmijët e të rinjtë fshatarë e qytetarë. Në të tilla shkolla mësuan Dhaskal Todhri, që i mori mësimet e para në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit pranë

Elbasanit, dhe prej aty më vonë kaloi në Akademinë e re të Voskopojës, Andon Zako Çajupi, që ka qenë nxënës i Manastirit të Shën Mëhillit të Nivanit të Zagorisë etj.

Lidhur me ktitorët porositësit ose dhuruesit ndaj institucioneve të kultit kristian, nga materialet epigrafike rezultojnë mjaft të dhëna me karakter historik.

Ktitorë në mbishkrimet e kishave tona shohim të përmenden që prej shek. XIII. Kështu mbishkrimi i Kishës së Shën Sergjit e Bakhut në Shirgj të Shkodrës, me datë 1290 (mb. 913), bën fjalë për ndërtimin e kësaj kisha prej mbretëreshës Elenë dhe bijve të saj Stefanit e Uroshit. Mbishkrimet mbi freskun e familjes perandorake të Mihail Paleologut, në eksonarteks të kishës së Manastirit të Shën Mërisë së Apolonisë (mb. 86, 87), kallëzojnë se ktitorët e kësaj kisha kanë qenë Mihail Paleologu, kur sundonte bashkë me birin e tij Andronikun e dytë. Një mbishkrim tjetër në gërmadhat e Kishës së Shën Sergjit e Bakhut (mb. 914) përmend si ktitor të rindërtimit të një kisha të dytë të shenjtoreve të sipërpërmendur mbretin Urosh, birin e mbretit Urosh të Rashës e të Mbretëreshës Elenë.

Mbishkrimi më i vjetër i Kishës së Shën Mërisë së Maligradit të Prespës (mb. 286) përmend fisnikët Bojko dhe Evdokia si dhurues të pikturës së kishës me datë 1345, kurse një mbishkrim tjetër (mb. 287), me datë 1369, përmend "shumëfisnikun" Kesar Novak si ktitor të ndërtimit të shtojcës së kishës dhe të pikturës së saj të dytë.

Mbishkrimet në tri gjuhë të Kishës së Manastirit të Shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit (mb. 2, 3, 4) përmendin si ktitor të rindërtimit të Kishës më 1381 Karl Topinë me birin e tij të parëlindur Gjergjin. Mbishkrimet e kishës së Ristozit të Mborjes (mb. 290) përmendin me datë 1389 si ktitor Nimfonin, një peshkop të cilit nuk i jepet titulli i dioqezës, por që duhet të ketë administruar jo larg zonës së Korçës ose të ketë qenë ndihmës i titullarit të Selasforit.

Nga këto pak të dhëna rezulton se ktitorët e kishave dhe dhuruesit e pikturës gjatë shekujve XIII-XV në vendin tonë kanë pasë qenë nga shëresa aristokrate feudale e vendit (perandorë, princa, fisnikë, peshkopë). Klasa feudale në radhë të parë kishte mundësi të bënte për ndërtime të kultit shpenzime që në përgjithësi ishin të konsiderueshme.

Në periudhën mbas okupacionit otoman nga mbishkrimet vetëm në dy raste ktitorët cilësohen si "arkondë" e me prejardhje laike (mb. 16, 18) 1. Ka të ngjarë që ndërtime të tjera gjatë kësaj periudhe të shek. XVI të jenë kryer me fonde të manastireve.

Gjatë shek. XVII si ktitorë mbishkrimet përmendin klerikë, igumenë e murgjë ose laikë nga radhët e arkondëve ose të gjerondëve (të pleqve). Mendojmë se igumenët si ktitorë duhet të konsiderohen vetëm si iniciatorë të ndërtimeve, kurse shpenzimet pa dyshim janë nxjerrë nga arkat e manastireve. Qysh në këtë shekull mbishkrimet fillojnë të flasin për ndërtime të kryera me shpenzimet "e të gjithëve" ose "të katundit". Gjatë shekujve XVIII e XIX, kur konstatohet një aktivitet i madh në ndërtime të kultit kristian, mbishkrimet si ktitorë përmendin prap igumenë dhe laikë arkondë, por në pjesën më të madhe flasin për kontributin e "të gjithë të krishterëve të qytetit" ose "të katundit" ose "të lagjes" ose "të enorisë".

Sikurse dihet, në mesjetë botëkuptimi fetar ka pasë qenë një faktor vendimtar në orientimin ideologjik të njeriut. Prandaj në iniciativat e ndryshme për ndërtime të kultit kristian në vendin tonë, nga materialet epigrafike devocioni fetar del si motiv në plan të parë, sidomos në mbishkrimet më të lashta (vështro mbishkrimet Nr. 2, 17, 92, 95, 117, 174, 808 etj.). Megjithëkëtë nuk përjashtohet rasti që mbrapa iniciativave të ndryshme për ndërtime të kultit kristian të fshihen edhe faktorë politikë ose socialë. I tillë, mendojmë ne, duhet të ketë qenë motivi që shtyri Karl Topinë, një princ katolik, të rindërtojë kishën e Manastirit ortodoks të Shën Gjon Vladimirit pranë Elbasanit më 1381, një kishë ortodokse, e të bëjë katër herë më të madhe nga ç'ishte përpara për të tërhequr nga ana e vet elementin ortodoks të zotërimeve të tij, në një kohë kur ndodhesh në luftën e Balshajt e Shkodrës, të cilët nga ortodoksë ishin kthyer në katolikë (34, f. 202).

Në lidhje me emrat e mjeshtëreve të ndërtimit, materialet epigrafike të kishave tona nuk përmendin gjë deri në shek. XVIII, megjithëqë vendi ynë, me tradita të lashta në fushën e

ndërtimeve arkitektonike (16, f. 128-130), gjatë historisë ka dhënë figura të shquara në këtë fushë (52, f. 177-178).

Emrat e ndërtuesve (kryemjeshtër e mjeshtër) i takojmë vetëm në mbishkrimet e shekujve XVIII e XIX, si shqiptarë ashtu edhe të huaj. Për disa ndërtues në mbishkrime jepet edhe prejardhja e tyre, siç është rasti tek Anastas Voskopojari (mb. 270), Saliu nga Dibra (mb. 270), Mihal Pashku nga Pogradeci (mb. 65), Androniku me katër shokë nga katundi Krimi i Greqisë (mb. 340), protomastor Gega, që ka ndërtuar katedralen e Fierit më 1782 (mb. 153), mjeshtri Nasto Mandro që ka kryer ndërtime në Manastirin e Apolonisë më 1782 (mb. 152), mbiemër të cilin e kemi edhe sot në Pojan të Fierit etj.

Nga materialet epigrafike të kishave të vendit tonë rezultojnë të dhëna të rëndësishme edhe mbi traditat e lashta të vendit tonë në fushën e pikturës, mbi shkollat e ndryshme të këtij arti që janë zhvilluar gjatë shekujve të mesjetës, mbi piktorët e ndryshëm vendas e të huaj që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre artistike në institucionet e ndryshme të kultit kristian të vendit, mbi veprimtarinë e tyre pikturale, e cila në disa raste paraqitet me një rëndësi të dorës së parë.

Ndër institucionet fetare të kultit kristian në vendin tonë ruhen shumë vepra pikturale (piktura murale ose ikona). Për më të vjetrat, sidomos të epokës paraturke, nuk ekzistojnë mbishkrime që të japin të dhëna rreth kohës së pikturimit ose rreth mjeshtërive të pikturës. Në këtë rast orientimi kohësor mund të bëhet vetëm duke studiuar thellë stilin e pikturës ose duke ia nënshtruar një analize paleografike sinjaturat e saj.

Megjithëse, duke u bazuar në të dhënat historiografike e stilistike, mund të formohet ideja se piktura më e vjetër e monumenteve tona datohet afërsisht nga shek. X (40, f. 87), dokumentat epigrafike më të lashta, siç janë autografët e piktorëve, i përkasin fundit të gjysmës së parë të shek. XVI.

Në mbishkrimet e pikturës më të lashtë të vendit tonë përmendet një piktor me emrin Stano si autor i pikturës së Shpellës së Shën Mërisë në Letëm të Çermenikës (mb. 77), që, simbas nesh, duhet të jetë punuar gjatë shek. XI (40, f. 70).

Piktura më e vjetër e datuar në vendin tonë deri më sot rezulton të jetë ajo e pjesës së poshtme të Kishës së Shën Mërisë të Maligradit të Prespës, me data 1345 dhe 1369 (mb. 286, 287). Pastaj vijnë pikturat e vjetra të kishës së Ristozit në Mborje me datë 1389 (mb. 290). Përsa u përket pikturave të koridorit të Kishës së Shën Mërisë së Apolonisë aty ekziston një mbishkrim me datë që mund të shkojë nga 1292 deri 1391 (mb. 85); ky mbishkrim, i dëmtuar në dy shifrat e fundit, prandaj jo plotësisht i saktë, ka mjaft të ngjarë që t'i referohet pikturës së Koridorit.

Piktori i parë shqiptar që njohim në bazë të mbishkrimeve është Onufri nga Neokastra (Elbasani), figura më e shquar e artit piktorial të vendit tonë në shekujt 16, i cili aty nga mesi i shek. XVI pikturoi kishat e Beratit e të Shpatit të Elbasanit (mb. 7, 13, 14, 15, 92, 91). Të pakta janë të dhënat mbi jetën e tij.

Nga të dhënat e mbishkrimeve marrim vesh se Onufri ka pasë qenë i martuar e me fëmijë, ka pasë qenë prift dhe graduar protopapë i Elbasanit. Marrim vesh se mjeshtri ka stolisur me piktura murale dhe ikona katër kisha të vendit tonë, atë të Shën Kollit në Shelcan të Elbasanit (pa datë), atë të Shën e Premtes në Valësh të Shpatit (1554), dhe ato të Shën Todhrit dhe Evangjelizmosë në Kala të Beratit (pa datë), nga të cilat kjo e fundit ruan vetëm ikona të dorës së mjeshtrit.

Nga materialet epigrafike rezulton se traditën e Onufrit, shkollën e krijuar nga ai e vazhdoi një varg piktorësh, midis të cilëve figuronin i biri i Onufrit Nikolla (mb. 91, 92) me piktura murale e ikona të ruajtura në Kishën e Shën Mërisë Vlaherna në Kala të Beratit (1578), një piktor, Jani, bashkëpunëtori i Nikollës në pikturimin e Kishës së Shën Kollit në Kurjan të Fierit (mb. 94), Onufër Kiprioti (mb. 96, 97, 98), me piktura murale e ikona (1594-1622), sidomos në Kishën e Shën Mërisë në Vlahogoranxi të Gjirokastrës, si dhe tre piktorë anonimë (mb. 95) me piktura murale në Shën Kollë të Kalasë së Beratit, pranë Vlahernës (1591), në Shën Kollë të Valshit (1604), e në Shën Kollë të Shelcanit (1625).

Nga materialet epigrafike marrim vesh se ky fenomen i zhvillimit të traditës së lashtë piktorale të vendit nuk qe i izoluar, edhe në jug të vendit fillojnë të shfaqen një varg piktorësh vendas e të huaj si Ilia Llongoviti nga Dropulli i Sipërm (mb. 803, 804), i cili ka veshur me piktura murale Kishën e Shën Gjergjit në Leshnicë të Sipërme dhe atë të Shën Thanasit në Peca të Sarandës (1525), Mihali dhe Kostandini (mb. 807), vllëh nga katundi Gramos që kanë veshur me piktura murale, karakteristike për shkollën e Kretës, Kishën e Manastirit të Shën Mërisë në Dhivrovuni të Sarandës (1604), Mihali me bijtë e tij Kostandinin dhe Nikollën nga Linotopi i Kosturit (mb. 540, 542, 552, 556), që kanë stolisur shumë kisha të jugut (1517-1653) e më në fund Mihali nga katundi Zerma (1662-1672) (mb. 810, 813) etj.

Materialet epigrafike na bëjnë të njohur me një veprimtari piktorale shumë të begatshme gjatë shek. XVIII. Në rrethin e Korçës zhvillojnë veprimtarinë e tyre disa piktorë korçarë, puna e të cilëve ka kaluar edhe jashtë kufijve të vendit tonë; më i rëndësishëm është mjeshtri David Selenicasi (mb. 331), i cili në bashkëpunim me dy piktorë të tjerë, Kostandinin e Kriston, ka krijuar ansamblin piktoral mural të shkëlqyeshëm të bazilikës së Shën Kollit të Voskopojës me datë 1726. Traditën e shkollës së ndritur të David Selenicasit në rrethin e Korçës e vazhdojnë një varg piktorësh të tjerë shqiptarë, si vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi (mb. 345 etj.), të cilët midis viteve 1744-1783 shquhen me vepra piktorale të rëndësishme brenda vendit tonë, ashtu edhe jashtë: bijtë e tyre Terpo dhe Efthim Zografi (mb. 395 etj.) si dhe nxënësit e tyre, piktorët grabovarë të familjes së madhe Katro (Çetiri), Gjergji dhe Jani me bijtë dhe nipat e tyre, që e zgjatën veprimtarinë deri aty nga gjysma e shek. XIX.

Në të njëjtin shekull të XVIII zhvillojnë veprimtarinë e vet në zonën e Gjirokastrës piktorë si Jani dhe i biri Vasili (mb. 607, 610, 612 etj.), nga Qesarati (Sinkriati) i Lunxhërisë, që kanë stolisur me piktura murale dhe ikona 12 kisha midis viteve 1758-1799.

Së fundi shënojmë se si në shek. XVII-XVIII, edhe nga mbishkrimet e shek. XIX bien në sy edhe një numër piktorësh grekë që punojnë gjatë kësaj kohe nëpër kishat e jugut të vendit tonë. Origjina e këtyre piktorëve është nga Fjonjati (Hjonadhës), Samarina e Postenali i Pogonjanisë, (nga Postenani i Kolonjës) (mb. 743, 747, 748, 749, 200).

Materialet epigrafike formojnë kështu dokumenta historike të rëndësishme për të njohur pikturën kishtarë të vendit tonë. Nga ato rezulton një kuadër mjaft i plotë i kësaj veprimtarie, i dokumentuar me emra dhe data që prej gjysmës së parë të shek. XIV e deri nga mesi i shek. XIX.

Pranë artit piktoral një vend me rëndësi zë edhe arti i aplikuar. Në shumë objekte të kultit të krishterë, siç janë ikonostaset amvonet, thronet peshkopale, proshqinitarët, polielejt, potirët, kryedet, kapakët e ungjijve, thimiatonët, amfiat, epitafet, kalimata etj., takohen mbishkrime të gdhendura në dru, të gravuara në metal ose të qëndisura në pëlhurë. Prania e këtyre mbishkrimeve, me të dhëna të ndryshme biografike-historike, fiton një interes të veçantë, se na bën të njihemi me mjeshtrë të dalluar, krijues të një pune të hollë artistike, ajo kontribuon për zbulimin e traditave të vendit në këto fusha të aktivitetit artizanal e artistik, sepse në pjesën më të madhe ato janë punime të mjeshtrëve të shkollave të vendit.

Përsa i përket artit të punimit të drurit, shënojmë se nëpër kishat e vendit tonë ruhen sot përmbi 50 ikonostase druri të shoqëruara me amvone, throne peshkopale e proshqinitarë, të gjitha të gdhendura artistikisht në dru. Mjerisht jo të gjitha këto objekte artistike ruajnë mbishkrime me të dhëna mbi mjeshtrët e punimit e mbi datat e punimit.

Mbishkrime mbi ikonostaset e gdhendura të kishave tona takohen qysh prej shek. XVIII si p. sh. tek ikonostasi i Kishës së shën Kollit të Voskopojës, me datë 1743 (mb. 344), i Kishës së Manastirit të Shën Pjetrit në Vithkuq me datë 1773 (mb. 375) të Shën Mërisë së Dragotit të Dumresë, me datë 1785 (mb. 161), të Shën Vlashit në Vlorë dhe të Shën Gjergjit në Fier, të dy me datë 1786 (mb. 162).

Nga ikonostaset e shumta të punuara gjatë shek. XIX, vetëm 14 ruajnë mbishkrime me datat e gdhendjes. Megjithëkëtë në mjaft raste kjo datë mund të përcaktohet me përafërsi, kur

njihet data e ndërtimit të kishës; kështu shtohet mundësia për të njohur më mirë periodat e krijimit të motiveve ose të formave, sidomos të atyre me karakter vendas, në artin e veçantë por shumë interesant të gdhendjes së drurit.

Nga mbishkrimet rezulton se ndonjë ikonostas është punuar edhe me torno, si p. sh. ai i Kishës së Shën Mërisë në Elbasan, me datë 1859 (mb. 63).

Përsa u përket mjeshtërive të dalluar të punimit të ikonostaseve prej druri, ata që përmenden nga mbishkrimet janë relativisht të vonë, si Usta Naumi nga Lavdari i Oparit, i cili më 1849 ka gdhendur ikonostasin e Kishës Fjetja e Shën Mërisë në Kala të Beratit (mb. 226), e më vonë ato të një vargu kishash të tjera në Shqipëri të Mesme e të Jugut (mb. 232, 271) etj. Përmenden gjithashtu Kostë Tuni Mecoviti, që ka gdhendur ikonostasin e Kishës së Shën Mërisë në Labovë të Kryqit më 1805 (mb. 666), Andon Korfuzioti, që ka punuar më 1758 (mb. 359), Mitro Fandi më 1842 (mb. 716) etj.

Të dhëna për një tjetër gjini arti të aplikuar me tradita të lashta në vendin tonë japin mbishkrimet e objektet prej argjendi. Punimi i argjendit duhet të jetë shumë i lashtë në vendin tonë për objekte të tilla të ruajtura deri më sot nuk takojmë më të vjetra se të fillimit të shek. XVII. Nga mbishkrimet mbi këto objekte argjendi (potirë, kryqe, kapakë ungujsh etj.), dalin shumë emra argjendarësh shqiptarë e të huaj, që dallohen për punimet e tyre artistike, si Dhimitër Hrisohu, që ka punuar në 1616 kryqin prej argjendi të Kishës së Shën Spiridonit të Goricës së Beratit (mb. 101). Gjergj Voskopojari, që më 1729 ka punuar kapakët prej argjendi të ungujllit të kishës së Shën Mërisë në Kala të Beratit (mb. 109), Apostoli i Jakovit të Vogël nga Elbasani, që gjatë shek. XVIII ka punuar artistikisht në argjend objekte të shumta të kultit kristian (mb. 48, 198), Janko Voskopojari (mb. 123, 124), Jorgo Kalivioti (mb. 592), Gjergj Jan Mecovitin (mb. 771) etj.

Mbishkrimet na japin të dhëna edhe për artin e qendisjes me ar e argjend në pëlhurë prej lini, shumë i zhvilluar në vendin tonë gjatë shekujve të mesjetës. Këto objekte sot ruhen me pakicë, për arsye të natyrës së tyre të konsumueshme. Megjithëkëtë disa prej tyre kanë një interes të veçantë historik e artistik. I tillë është sidomos epitafi i Gllavenicës, i punuar me art të hollë nga mjeshtri shqiptar Gjergj Arianiti më 1373 (mb. 90), epitafi i Kishës së Shën e Premtes së Përmetit me datë 1776 (mb. 379), i Kishës së Shën Mërisë së Leusës, me datë 1789 (mb. 386), etj.

*

*

*

Me gjithë zbrazëtitë që paraqesin, me gjithë karakterin e kufizuar që kanë, edhe sepse të dëmtuara e të cinguara, materialet epigrafike të kishave të vendit tonë përbëjnë siç u munduam të tregojmë një burim të vlefshëm për historinë e vendit tonë. Ato hedhin dritë mbi fakte të panjohura të traditës së lashtë kulturore të popullit tonë, dhe aty këtu, mund të zgjidhin ndonjë problem historik të rëndësishëm, veçanërisht atëherë kur ka mungesë burimesh arkivore, këto mbishkrime përbëjnë për ne të vetmet materiale dokumentare autentike e të pakontestueshme.

TREGUESI KRONOLOGJIK I MBISHKRIMEVE

- 525 - Datë ndërtimi në kishën Lindja e shën Mërisë, në Labovë të Gjirokastrës (Nr. 517).
- 551 - Mbishkrim ndërtimi në kishën e shën Mërisë, në Labovë të Gjirokastrës (Nr. 518).
- 619 - Mbishkrim ndërtimi në kishën e shën Mërisë, në Peshkopi të Sipërme të Gjirokastrës (Nr. 519).
- 786 - Datë ndërtimi në kishën e shën Sergjit e Bakut, në Himarë (Nr. 801).
- 866 - Mbishkrimi për konvertimin në krishtërim të carit bullgar Borisit dhe të popullit bullgar (Nr. 82).
- Shek. IX-X - Mbishkrim lutjeje, në gërmadhat e kishës së dyzet të shenjtorëve, Sarandë (Nr. 901).
- 1015 - Ditë ndërtimi në kishën e shën Mërisë, në Lubonjë të Kolonjës (Nr. 398).
- 1032 - Mbishkrim në vulën e Manastirit, Fjetja e shën Mërisë, në manastirin Kamenë të Delvinës (Nr. 802).
- Shek. XI - Mbishkrim pikturimi në shpellën kishë, në Letëm të Çermenikës (Nr. 77).
- 1142 - Mbishkrim ndërtimi në kishën e shën Kollit, në Peshtan të Përmetit (Nr. 449).
- 1159 - Datë ndërtimi në kishën e Shën Mitrit, në Potkozhan të Mokrës Pogradec (Nr. 1).
- Shek. XII - Lutje ktitori, në shpellën e Arangjelit, pranë Purtecit të Prespës (Nr. 512).
- Shek. XIII - Mbishkrim dhurate, në narteks të kishës së shën Mitrit, në Bezmisht të Prespës (Nr. 516).
- 1240 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Ndojt, në Lesh (Nr. 912).
- 1250 - Datë vorri mbi një gur mbi apsidën e kishës së Shën Mërisë së Apolonisë (Nr. 84).
- 1290 - Mbishkrim ndërtimi në Kishën e shën Sergeit e Bakut, në Shirgj të Shkodrës (Nr. 913 e 914).
- 1292 - Datë pikturimi në Kishën e shën Mërisë së Apolonisë (Nr. 85).
- Shek. XIII - Tekst ilitazioni, nga kisha e Vaut të Dejës, pranë Shkodrës (Nr. 926).
- Shek. XIII - Mbishkrim në fragment, në eksonarteks të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Apolonisë, pranë Fierit (Nr. 88).
- Shek. XIII - Mbishkrimet mbi pikturën e perandor Mihail Paleologut në eksonarteks të kishës së Manastirit të Shën Mërisë së Apolonisë, pranë Fierit (Nr. 87).
- Shek. XIII - Mbishkrimi mbi pikturën e Andronikut II Paleolog, në eksonarteks të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Apolonisë, pranë Fierit (Nr. 86).
- Shek. XIII - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Salvatorit, në Rubik të Rrëshenit (Nr. 918).
- 1345 - Mbishkrim dhurate, në pikturën e apsidës së kishës së shën Mërisë, në Maligrad (Nr. 286).
- 1350 - Mbishkrim varri i murosur në eksonarteksin e kishës së Manastirit të shën Mërisë së Apolonisë, pranë Fierit Nr. 89).
- 1369 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e shën Mërisë në Maligrad të Prespës (Nr. 287).
- 1373 - Mbishkrim i epitafit të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Gllavenicës, gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 90).
- 1381 - Mbishkrim rindërtimi, të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 3).
- 1381 - Mbishkrim rindërtimi, të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit pranë Elbasanit. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 2).
- 1389 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Ristosit në Mborje të Korçës (Nr. 290).

- 1392 - Mbishkrim dhurate në korridorin e kishës së Manastirit të shën Mërisë së Apolonisë, pranë Fierit (Nr. 85).
- Shek. XIV - Mbishkrim këmbane gjetur në Sopot të Elbasanit (Nr. 69). Gjendet në Muzeun e Elbasanit.
- Shek. XIV - Mbishkrimi në stemën e Karl Topisë, gjendej në kishën e Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit. Tani gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 5).
- Shek. XIV - Mbishkrimi i kohës së rindërtimit të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 4).
- Shek. XIV - Mbishkrimi me shprehje dogmatike në kishën e shën Mërisë së Maligradit (Nr. 288).
- Shek. XIV - Sinjaturat pranë pikturës së familjes së Kezar Novakut, në kishën e shën Mërisë së Maligradit (Nr. 289).
- Shek. XIV - Mbishkrim lutje ktitori në kishën e Ristosit në Mborje të Korçës (Nr. 291).
- Shek. XIV - Mbishkrim me emrin e ktitorit, në Kishën e Ristozit në Mborje (Nr. 292).
- Shek. XIV - Mbishkrim në kupën e gurit të pagëzimit, në Kishën e Manastirit të shën Mërisë së Apolonisë (Nr. 285).
- Shek. XIV - Mbishkrim ndërtimi, nga Manastiri i shën Mërisë së Glavenicës (Ballshit) (Nr. 277).
- Shek. XIV - Mbishkrim pikturimi, në shpellën e shën Mërisë në Gllobovo, pranë Beznishtit të Prespës (Nr. 511).
- Shek. XIV - Mbishkrim, në kishën e shën Kollit Nënshatit, pranë Shkodrës (Nr. 924).
- Shek. XIV - Mbishkrim pikturimi, në shpellën e shën Mërisë në Gllobovo, pranë Beznishtit të Prespës (Nr. 513).
- Shek. XIV-XV - Mbishkrim dhurate në ikonën e shën Mërisë, të kishës së Shën Kostandinit dhe Elenës në Kala të Beratit (Nr. 282).
- Shek. XIV-XV - Mbishkrim, në kishën e Dom Lleshit, në Lezhë (Nr. 927).
- 1447 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kryq të kishës së Abacisë së shën Aleksandrit të Oroshit (Nr. 915).
- 1462 - Mbishkrim lutje, në kishën e Baldresë, pranë Lezhës (Nr. 914).
- 1462 - Datë këmbane, në një këmbanë që konsiderohet e kishës së Kastriotëve në Krujë. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar (Nr. 6).
- 1465 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Markut, në Kala të Vaut të Dejës (Nr. 916).
- Shek. XIV-XV - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Gjergjit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 514).
- Shek. XV - Mbishkrim në vulën e peshkopatës së Stephaniakës dhe Bendës (Nr. 925).
- Shek. XV-XVI - Mbishkrim varri në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Zvernec të Vlorës (Nr. 278).
- 1510 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Peshkopi të Sipërme të Gjirokastrës (Nr. 520).
- 1513 - Mbishkrim pikturimi (?) në kishën e shën Thanasit, në Poliçan të Pogonit (Nr. 521).
- 1525 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Gjergjit, në Leshnicë të Sipërme të Sarandës (Nr. 803).
- 1525 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Pecë të Sarandës (Nr. 804).
- 1526 - Mbishkrim rindërtimi dhe pikturimi, në Kishën e shën Mitrit, në Poliçan të Pogonit (Nr. 522).
- 1538 - Mbishkrim lutje, në kishën e shën Mitrit, në Poliçan të Pogonit (Nr. 523).
- 1554 - Nënshkrim në një ungjill, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Stegopull të Lunxhërisë (Nr. 524).
- 1554 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën e Premtes, në Valësh të Shpatit (Nr. 15).
- 1557 - Mbishkrimi konsakririmi, në kishën e Shna Ndojt, në Laç të Krujës (Nr. 919).
- 1560 - Mbishkrim rindërtimi ikonostasi, në kishën e shën Sotirit, në Tremisht të Përmetit (Nr. 295).
- 1562 - Datë ndërtimi, në një altar, pranë kishës së Dom Lleshit, në Lezhë (Nr. 920).
- 1565 - Datë ndërtimi, e vjetër, në kishën e shën Gjergjit, në Lugar të Dropullit (Nr. 525).
- 1569 - Mbishkrim ndërtimi të kolonave, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 526).
- 1576 - Mbishkrim dhurate, në pikturën murale të kishës së Manastirit të Panaisë, mbi Dhërmi

- të Himarës (Nr. 805).
- 1578 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Vlahernës, në Berat (Nr. 92).
- 1580 - Datë ndërtimi, kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Kamenë të Delvinës (Nr. 806).
- 1582 - Datë ndërtimi, në Manastirin e Ungjillëzimit, në Vanitë të Dropullit (Nr. 527).
- 1583 - Datë ndërtimi, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Zervat të Dropullit (Nr. 528).
- 1584 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit, të shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 529).
- 1586 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Jergucat të Dropullit të Sipërm (Nr. 530).
- 1588 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Qiriakut e Julitës, mbi Dhuvjan të Dropullit të Poshtëm (Nr. 531).
- 1591 - Mbishkrim rindërtimi dhe ripikturimi, në kishën e shën Kollit pranë Vlahernës, në Kala të Beratit (Nr. 95).
- 1594 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Kollit të Kishës së shën Kollit, pranë Vllahernës, në Kala të Beratit (Nr. 96, 97).
- 1595 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Qiriakut e Julitës, mbi Dhuvjan të Dropullit të Poshtëm (Nr. 532).
- 1596 - Nënshkrimi i piktor Onufrit Qiprioti në një ikonë të kishës së shën Gjergjit në Berat (Nr. 97).
- 1597 - Mbishkrim ndërtimi dhe pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Kodrës, pranë Tepelenës (Nr. 298).
- 1599 - Mbishkrim lutje, në ikonën e Pagëzorit, të marrë nga kisha e shën Kostandinit dhe Elenës, në Berat (Nr. 98).
- Shek. XVI - Mbishkrim i fragmentuar në kishën e shën Premtes, në Valësh të Shpatit (Nr. 15).
- Shek. XVI - Mbishkrim me një kërkesë të piktor Onufrit, në prothes të kishës së shën Premtes, në Valësh të Shpatit (Nr. 14).
- Shek. XVI - Lutje liturgjike, në këngë të kishës së shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 12).
- Shek. XVI - Lutje liturgjike, mbi derën veriore të ikonostasit të kishës së shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 11).
- Shek. XVI - Kombinim vargjesh nga psallmi 24 mbi derën e bukur të ikonostasit të kishës së shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 10).
- Shek. XVI - Lutje liturgjike, në ikonostasin e kishës së shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 10).
- Shek. XVI - Lutje liturgjike, në ikonostasin e kishës së shën Kollit në Shelcan (Nr. 9).
- Shek. XVI - Pjesë e një lutje nga mesha e Gjon Gojartit, në ikonostasin e kishës së shën Kollit, në Shelcan (Nr. 8).
- Shek. XVI - Mbishkrim me një kërkesë të piktorit, në kishën e shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 7).
- Shek. XVI - Mbishkrim që rekomandon ndërrimin e shenjtorëve në kishën e shën Sotirit, në Tremisht të Përmetit (Nr. 296).
- Shek. XVI - Tekst ungjillor i modifikuar dhe lutje në kishën e shën Sotirit, në Tremisht të Përmetit (Nr. 297).
- Shek. XVI - Mbishkrimi përmban një kërkesë të piktorëve, në kishën e shën Kollit, në Kurjan të Fierit (Nr. 94).
- Shek. XVI - Kërkesë e piktor Nikollës, birit të Onufrit, në kishën e shën Mërisë së Vllahernës, në Kala të Beratit (Nr. 93).
- Shek. XVI - Mbishkrim dhurate, mbrapa një ikone të shën Mërisë, të kishës së Vllahernës, në Kala të Beratit (Nr. 96).
- Shek. XVI-XVII - Mbishkrim pikturimi në kishën e shën Kollit në Tepar, pranë Ogrenit të Përmetit (Nr. 498).
- 1600 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Ravenjës, në Dropull (Nr. 533).
- 1601 - Mbishkrim dhurate, në kishën e Manastirit të shën Thanasit, në Poliçan të Pogonit (Nr. 534).
- 1604 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mërisë, në Voskopojë (Nr. 300).
- 1604 - Mbishkrim dhurate, në dyert e bukura të ikonostasit të kishës së shën Mërisë së

- Maligradit (Nr. 299).
- 1604 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e shën Kollit, në Valësh të Shpatit (Nr. 16).
- 1603 - Mbishkrim rindërtimi dhe pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Mavrodhivri të Sarandës (Nr. 807).
- 1604 - Mbishkrim dhurate në ikonën e Krishtit të kishës së shën Kostandinit e Elenës, në Berat (Nr. 99).
- 1604 ose 1611 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 535).
- 1605 - Datë rindërtimi, në kishën e shna Ndojt në Laç të Milotit (Nr. 922).
- 1606 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Zrrvat të Dropullit (Nr. 536).
- 1606 - Mbishkrim pikturimi, në fasadën e kishës së shën Mërisë së Maligradit (Nr. 301).
- 1607 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mitrit, në Kala të Beratit (Nr. 100).
- 1610 - Mbishkrim rindërtimi e pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Durhar të Oparit (Nr. 302).
- 1614 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së Manastirit të shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 537).
- 1615 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e krishtit, të kishës së Manastirit të shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 538).
- 1615 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Shpërfytyrimit të kishës së shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 539).
- 1616 - Datë punimi argjendi, në një kryq të kishës së shën Spiridhomit, në Berat (Nr. 101).
- 1616 - Mbishkrim pikturimi, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Barmash të Kolonjës (Nr. 303).
- 1617 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Jergucat të Dropullit (Nr. 540).
- 1617 - Mbishkrim rindërtimi dhe pikturimi, në kishën e shën Mërtirit të Tranoshishtës, në Lunxhëri (Nr. 541).
- 1617 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit Ungjillëzimit në Vanistë të Dropullit (Nr. 542).
- 1620 - Nënshkrim i jeromonak Neofitit, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 543).
- 1620 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Mëhillit, në Delvinë të Shqerisë së Përmetit (Nr. 304).
- 1621 - Mbishkrim lutje, në kishën e Manastirit të shën Mërisë në Goranxi të Dropullit (Nr. 544).
- 1622 - Datë punimi argjendi, në një potir të kishës së shën Mërisë, në Golem të Lushnjes (Nr. 102).
- 1622 - Mbishkrim vule, në vulën e Manastirit të shën Mërisë së Ravenjës mbi Goranxi të Dropullit (Nr. 546).
- 1622 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Vllahogoranxi të Gjirokastrës (Nr. 547).
- 1623 - Datë, në ikonën e Pagëzorit të kishës së shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 548).
- 1623 - Mbishkrim rindërtimi dhe pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Thanasit, në Muzinë të Sarandës (Nr. 808).
- 1623 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të Spilesë, mbi Saraqinisht të Lunxhërisë (Nr. 549).
- 1624 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Stegopull të Lunxhërisë (Nr. 550).
- 1625 - Mbishkrim ripikturimi në kishën e shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 17).
- 1625 - Mbishkrim dhurate, në kishën e shën Kollit, në Saraqinisht të Lunxhërisë (Nr. 551).
- 1626 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Sotirit, në Çatistë të Pogonit (Nr. 552).
- 1628 - Datë dorëzimi diakon, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 555).
- 1628 - Mbishkrim lutje, në kishën e Manastirit të shën Thanasit, në Poliçan të Pogonit (Nr.

- 554).
- 1630 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Spilesë, në Saraqinishtë të Lunxhërisë (Nr. 556).
- 1630 - Datë dorëzimi prift, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 557).
- 1630 - Mbishkrim punimi kryqi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 558).
- 1632 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e shën Kollit, në Melan të Përmetit (Nr. 305).
- 1632 - Mbishkrim rindërtimi, në kishën e Manastirit të shën Prodhromit, në Voskopojë (Nr. 306).
- 1634 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të Spilesë, në Saraqinishtë të Lunxhërisë (Nr. 559).
- 1641 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit, të kishës Fjetja e shën Mërisë, në Delvinë (Nr. 809).
- 1642 - Mbishkrim me emrin e një farë jeronomak Marku, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Thanasit, në Polenë të Sipërme të Korçës (Nr. 307).
- 1644 - Datë pikturimi, në kishën e shën Kostandinit dhe Elenës, në Berat (Nr. 103).
- 1650 - Mbishkrim mbi larjen e borxheve të Manastirit, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 560).
- 1651 - Mbishkrim punimi argjendi, në thimiatonin e kishës së Manastirit të shën Mërisë së Drianos (Nr. 595).
- 1652 - Datë pikturimi, në kishën e shën Kollit, në Leshnjë të Vithkuqit (Nr. 308).
- 1653 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Stegopull të Lunxhërisë (Nr. 561).
- 1653 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 309).
- 1656 - Datë ndreqje, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 562).
- 1657 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit, të kishës së shën Thanasit, në Dhuvjan të Dropullit (Nr. 563).
- 1659 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Prodhromit në Voskopojë (Nr. 306).
- 1659 - Mbishkrim ndërtimi dhe pikturimi, në marteks të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Spilesë, në Saraqinishtë të Lunxhërisë (Nr. 564).
- 1659 - Mbishkrim antiminsi, në kishën e shën Mërisë së Drianos, në Dropull të Sipërm (Nr. 565).
- 1660 - Datë pikturimi, në një ikonë të shën Gjergjit në kishën e Manastirit të Ardenicës (Nr. 107).
- 1660 - Mbishkrim dhurate, në një thimiaton, në Katedralen Fjetja e shën Mërisë e Beratit (Nr. 106).
- 1660 - Mbishkrim dhurate në një kryq argjendi të eksapergave në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Kala të Beratit (Nr. 104).
- 1660 - Mbishkrim dhurate, në potirin e kishës së shën Mërisë, në Dhuvjan të Dropullit të Poshtëm (Nr. 566).
- 1661 - Mbishkrim pikturimi, në një ikonë të shën Mërisë, të kishës së shën Gjergjit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 310).
- 1662 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit Fjetja e shën Mërisë, në Kamenë të Delvinës (Nr. 810).
- 1669 - Datë në një ikonë të shën Mërisë, në kishën e Senicës së Korçës (Nr. 311).
- 1666 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Sotirit, në Drenovë të Mingulit të Lunxhërisë (Nr. 567).
- 1669 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Sotirit, në Hoshtevë të Zagorisë (Nr. 568).
- 1669 - Datë pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë në Koshovicë të Dropullit (Nr. 569).
- 1671 - Mbishkrim pikturimi, në prothes të kishës së shën Thanasit, në Dhërmi të Himarës (Nr. 811).

- 1671-1672 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të Profit Ilisë, në Stegopull të Lunxhërisë (Nr. 560).
- 1672 - Mbishkrim punimi argjendi në një kryq, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos (Nr. 570).
- 1672 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Piqeras të Sarandës (Nr. 812).
- 1672 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit, Fjetja e shën Mërisë të Kokomesë, pranë Sarandës (Nr. 813).
- 1672 - Mbishkrim mbi djegien e qelisë Padana, në kishën e shën Venerandës në Plavë të Milotit (Nr. 923).
- 1672 - Mbishkrim lutje, në kishën e Manastirit të Kakomesë, pranë Sarandës (Nr. 814).
- 1674 - Mbishkrim pikturimi, në narteks të kishës së Manastirit të Kamenës, pranë Delvinës (Nr. 815).
- 1675 - Mbishkrim dorëzimi, të një diakoni në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit të Sipërm (Nr. 571).
- 1678 - Datë ndërtimi, mbi portën e kishës së profit Ilisë, në Boboshticë të Korçës (Nr. 312).
- 1679 - Datë e një kryqi argjendi, në kishën e shën Kollit, në Elbasan (Nr. 19).
- 1679 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Gjergjit, në kishën e Manastirit të shën Kollit, në Dhivri të Sarandës (Nr. 816).
- 1680 - Mbishkrim pikturimi, në ikonostasin prej druri të kishës së Manastirit të shën Mërisë, në Dhivrovuni të Delvinës (Nr. 817).
- 1682 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Mëhillit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 313).
- 1682 - Mbishkrim pikturimi, në narteks të kishës së Manastirit të Ipandisë, në Leshnicë të Sipërme të Sarandës (Nr. 818).
- 1682 - Mbishkrim pikturimi, në narteks të kishës së Manastirit Ipandi, në Leshnicë të Sipërme të Sarandës (Nr. 819).
- 1682 - Mbishkrim pikturimi, pranë portës së kishës së Manastirit Ipandi, në Leshnicë të Sipërme të Sarandës (Nr. 820).
- 1684 - Mbishkrim dhurate mbi derën e bukur të kishës së Ungjillëzimit në Vithkuq (Nr. 315).
- 1685 - Datë në ikonën e shën Mërisë, të kishës së Ungjillëzimit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 316).
- 1685 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Pagëzorit, të kishës së shën Gjergjit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 318).
- 1685 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kryq të kishës së Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 572).
- 1686 - Datë në rozetën e gurtë të kishës së Manastirit të shën Kollit, në Boboshticë të Korçës (Nr. 319).
- 1689 - Mbishkrim dhurate, në apsidë të kishës së Ungjillëzimit, në Dhërmi të Himarës (Nr. 821).
- 1689 - Mbishkrim dhurate, pranë pikturës murale në kishën e shën Gjon Theologut, në Dhërmi të Himarës (Nr. 822).
- 1690 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Gjergjit të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Ardenicës (Nr. 107).
- 1679 - Datë punimi argjendi, në kishën e shën Kollit, në Elbasan (Nr. 19).
- 1690 - Datë ndërtimi, në kishën e shën e Premtes, pranë Kavajës (Nr. 21).
- 1693 - Datë e pikturimit të ikonave të kishës së Kosovës së Madhe, pranë Lushnjës (Nr. 22).
- 1694 - Datë pikturimi në ikonën e sh. Vlashit të kishës së Manastirit të shën e Vlashit, pranë Durrësit (Nr. 24).
- 1694 - Datë pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së Shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës (Nr. 23).
- 1696 - Mbishkrim ndërtimi ikonostasi, në kishën e Fjetjes së shën Mërisë, në Ogren të Përmetit (Nr. 320).
- 1696 - Mbishkrim dhurate, në pikturën murale të kishës së Ungjillëzimit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 321).
- Shek. XVII - Mbishkrim pronësie në eksaptergat, në katedralen e Beratit Fjetja e shën Mërisë (Nr. 105).

- Shek. XII - Vargje epitafi të mbivonshëm, në gurin me mbishkrimin Nr. 82 nga gërmadhat e kishës së shën Mërisë, në Ballsh të Mallakastrës (Nr. 83).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate në ikonën e shën Naumit, të kishës së Ungjillëzimit, në Tiranë (Nr. 81).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në kungë të kishës së shën Mitrit, në Potkozhan të Mokrës (Nr. 71).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi, në kungë të kishës së Shën Mitrit, në Potkozhan të Mokrës (Nr. 70).
- Shek. XVII - Mbishkrim ndërtimi dhe pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës (Nr. 20).
- Shek. XVII - Mbishkrim Klitorial, në pikturën e vonë të kishës së shën Kollit, në Shelcan të Shpatit (Nr. 18).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në ikonën e krishtit, në Kishën e shën Mëhillit, në Vithkuq (Nr. 314).
- Shek. XVII - Nënshkrimi i daskal Kostandinit, në ikonën e shën Gjon Pagëzorit të kishës së Ungjillëzimit, në Vithkuq (Nr. 317).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Ravenjës, në Dropull (Nr. 545).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në kishën e Manastirit të shën Thanasit, në Boliçan të Pogonit (Nr. 770).
- Shek. XVII - Nënshkrimi i Mitropolit Jakovit të Zihnës në kishën e Manastirit të shën Sotirit të Çatistës së Pogonit (Nr. 553).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit, në kishën e shën Mëhillit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 502).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Mërisë të Kishës së Pagëzorit, në Lëshicë të Përmetit (Nr. 505).
- Shek. XVII - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Mërisë, në Shalës të Kolonjës (Nr. 506).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Gjergjit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 509).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Kollit, në Saraqinisht të Lunxhërisë (Nr. 794).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Pagëzorit të kishës së shën Kollit, në Saraqinishtë të Lunxhërisë (Nr. 795).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi në kungë të kishës së shën e Premtes, në Dhërmi të Himarës (Nr. 911).
- Shek. XVII - Mbishkrim pikturimi në kubën e kishës së Manastirit të Panaisë, mbi Dhërmi të Himarës (Nr. 906).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Kollit të kishës së shën Kollit, në Saraqinishtë të Lunxhërisë (Nr. 796).
- Shek. XVII - Mbishkrim dhurate, në pikturën e narteksit të kishës së Manastirit të shën Sotirit, në Mingul të Lunxhërisë (Nr. 787).
- Shek. XVII - Tri shifra të padeshifruara të kishës së shën e Premtes në Lukovë të Sarandës (Nr. 900).
- Shek. XVII-XVIII - Mbishkrim dhurate, në potirin e kishës së Manastirit të Drianos, në Dropull (Nr. 785).
- Shek. XVII-XVIII - Mbishkrim punimi me sadef, në kamalecin prej druri të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 772).
- Shek. XVII-XVIII - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Profet Ilisë, të kishës së Profit Ilisë, në Boboshticë (Nr. 508).
- 1701 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Kollit e të shën Spiridhonit, në Muzeun e artit mesjetar, Korçë (Nr. 322).
- 1702 - Nënshkrimi i jeronomak Danilit, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos në Dropull (Nr. 573).
- 1702 - Mbishkrim dhurate, në kishën e shën Kollit, në Nivan të Zagorisë (Nr. 574).
- 1703 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Gjergjit e të shën Mitrit të kishës së shën Mërisë, në Voskopojë (Nr. 323).

- 1707 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e vjetër "Burimi jetëdhënës", në Korçë (Nr. 329).
- 1710 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit, të kishës së Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 325).
- 1710 - Mbishkrim dhurate në ikonën e shën Mërisë, të kishës së Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 324).
- 1712 - Mbishkrim pikturimi, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Voskopojë (Nr. 326).
- 1715 - Datë pikturimi, në hajatin e kishës së shën Mërisë, në Voskopojë (Nr. 328).
- 1715 - Mbishkrim dhurate, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Zervat të Dropullit të Sipërm (Nr. 575).
- 1717 - Datë e punimit të proshqinitarit të kishës së shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës (Nr. 25).
- 1717 - Mbishkrim dhurate, në një kryq argjendi, të kishës së shën Spiridhonit, në Goricë të Beratit (Nr. 108).
- 1717 - Mbishkrim dhurate qëndisur në një mbulesë kungate, në kishën e shën Pjetrit, në katundin shën Pjetër të Fierit (Nr. 112).
- 1718 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e apostojve Pjetrit e Pavlit të kishës së këtyre apostujve, në Dhrovjan të Sarandës (Nr. 823).
- 1721 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Thanasit, në Kucak të Oparit (Nr. 332).
- 1721 - Mbishkrim ndërtimi, në muret jashtë kishës së shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 330).
- 1721-1722 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 331).
- 1722 - Mbishkrim ndërtimi dhe pikturimi, në kishën e shën Mëhillit, në Voskopojë (Nr. 333).
- 1724 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 336).
- 1724 - Tekst ungjillor, në kishën e shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 337).
- 1724 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 335).
- 1724 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 335).
- 1725 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mëhillit, në Voskopojë (Nr. 341).
- 1725, 1740, 1745, 1756 - Datat e kandileve prej argjendi të kishës së Manastirit të Ardenicës (Nr. 122).
- 1726 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 331).
- 1728 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mëhillit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 312).
- 1728 - Mbishkrim pronësie, në një kuti lipsanash, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 576).
- 1729 - Datë punimi argjendi, në një thimiaton prej argjendi, në kishën e shën Mërisë, në Elbasan (Nr. 26).
- 1729 - Mbishkrim dhurate, në kapakët argjendi të ungjillit të Katedrales së Beratit (Nr. 109).
- 1730 - Datë ndërtimi në murin e kuzhinës së Manastirit të Ardenicës (Nr. 110).
- 1731 - Mbishkrim në katër gjuhë, në ikonën e shën Mërisë në gravurë, që gjendej në Manastirin e Ardenicës (Nr. 111).
- 1732 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Goranxi të Dropullit (Nr. 577).
- 1732 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Gjergjit, në Rehovë të Kolonjës (Nr. 343).
- 1734 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kuti lipsanash në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Driano të Dropullit (Nr. 578).
- 1736 - Mbishkrim ndërtimi, mbi portën e qimiterit të Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 354).
- 1736 - Nënshkrim i jeromonak Danielit, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 579).
- 1736 - Mbishkrim ndërtimi dhe pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Kollit, në Dhivër të Sarandës (Nr. 824).
- 1736 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Pagëzorit të kishës së Manastirit të shën Qiriakut e Julitës, në Dhuvjan të Dropullit (Nr. 580).
- 1737 - Datë qëndisje në Kishën e shën Pjetrit, në shën Pjetër të Fierit (Nr. 112).
- 1737 - Mbishkrim në kryqin e ikonostasit, të kishës së shën Mërisë në Zervat të Dropullit (Nr. 581).
- 1738 - Datë këmbane, në kishën e Manastirit, të Ardenicës, në Myzeqe (Nr. 113).

- 1739 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Gjon Vladimirit të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Ardenicës (Nr. 114).
- 1739 - Mbishkrim dhurate, në një kandile argjendi të kishës së Manastirit të shën Mërisë së Drianos, në Dropull (Nr. 582).
- 1743 - Mbishkrim pronësie, në një ungjill me kapakë argjendi të kishës së shën Kollit, në Sadovicë të Beratit (Nr. 116).
- 1743 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Ardenicës (Nr. 115).
- 1743 - Datë ndërtimi, mbi portën e kishës Fjetja e shën Mërisë, në Niçë të Gorës (Nr. 28).
- 1743 - Datë ikonostasi, në kishën e shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 344).
- 1743 - Datë në kapakët prej copash argjendi të një ungjilli të kishës së shën Gjergjit, në Llengë (Nr. 27).
- 1744 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 345).
- 1744 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit të kishës së Manastirit të Ardenicës (Nr. 120).
- 1744 - Mbishkrim pikturimi, në prothes të kishës së shën e Premtes, në Dhërmi të Himarës (Nr. 825).
- 1744 - Mbishkrim rindërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Ardenicës (Nr. 117).
- 1744 - Datë pikturimi, në ikonën e shën Mërisë, në Manastirin e Ardenicës (Nr. 119).
- 1745 - Mbishkrim pikturimi, mbi hajatin e kishës së shën Thanasit, në Voskopojë (Nr. 346).
- 1745 - Mbishkrim pronësie, në një skeptër argjendi, në katedralen e Beratit (Nr. 123).
- 1745 - Mbishkrim pronësie, në një ungjill të Manastirit të Ardenicës (Nr. 121).
- 1747 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Përmet (Nr. 348).
- 1747 - Mbishkrim kryqi argjendi, në kishën e shën Kollit, në Sadovicë të Beratit (Nr. 124).
- 1748 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit, në qimiter të Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 349).
- 1748 - Datë me një kryq argjendi, në kishën e shën Mërisë, në Elbasan (Nr. 29).
- 1749 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Pjetrit, në katundin shën Pjetër të Fierit (Nr. 125).
- 1750 - Mbishkrim pikturimi, mbi hajatin e kishës së shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 352).
- 1750 - Mbishkrim pikturimi, mbi portën e qimitarit të Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 354).
- 1750 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Naumit të kishës së shën e Premtes, në Përmet (Nr. 355).
- 1750 - Datë pikturimi, në ikonën e shën Naumit, në kishën e Ungjillëzimit (Nr. 30).
- 1750 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Triadhës, në Pepel të Dropullit (Nr. 583).
- 1751 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Ipapandisë, në Dhërmi të Himarës (Nr. 826).
- 1751 - Mbishkrim me emrin e peshkopit të Glavenicës Nikifor Agavatit, gjetur në Ballsh të Mallakastrës (Nr. 127).
- 1752 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit të kishës Burimi jetëdhënës në Korçë (Nr. 356).
- 1752 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e 12 Apostujve, në Voskopojë (Nr. 357).
- 1752 - Datë pikturimi, në hajatin e kishës së shën Thanasit, në Llengë të Mokrës (Nr. 31).
- 1752 - Datë pikturimi, në ikonën e Krishtit, në ikonostasin e kishës së Manastirit të shën Marenës, në Llengë të Mokrës (Nr. 32).
- 1754 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Marenës, në Llengë të Mokrës (Nr. 34).
- 1754 - Datë ndërtimi, mbi kolonën e hajatit të kishës së Manastirit, të Ardenicës (Nr. 128).
- 1754 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Triadhës së Pepelit, në Dropull (Nr. 584).
- 1755 - Mbishkrim punimi argjendi, në kapakë ungjilli të kishës së shën Spiridhonit, në Berat (Nr. 129).
- 1755 - Datë ndërtimi, në kishën e shën e Premtes, në Selckë të Pogonit (Nr. 585).
- 1756 - Mbishkrim punim argjendi, në kapakët e ungjillit të kishës së shën Kollit, në Voskopojë (nr. 358).

- 1757 - Datë ndërtimi i kishës së shën Pjetrit, në shën Pjetër të Fierit (Nr. 131).
- 1757 - Mbishkrim, mbi potir argjendi në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Berat (Nr. 130).
- 1758 - Mbishkrim pikturimi, në narteks të kishës së Manastirit të Ungjillëzimit, në Vanistë të Dropullit (Nr. 584).
- 1758 - Datë punimi e thronit peshkopal, në Kishën e shën Kollit, në Voskopojë (Nr. 359).
- 175? - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Naumit, në kishën e shën e Premtes, në Lushnje (Nr. 126).
- 1759 - Datë ndërtimi, në kishën e Profit Ilisë, në Voskopojë (Nr. 360).
- 1760 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mitrit, në Dhërmi të Himarës (Nr. 827).
- 1760 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Dhionisit, në Voskopojë (Nr. 361).
- 1760 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Sopik të Pogonit (Nr. 587).
- 1761 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit, të kishës së shën Mërisë në Stratobërdë (Nr. 362).
- 1761 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë "Eleusa", të kishës së shën e Premtes, në Dhoksat të Lunxhërisë (Nr. 588).
- 1762 - Mbishkrim dhurate, në një ikonë prej guri të kishës së Gjinikasit, në Opar të Korçës (Nr. 363).
- 1762 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e madhe të kryeengjëjve, të kishës së Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 364).
- 1762 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit, të Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 365).
- 1762 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën Fjetja e shën Mërisë të Kishës së shën Mërisë së Apolonisë (Nr. 132).
- 1763 - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Thanasit, në Piqeras të Sarandës (Nr. 828).
- 1763 - Mbishkrim punimi argjendi, në breroren e ikonës së shën Triadhës, në kishën e Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 366).
- 1764 - Mbishkrim ndërtimi e pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Pjetrit, në Vithkuq (Nr. 367).
- 1764 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Kollit, në Treskë të Kolonjës (Nr. 368).
- 1764 - Mbishkrim punimi argjendi, në ikonën e vjetër të shën Mërisë të kishës së shën Mërisë, në Leusë të Përmetit (Nr. 369).
- 1764 - Nënshkrim i një prifti, në kishën e shën Kollit, në Sopik të Pogonit (Nr. 589).
- 1764 - Mbishkrim punimi argjendi, në një triqer të kishës së Manastirit të Drianos, në Dropull (Nr. 590).
- 1765 - Mbishkrim lutje, në ikonën e Sinodhit të pestë ekumenik, në muzeun e artit mesjetar në Korçë (Nr. 370).
- 1766 - Mbishkrim, në kryqin e kishës së Manastirit të shën Gjergjit, në Mbreshtan të Shpiragut (Nr. 134).
- 1766 - Mbishkrim punimi argjendi, në ikonën e shën Mërisë Spileotisa, të Manastirit të Spilesë, në Lunxhëri (Nr. 591).
- 1766 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kuti lipsanash të kishës së Manastirit të shën Mërisë, në Tërbuq të Rrëzës së Tepelenës (Nr. 592).
- 1767 - Nënshkrim i piktor Kostandin Shpatarakut, në ikonat e Krishtit, të kishës së shën e Premtes në Kavajë (Nr. 137).
- 1767 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Drenovë të Korçës (Nr. 371).
- 1767 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Trijerarkëve të kishës së shën Gjergjit, në Vithkuq të Korçës (Nr. 372).
- 1767 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit, në kishën e shën e Premtes, jashtë Kavajës (Nr. 37).
- 1768 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kuti lipsanash të shën Gjonit, në kishën Lindja e shën Mërisë në Elbasan (Nr. 38).
- 1768 - Datë ndërtimi, në kishën e Ungjillëzimit, në Kozarë të Beratit (Nr. 136).
- 1864 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Tërbuq të Rrëzës së Tepelenës (Nr. 738).
- 1864 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Apostol Pjetrit e Pavlit, në Zhymë të Myzeqesë (Nr. 246).
- 1864 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Gjergjit të ri në kishën e Shpërftyrimit, në Gjirokastër (Nr. 739).
- 1864 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Gjergjit të kishës së Manastirit të Taksiarkëve, mbi Derviçan (Nr. 740).
- 1864 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mitrit të kishës së Manastirit të shën Kollit në Kamenicë të Kolonjës (Nr. 450).
- 1865 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Gjon Vladimirit të kishës së shën Kostandinit dhe Elenës, në Ogren të Përmetit (Nr. 451).
- 1865 - Mbishkrim ndërtimit të Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit (Nr. 61).
- 1866 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Triadhës, në Labovë të Gjirokastrës (Nr. 741).
- 1866 - Mbishkrim pikturimi në ikonostas të kishës së shën Kollit në Grabovë të Elbasanit (Nr. 62).
- 1867 - Datë ndërtimi, mbi këmbanarinë e kishës së shën Mërisë, në Qiparo të Himarës (Nr. 882).
- 1867 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Ungjillëzimit të kishës së Hyrjes së shën Mërisë, në Progër të Korçës (Nr. 452).
- 1868 - Datë rindërtimi, në kishën e shën Gjon Theologut, në Kala të Beratit (Nr. 247).
- 1868 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Artemit të kishës së shën e Premtes, në Hillomo të Pogonit (Nr. 742).
- 1868 - Datë ndërtimi, mbi kambanarinë e kishës së shën Mërisë, në Kosinë të Përmetit (Nr. 453).
- 1869 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kryq të Manastirit të shën Gjon Theologut, Sarandë (Nr. 883).
- 1869 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Shamoll të Korçës (Nr. 454).
- 1869 - Mbishkrim pikturimi, në apsidë të kishës së Manastirit të Taksiarkëve, në Derviçan të Dropullit të Poshtëm (Nr. 743).
- 1869 - Datë ndërtimi, mbi portën e kishës së shën Spiridhonit, në Durrës (Nr. 64).
- 1869 - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e kishës së shën Kostandinit dhe Elenës, në Ogren të Përmetit (Nr. 455).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, mbi portën e kishës së shën Mërisë në Derviçan të Dropullit (Nr. 744).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Pagëzimit të Krishtit të kishës së shën Gjergjit, në Pepel të Dropullit (Nr. 745).
- 1870 - Mbishkrim punimi argjendi, në mbulesën e ikonës së Ipapandisë të kishës së Ipapandisë, në Labovë të Rrëzës së Tepelenës (Nr. 746).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Skore të Pogonit (Nr. 747).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Kryeengjëjve të kishës së shën Thanasit, në Skora të Pogonit (Nr. 748).
- 1870 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Thanasit, në Drenovë të Korçës (Nr. 456).

- 1870 - Datë pikturimi, në paraklisin e shën Kollit, në Nakole, pranë Putecit të Prespës (Nr. 457).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Gjergjit të kishës së shën Kollit, në Senicë të Korçës (Nr. 458).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mitrit, në Skorovodë të Kolonjës (Nr. 459).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Kostandinit dhe Elenës të kishës së shën Mitrit, në Drobonik të Beratit (Nr. 248).
- 1870 - Mbishkrim punimi argjendi, në një potir të kishës së shën Gjergjit në Lushnje të Myzeqesë (Nr. 249).
- 1870 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Thanasit, në Lukovë të Sarandës (Nr. 884).
- 1871 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Shpërfytyrimit të kishës së Manastirit të shën Sotirit, në Drenovë të Mingulit të Lunxhërisë (Nr. 749).
- 1871 - Datë ndërtimi, të kishës së shën Spiridhonit, në Stegopull të Lunxhërisë (Nr. 750).
- 1871 - Mbishkrim pikturimi, në një ikonë të gjithshenjtorëve, në kishën e Triarkëve, në Kakavi të Dropullit (Nr. 751).
- 1871 - Mbishkrim pikturimi, në një ikonë të shën Mërisë, në narteks të kishës së shën Mërisë, në Skore të Pogonit (Nr. 752).
- 1871 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Kostandinit dhe Elenës, të kishës së shën Kozmajt, në Sopik të Pogonit (Nr. 753).
- 1871 - Mbishkrim drugdhendje, në derën e bukur të kishës së shën Mitrit, në Drobonik të Beratit (Nr. 250).
- 1872 - Datë pikturimi në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mitrit, në Skorovodë të Kolonjës (Nr. 459).
- 1873 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Gjergjit, në Pepel të Dropullit (Nr. 754).
- 1873 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Këllëz të Lunxhërisë (Nr. 755).
- 1873 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Minajt, në Sopik të Pogonit (Nr. 756).
- 1873 - Mbishkrim ndërtimi, gjendej në kishën e Ungjillëzimit, në Tiranë (Nr. 65).
- 1873 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shtatë shenjtorëve sllav të kishës së shën Gjergjit, në Kala të Beratit (Nr. 251).
- 1873 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Pagëzorit të kishës së shën Gjergjit, në Pojan të Korçës (Nr. 460).
- 1873 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Glamboç të Prespës (Nr. 461).
- 1874 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Kollit, në Luaras të Kolonjës (Nr. 462).
- 1874 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Trijerarkëve të kishës së shën Thanasit, në Arzë të Kolonjës (Nr. 463).
- 1874 - Mbishkrim antiminsi, në kishën e shën Mërisë, në Badilonjë të Përmetit (Nr. 464).
- 1874 - Mbishkrim punim argjendi, në kapakët e ungjillit të kishës së shën Spiridhonit, në Goricë të Beratit (Nr. 252).
- 1874 - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Kollit, në Vanaj të Myzeqesë (Nr. 253).
- 1875 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Hoskovë të Dropullit (Nr. 757).
- 1875 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën e Premtes, në Vodhinë të Dropullit (Nr. 756).
- 1875 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Ipapandisë të kishës së shën e Premtes, në Hllomo të Pogonit (Nr. 759).
- 1875 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Gjergjit, në Kala të Beratit (Nr. 254).
- 1875 - Datë rindërtimi, mbi portën e kishës së shën Thanasit, në Biçakaj të Vjetër (Myzeqe) (Nr. 255).
- 1875 - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Gjergjit, në Libofshë të Myzeqesë (Nr. 256).
- 1875 - Mbishkrim punim argjendi, në një diskos të kishës së shën Spiridhonit, në Goricë të Beratit (Nr. 257).
- 1875 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Kollit, në Paftal të Beratit (Nr. 259).
- 1875 - Mbishkrim këmbane, në kishën e Ungjillëzimit, në Kozarë të Beratit (Nr. 258).

- 1876 - Datë pikturimi, në ikonën e Ipapandisë të kishës së Ipapandisë në Dhivër të Sarandës (Nr. 885).
- 1876 - Datë pikturimi, në ikonat e kishës së shën Mërisë, në Varrezat e Qesaratit të Lunxhërisë (Nr. 760).
- 1876 - Mbishkrim punimi argjendi, në një kryq të kishës së shën Kollit në Çatistë (Nr. 761).
- 1876 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Todrit në Pevelan të Mokrës (Nr. 66).
- 1877 - Datë drugdhendje, në ikonostasin e kishës së shën Kollit, në Dhrovjan të Sarandës (Nr. 879).
- 1877 - Mbishkrim pikturimi, në një ikonë të kishës së shën Kollit, në Selekë të Pogonit (Nr. 762).
- 1878 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mëhillit të kishës së Manastirit të shën Triadhës, në Pepel të Dropullit (Nr. 763).
- 1878 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Spiridhonit të kishës së shën e Premtes, në Kocat të Leshnicës së Poshtme të Saranës (Nr. 887).
- 1878 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Triadhës, në Dhivër të Sarandës (Nr. 888).
- 1879 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Thanasit, të kishës së shën Thanasit, në Floq të Korçës (Nr. 465).
- 1880 - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Thanasit, në Arzë të Kolonjës (Nr. 466).
- 1881 - Datë ndërtimi, në kishën e shën e Premtes, në Lavdar të Opatit (Nr. 467).
- 1882 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Gjergjit, në Dardhë të Korçës (Nr. 468).
- 1882 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Manastirit të shën Todhrit, në Dhërmi të Himarës (Nr. 888).
- 1882 - Datë ndërtimi, në kishën e Vrionit, në Vung të Sarandës (Nr. 890).
- 1882 - Mbishkrim dhurate, në portën e kishës së shën Mërisë, në Badilonjë të Përmetit (Nr. 469).
- 1882 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Sotirit, në Konizbalt të Beratit (Nr. 260).
- 1883 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Mërisë, në Peshkopi të Sipërme të Dropullit (Nr. 764).
- 1883 - Mbishkrim me mbulesë argjendi, në ikonën e shën Spiridhonit, në kishën e këtij shenjti, në Goricë të Beratit (Nr. 261).
- 1883 - Datë ndërtje, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Mbreshtan të Beratit (Nr. 262).
- 1883 - Mbishkrim dhurate, në Thimiatonin e kishës së shën Mitrit, në Vakëf të Beratit (Nr. 263).
- 1883 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mërisë, në Kanikol të Përmetit (Nr. 473).
- 1883 - Mbishkrim pikturimi, në kungë të kishës së Pagëzorit, në Vuno të Himarës (Nr. 891).
- 1883 - Datë ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Gjon Theologut, Sarandë (Nr. 892).
- 1883 - Mbishkrim rindërtimi, në murin perëndimor të kishës së Manastirit të shën Gjon Theologut, Sarandë (Nr. 893).
- 1884 - Datë ndërtimi, në kishën e shën Mitrit, në Sopik të Pogonit (Nr. 765).
- 1884 - Mbishkrim dhurate, në një triqer të kishës së shën Mërisë, në Vokopolë të Beratit (Nr. 264).
- 1884 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Ipapandisë të kishës së shën Mërisë, në Progër të Devollit (Nr. 471).
- 1884 - Mbishkrim punim argjendi, në potirin e kishës Fjetja e shën Mërisë në Brezhdan të Përmetit (Nr. 470).
- 1884 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Gjergjit, në Barmash të Kolonjës (Nr. 472).
- 1885 - Mbishkrim mbi mbulesën prej argjendi, në Katedrale të Beratit (Nr. 265).
- 1885 - Datë ndërtimi, në kishën e Finiqit, Sarandë (Nr. 894).
- 1885 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Kryeengjëllit, në kishën e shën Kostandinit dhe Elenës, në Ogren të Përmetit (Nr. 474).
- 1886 - Datë pikturimi, në ikonat e vogla të kishës së shën Mitrit, në Zhepa të Përmetit (Nr. 475).

- 1886 - Datë ndërtimi, në kishën e Ipapandisë, në Ogren të Përmetit (Nr. 476).
- 1887 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mitrit të kishës së shën Gjergjit, në Dardhë të Korçës (Nr. 477).
- 1887 - Mbishkrim ndërtimi, në kambanarinë e kishës së shën Mërisë, në Voskopojë (Nr. 478).
- 1887 - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e shën Mitrit të Labit, në Poliçan të Pogonit (Nr. 766).
- 1887 - Datë ndreqjeje, në kishën e shën Sotirit, në Konizbalt të Beratit (Nr. 266).
- 1888 - Datë ndreqjeje, në kishën e shën Gjon Theologut, në Kala të Beratit (Nr. 267).
- 1888 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të Ikonostasit të kishës së shën Triadhës, në Zvirinë të Korçës (Nr. 479).
- 1890 - Mbishkrim ndërtimi, mbi kambanarinë e kishës së Profet Ilisë, në Voskopojë (Nr. 480).
- 1891 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e Krishtit në kishën e shën Triadhës, në Labovë të Rrëzës së Tepelenës (Nr. 767).
- 1892 - Mbishkrim në ikonostas të kishës së Manastirit të shën Kollit, në Mesopotam të Sarandës (Nr. 895).
- 1892 - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e shën Spiridhonit, në Dhivër të Sarandës (Nr. 896).
- 1892 - Datë ndërtimi, në narteks të kishës së shën Mitrit, në Glinë të Gjirokastrës (Nr. 768).
- 1892 - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e kishës së shën e Premtes, në Bradovicë të Korçës (Nr. 481).
- 1892 - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Gjergjit të kishës së Ipapandisë, në Grabovë të Përmetit (Nr. 482).
- 1892 - Nënshkrim pikturimi, pranë pikturës së shën Mërisë të kishës Lindja e shën Mërisë, në Peshkopi të Pogradecit (Nr. 68).
- 1892 - Mbishkrim pikturimi, në pikturën e kishës së Kosovës së Madhe, pranë Lushnjës (Nr. 269).
- 1893 - Mbishkrim ndreqjeje, në kishën e shën Mërisë të Peshkopisë së Sipërme, të Gjirokastrës (Nr. 519).
- 1894 - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e kishës së shën Mërisë të Katundit Benja, pranë Përmetit (Nr. 483).
- 1895 - Mbishkrim rindërtimi, në kishën e shën Gjergjit, në Lugar të Dropullit (Nr. 525).
- 1896 - Mbishkrim punim argjendi, në potirin e kishës së shën Gjergjit në Dardhë të Korçës (Nr. 485).
- 1896 - Datë ndërtimi, në kishën e Ipapandisë, në Limar të Malëshovës së Përmetit (Nr. 484).
- 1896 - Mbishkrim punim argjendi, në kuti lipsanash të kishës së shën Mitrit, në Lagjen Vakëf të Beratit (Nr. 269).
- 1896 - Mbishkrim vule, në një vulë të Manastirit të shën Gjon Vladimirit (Nr. 68).
- 1896 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Spiridhonit, në kishën e shën Mërisë, në Senicë të Sarandës (Nr. 897).
- 1896 - Datë ndërtimi, në kambanarinë e kishës së shën Mërisë, në Mavrojë të Pogonit (Nr. 769).
- 1897 - Mbishkrim ndërtimi, në kambanarinë e kishës së Manastirit të shën Mërisë, në Mbreshtan të Beratit (Nr. 270).
- 1897 - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Thanasit, në Buzmadh të Mallakastrës (Nr. 271).
- 1899 - Datë pikturimi, në kubënë e kishës së shën Mërisë, në Çarshovë të Sipërme të Përmetit (Nr. 486).
- 1899 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit e të shën Mërisë, në Senicë të Sarandës (Nr. 898).
- 1899 - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Anargjirëve, Kozmaj e Damjanojt, të kishës së shën Kollit, në Rehovë të Kolonjës (Nr. 487).
- 1811 - Mbishkrim pikturimi, në një ikonë të Krishtit të kishës së Çiflikut të Konispolit (Nr. 899).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Spiridhonit, në shën Gjergj të Libofshës (Nr. 185).

- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë, në shën Gjergj të Libofshës (Nr. 187).
- Shek. XIX - Mbishkrim i një vule të Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit (Nr. 80).
- Shek. XIX - Nënshkrimi i piktor Mihal Anagnostit nga Samarina, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mërisë, në Elbasan (Nr. 79).
- Shek. XIX - Citate nga librat kishtare, në apsidën e kishës së shën Mërisë, në Elbasan (Nr. 54).
- Shek. XIX - Mbishkrim, me emrat e kryemjeshtëreve, në kishën e shën Mërisë në Elbasan (Nr. 53).
- Shek. XIX - Mbishkrim ndërtimi, në kambanarinë e kishës së Manastirit të shën Kozmajt, në Kolkondas të Myzeqesë (Nr. 272).
- Shek. XIX - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Gjergjit, në Libofshë të Myzeqesë (Nr. 273).
- Shek. XIX - Mbishkrim ndreqje, në murin e kishës së shën Triadhës, në Manastirin e Ardenicës (Nr. 274).
- Shek. XIX - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Kozmajt në Kolkondas të Myzeqesë (Nr. 275).
- Shek. XIX - Mbishkrim ndërtimi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Mbreshtan të Beratit (Nr. 276).
- Shek. XIX - Tekst ungjillor, në kishën e shën Mërisë, në Leusë të Përmetit (Nr. 409).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës Hyrja e shën Mërisë, në Breshdan të Përmetit (Nr. 499).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë, të kishës së shën Mërisë në Korçë (Nr. 441).
- Shek. XIX - Mbishkrim ndërtimi, në kambanarinë e kishës së shën Mërisë në Voskopojë (Nr. 489).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e vogla të kishës së shën Kollit, në Shamoll të Korçës (Nr. 490).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e vjetra të ikonostasit të kishës së shën Kollit, në Shamoll të Korçës (Nr. 491).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Gjon Gojartit, në Drenovë të Korçës (Nr. 492).
- Shek. XIX - Mbishkrim punimi argjendi, në kapakët e ungjillit të kishës së shën Gjergjit, në Dardhë të Korçës (Nr. 493).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në dy ikona të ikonostasit të kishës së Manastirit të Profit Ilisë, në Hodisht të Devollit (Nr. 495).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonat e kishës së shën Thanasit në Floq të Korçës (Nr. 496).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Kollit të kishës së shën Kollit, në Shalës të Kolonjës (Nr. 497).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Ipapandisë, në Lipivan të Përmetit (Nr. 503).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në kishën e shën Stefanit, në Dhërmi të Himarës (Nr. 905).
- Shek. XIX - Mbishkrim lutje, në konakët e rënuar të kishës së Manastirit të shën Mërisë, në Kamenë të Delvinës (Nr. 908).
- Shek. XIX - Mbishkrim punimi argjendi, në një potir të kishës së shën e Premtes, në Hllomo të Pogonit (Nr. 771).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në kishën e Ipapandisë, në Lipivan të Përmetit (Nr. 503).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën Mërisë, në Këllëz të Lunxhërisë (Nr. 779).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në narteks të kishës së Manastirit të Taksiarkëve, mbi Derviçan të Dropullit (Nr. 786).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Kryeengjëjve në kishën e shën Mëhillit, në Qesarat të Lunxhërisë (Nr. 789).
- Shek. XIX - Mbishkrim pikturimi, në ikonën e Krishtit të kishës së shën Mëhillit, në Qesarat të Lunxhërisë (Nr. 790).
- Shek. XIX - Mbishkrim punimi argjendi, në potirin e kishës së Manastirit të Spilesë, në Lunxhëri (Nr. 791).
- Shek. XIX - Mbishkrim punim argjendi, në një kuti lipsanash, në kishën e Manastirit të Drianos në Dropull (Nr. 797).

- Shek. XIX - Mbishkrim dhurate, në ikonën e shën Mërisë të kishës së shën e Premtes, në Hllomo të Pogonit (Nr. 798).
- Shek. XIX - Mbishkrim punim argjendi, në mbulesën e ikonës së shën Mërisë, në Manastirin e Drianos në Dropull (Nr. 800).
- Shek. XIX - Mbishkrim punimi argjendi, në një kryq të kishës së Manastirit të Çatistës së Pogonit (Nr. 799).
- Shek. XIX - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën e Premtes, në Blush të Kolonjës (Nr. 488).
- Shek. XIX - Mbishkrim këmbane, në kishën e shën Mërisë, në Stratoberdë të Korçës (Nr. 501).
- Mbishkrim në një ikonë të Manastirit të Drianos në Dropullin e Sipërm (Nr. 800).

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Mbishkrimet e Kishave të Shqipërisë

I. MBISHKRIMET E ZONËS SË DURRËSIT

1.
1159

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur, në një gur të murosur, në qoshen juglindore të kishës së shën Mitrit në Potkozhan të Mokrës. Një gojëdhënë e vendit thotë, se data ka qenë pikturuar mbi suva, në portën perëndimore, brenda në kishë, por, për ta përjetësuar është gdhendur vonë në gur, me urdhër të një peshkopi.

Shënojmë se data, po të ishte e shekullit XII - nuk do të ishte shkruar me shifra arabe. Veç kësaj, ajo do të ishte e paraqitur simbas kronologjisë së ashtuquajtur bizantine, që prej krijimit të botës. Së fundi theksojmë se kisha, ndërtimit të së cilës i referohet data, është e gjatë 6 m, e gjerë 5 m. Piktura e saj ka tipare të shek. XVII.



Χρη γηνωσκ(ειν) οτι ο ναος ουτος ἐκατελυθη απο σοισμου παντελως εως θεμελιου εις την διακρατησιν και εν ημεραις αυθεντεβοντος πα / σης χωρας Αλβανου πανυσι

λωτατος πρωτος Καρλας ο Θεωπιας ανεψιος δε και αιματος ρυγας της Φραγγιας. Αυτος δε / ανοικοδομησεν τον πανσεπτον ναον τουτον του αγιου Ιωαννου του Βλαδημηρου και ανιγειρεν αυτω(ν) εκ βαθρου μεχρι τε / λους εκ πιστεως δε και ζεουσι(ς) καρδια(ς) απο Χ(ριστο)υ γεννησεως εως οικοδομησεως του ναου ετη Α. Τ. Π. (1380) απο δε κτισεως κοσμου ει / σιν ετη ζωγ (6890 = 1382) αυθεντεβοντος δε εως τοτε κβ̄ ετους ινδικτιον(ος) της Ε.Ο. (ηλιου) κυ(κλος) ᾱ (σεληνης) κυ(κλος) ιδ̄ εκτηστη δε ο ναος (ον) ορ(α)ς. Δ. μεγηστως (ως) πρη(ν) ο πα / λεος ναως.

Përkthimi: Duhet ditur se ky tempull u shemb nga tërmeti, deri në themel, gjatë sundimit dhe në ditët kur zotëronte mbi të gjithë vendin e Albanit i ndrituri Karl Topia i parë, nip dhe prej gjaku i mbretit të Francës. Ky e ndërtoi këtë tempull të gjithënderuar të shën Gjon Vladimirit dhe e ngriti prej themeli deri në mbarim nga besimi dhe zemra e përvëlur. Prej lindjes së Krishtit deri në ndërtimin e tempullit [janë] vjet 1380 dhe prej krijimit të botës janë vjet 6890 dhe deri atëherë vjet 22 të zotërimit [të tij], indikti 5, cikli [i diellit] 1, cikli [i hënës] 14, dhe është ndërtuar tempulli (që) shikon 4 [herë] më i madh se [ka qenë] më parë tempulli i vjetër.

Shënim: 1- Mbishkrimi gjendej i gdhendur në gurin e madh arkitra të portallit të derës jugore të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit. Ka gjatësi 2.20 m., gjerësi 0.27 m., përmban pesë radhë. Është shkruar me gërma të mëdha, me fjalë të përmbledhura, me shkurtime e sigla dhe me gabime ortografike e gramatikore. Tani gjendet në Muzeun Historik Kombëtar.

2- Mbishkrimi është botuar nga: a) Jan Papa [30], me gabime dhe deformime; b) Shtypshkronja e Voskopojës [31] (ribotim i veprës së Jan Papës); c) Papa N. Gliqi [14] (ribotim i veprës së Jan Papës); ç) J. G. Hahni [15] me deformimet si në botimet e mëparshme; d) Shtypi i Venedikut [14] (ribotim i veprës së Gliqit); dh) Stavraq Aristarku [4] me fotografi të origjinalit; e) Stojan Novakoviç [28] me një gabim tjetër që prish kuptimin e origjinalit; ë) Th. Ippen [17, XIII, 1901, f. 439-442], me pasaktësinë e botimeve të mëparshme; dhe f) Th. Popa [34] me korrektive e deshifime të reja.

Nuk dihet se ç'madhësi ka patur kisha e shën Gjonit, që rindërtoi Karl Topia.

3.



An(n)o ab incarnatione d(omi)ni
n(ost)ri Je(s)u Chri(sti) MCCCLXXXI
i(n)di(ction)e V reg(na)nte i(n) Albania
serenis(s)i(mo) pr(in)cipe d(omi)no
Karulo Thopia p(ri)mo de
domo Fra(n)ci(a)e, an(n)o d(omi)ni(at)ionis
XXII una cum il(l)ustris(s)imo su-
o filio pr(ri) mogenito d(omi)no
Georgio ha(n)c eccl(esi)a(m) fecit.


Përkthimi: Në vitin e mishërimit të zotit tonë, Jezu Krisht 1381, indikti 5, kur zotëronte në Shqipëri shumë i kthjellti princi zoti Karl Topia i parë, prej shtëpisë së Francës, në vitin XXII të zotërimit të tij dhe me të birin e tij, shumë të ndriturin e paralindur zotin Gjergj, ka ndërtuar këtë kishë.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur, në një rrasë mermeri në trajtë katrore murosur, pranë derës jugore të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit, pranë Elbasanit, me gjatësi 50

5 Gërmat e plotësuara në kllapa janë të Margarit Dhimicës [10].

cm.dhe gjerësi 48 cm dhe përmban nëntë radhë. Është shkruar me shkrim të tipit frakturë, me shumë shkurtime e sigla dhe me germa të mëdha. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar. Mbishkrimi është botuar nga: a) J. G. Hahn [15]; b) Stavraq Aristarku [4]; c) Margarit Dhimicas [10]; ç) Stojan Novakoviç [28]; d) Th. Ippen [17 XIII, 1901, f. 439-442]; dh) dhe Th. Popa [34]⁶.

4.



† СНО СТО ЦРКВ. СТАО. НΩΒΑ
 НАВЛАДНМРА. СТВОРНКАРЬТЕΩ
 ПНЯ ГЪ РАБЪНСКН ВЪ К В
 ЛТО ГПДСТВА СВОЕГО НСВРШНЮВЪ ЛО К Δ Γ(О) С(ПО) ДС
 СВАС
 ВОГ

Klisheja e translimituar

+ СНО ЭТО ЦРКВ СТАО НΩΒΑ НАВЛАДНМРА СТВОРН КАРЛЬ ТЕΩ /
 ПНЯ Газета ДИЕЛЛИЮ РАБЪНСКН ВЪ К В / Л(Е)ТО Г(О)С(ПО)ДСТВА С
 ВОЕГО НСВР ШНЮВЪ Л(Е)ТО К Δ Г(О)С(ПО)ДС / СВАС / ВОГ / О

Përkthimi: Këtë kishë të shenjtë të shën Gjon Vladimirit, e ka ndërtuar Karl Topia, zoti i Arbërit, në të 22-tin vit të zotërimit të tij dhe e mbaroi atë në të 24-tin vit të zotërimit të tij.

Shënim:

1- Mbishkrimi gjendej i gdhendur mbi gurin e madh të portalit të derës jugore të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit. Sipërfaqja e gurit ndahet në korniza të gdhendura në relief. Mbishkrimi është në dy radhë. Radha e parë e mbishkrimit nga kuadri i kornizës së parë kalon në të dytin si dhe radha e dytë. Mbishkrimi është me sigla, fjalët janë të ndara në fillim, por nga fundi, për mungesë vendi, janë bashkuar. Si gjuhë është përdorur serbishtja e shek. XIV, me alfabet cirilik kishtar. Guri i këtij mbishkrimi ka pësuar një plasje nga fundi i mesit të kornizës së parë dhe asaj të dytës, nga ku, duke vijuar, plasja zbret poshtë para dhe mbas gjysmës së kornizës së dytë. Afër fillimit mbi kornizën e dytë, një plasje tjetër ngjitet përpjetë, pak pjerrtas, deri në fund. Këto plasje i kanë dëmtuar fare pak gërmat, kështu që në vend mbishkrimi mund të lexohet fare lehtë. Gjendet në Muzeun Historik Kombëtar.

2- Një gojëdhënë e Elbasanit thotë, se kjo kishë, përpara se të quhej e shën Gjon Vladimirit, quhej e shën Triadhës. Në të vërtetë në ikonostasin e kishës ndofta në vazhdim të traditës më të vjetër të kishës, mbi derën e bukur, ka qenë varur gjithmonë një ikonë e madhe e shën Triadhës, deri kur u dogj kisha më 1944.

3- Mbishkrimi është botuar nga: a) Stavraq Aristarku [4]; b) Stojan Novakoviç [28]; dhe c) Th. Popa [34].

⁶ Gërmat në kllapa janë plotësime të Stojan Novakoviçit [28/.

5.




Ετουτα τα / (ση) μαθηα αυθε(ν) / του μεγα / Καρλα Θ(ε)οπηα (1).

Përkthimi: Këto janë shenjat e zotit të madh Karl Topisë.

Shënim: Mbishkrimi me germa të mëdha, gjendet i gdhendur mbi një gur të murosur në faqen e jashtme të murit jugor të kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit. Guri ka gjatësi 0.98 x 0.68 m dhe ruan të punuar në relief stemën e Karl Topisë.

Mbishkrimi është botuar nga J. G. Hahni [15]; Th. Ippeni [17] XIII, 1901, f. 439-442], dhe Th. Popa [3].

6.




Klisheja e dy skicave të kambanës së Kastriotëve

-MCCCCLXII (=1462)

Shënim: Kjo datë e shoqëruar me dy skicat, që shihen më sipër, gjendet në një kambanë, që ruhet në Muzeun Historik Kombëtar në Krujë, e që konsiderohet si e kishës së Kastriotëve.

7.



+ "Οταν εις Θ(εο)ν εκπετασις / τας χειρας σου ω Θ(εο)υ θυτα, / μνησθητι κ(αι) εμου του αμαρτωλου / και αμαθους Ονουφριου ζωγράφου.

Përkthimi: Kur të ngrësh duart e tuaja nga perëndia, o meshtar i perëndisë, më përmend dhe mua mëkatarin e të paditurin, piktor Onufrin.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar mbi faqen e murit verior, pranë tryezës së prothesit, në

7 Gërmat në kllapa janë plotësime të autorit Th. Ippen [17].

kungë të kishës së shën Kollit, në Shelcan (Shpat i Elbasanit). Është pak i dëmtuar nga tymi i qirijve, por në vend lexohet pa vështirësi. Është shkruar me gërma të mëdha e të zeza. Në këtë mbishkrim piktor Onufri rezulton laik, pra mbishkrimi duhet të jetë shkruajtur para vitit 1554, për faktin se në këtë vit, piktori në shën e Premte të Valshit (shpat i Elbasanit) nënshkruan si prift dhe protopapë i Neokastrës (Elbasanit) (shih mbishkrimin 14).

Mbishkrimi është nga Th. Popa [35] i transkriptuar e i përkthyer⁸.

8.

Ἐν ταῖς λαμπρότητες τῶν ἁγίων σου πῶς εἰσελεύσομαι
ὁ ἀνάξιος ἐάν γάρ τολμήσω συνελθόν εἰς τῶν νυμφῶνα
ὁ χιτῶν μὲ ἐλλέγχει ὅτι οὐκ ἔστι τοῦ γάμου καὶ
δέσμιος ἐκβάλλομαι ὑπὸ τῶν ἁγίων σου ἀγγέλων Καθάρισον
Κύριε τὸν ρύπον τῆς ψυχῆς μου καὶ σῶσον με
ὡς μόν(ος) ἐλεήμων καὶ φιλόανθρωπος.

Përkthimi: Në shkëlqimet e shenjtorëve të tu, si do të hyj unë i pavyeri? Se, në guxofsha të hyj bashkë me nusërore, këmisha më tregon se s'është e dasmës, dhe, i lidhur do të nxirrem jashtë nga engjëjt. Spastro, o zot, ndyrësinë e shpirtit tim dhe shpëto më si i vetëm i mëshirshëm dhe njeridashës.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar në suva, në pjesën e sipërme të faqes perëndimore të ikonostasit prej muri, në kishën e shën Kollit, në Shelcan. Është shkruar me gërma të mëdha e të zeza dhe është pjesë e një lutje nga mesha e shën Gjon Gojartit. Përkthimin e kemi marrë nga F. S. Noli [23].

9.

Κ(ύρι)ε ὁ Θε(εός)ς ἡμῶν σῶσον τὸν λαόν σου καὶ εὐλόγησον
τὴν κληρονομίαν σου τῷ πλήρωμα τῆς ἐκκλησίας σου, φύ-
λαξον ἁγίασον τοῦς ἀγαπόντας τὴν εὐπρέπειαν τοῦ οἴκου
σου σύ αὐτούς ἀντιδόξασον.

Përkthimi: O zot, perëndia jonë, shpëto popullin tënd, dhe bekoje trashëgimin tënd; gjithë besnikët e kishës tënde ruaji, shënjtëro ata që dëshërojnë mirësinë e shtëpisë tënde. Ti lavdëroi ata.

Shënim: Mbishkrimi, është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar në pjesën e sipërme të faqes lindore të ikonostasit prej muri, në kishën e shën Kollit, në Shelcan, me gërma të mëdha e të zeza. Është një lutje liturgjike, që gjendet në shërbesën e meshës. Përkthimin shqip e kemi marrë nga F. S. Noli [23].

10.



+ Ἄρατε πύλας οἱ ἄρχωντες ὑμῶν καὶ ἐπάρθηται πύλαι αἰῶνιοι / κ(αὶ) οἰσελεύσεται ὁ βασιλεύς τῆς δόξης Κ(ύρι)ος κραταιὸς κ(αὶ) δυνατὸς ἐν / πολέμῳ αὐτὸς ἐστὶν ὁ βασιλεὺς τῆς δόξης Κ(ύρι)ος τὸν δινάμεων.

⁸ Gërmat në kllapa janë plotësime të autorit Th. Ippen [17].

Përkthimi: Ngreni ju o sundimtarë tanë dhe lartësohuni, o dyer të përjetshme, dhe do të hyjë Mbreti i lavdisë, Zot i fortë dhe i fuqishëm në luftë, ky është Mbreti i lavdisë, zot i fuqijve.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar në "derën e bukur" të ikonostasit, në kishën e shën Kollit, në Shelcan, me gërma të mëdha e të zeza mbi sfond të bardhë, me shkurtime e sigla, e me gabime ortografike. Është një kombinim vargjesh nga psallmi 24 i Davidit, nga teksti i përkthimit të Evdomikondave (Septuaginta). Tekstin shqip e kemi marrë nga përkthimi i Kostandin Kristoforidhit [47], përkthyer nga hebraishtja e vjetër.

11.




+ Κ(ύρι)ε, Κ(ύρι)ε, ἐπεὶ βλεψὼν ἐξ οὐρανοῦ καὶ ἴδε καὶ ἐπίσκεψε τὴν ἄμπελον ταύτην καὶ κατάρτησε αὐτήν ἣν ἐφύτευσεν ἢ δε / ξιά σου καὶ) ἐπεὶ ὄν ἀνθρώπου ὃν ἐκρατ εὔσας σεαυτὸν.

Përkthimi: O zot, o zot, shtjerë sytë prej qielli dhe vështro, vizito këtë vreshtë dhe rregulloje atë që e mbolli e djathta jote dhe mbi birin e njeriut mbi të cilin e mbështete vehten tënde.

Shënim: Mbishkrimi, është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar mbi derën veriore të ikonostasit, brenda në kungë të kishës së shën Kollit, në Shelcan, me gërma të mëdha e të zeza mbi sfond të bardhë.

12.




Klisheja e transliterimit

+ Γέγονεν ἡ κοιλία σου ἀγία τραπέζα εχουσα τον / ουρανιον αρτον Χρηστον τον Θ(ε)ὸν ημων ἐξ / ου πας ο τρόγων ου θνησκει ως εφησεν ο του / παντος θεογεννητωρ τροφευς.

Përkthimi: U bë barku yt [o Hyjelindëse] tryezë e shenjtë, që ka bukën qiellore, Krishtin, perëndinë tonë, nga e cila kushdo që ha nuk vdes, sikurse ka thënë ati ushqyesi i të gjithëve.

Shënim: Mbishkrimi, është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar rreth apsidës nën skenën e Platiterës, në kungë të kishës së shën Kollit, në Shelcan, me shkronja të mëdha të zeza e me gabime ortografike. Mbishkrimi, është një lutje e tryezës së bukës, që thuhet para buke.

13.



..... αυξύνθη παρα της χωρας Βαλεσεον κ(αι) εξογραφει κ(αι) τον εξό / δον... κα(ι) ο ευλαβεστατος ιερεὺς Γεώργιος τοῦ Λογοθετη εδοσεν ομπολα.... / Νεοκαστροῦ οι θεορου ντας εύχεσθε δεια τὸν Κ(ύριον) τω δωντι την χαρην επει ετους Ζ. Ξ. Β. (7062 = 1554). Κυκλοι (ηλιου) ιβ', κυκλοι (σεληνης)...

Përktimi: "u shtua nga katundi i valshakëve dhe është pikturuar me shpenzimet dhe fort i devotshmi prift Gjergji i Logothesit ka thënë e mbolla (?). . . . [ju] të Neokastrës që e vështroni lutuni për zotërinë që ka dhënë dhuratën, në vitin 7062 (=1554) cikël [të diellit], 12, cikël [të hënës].....

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar në pjesën veriore të faqes së murit perëndimor të kishës së shën e Premtes, në Valësh, me gërma të mëdha, të zeza e me shkurtime. Disa fjalë të mbishkrimit janë prishur. Është botuar nga Th. Popa [36]. Kisha ka dimensione (gjatësi e gjerësi 2.50 m.).

14.




+ "Όταν εἰς Θεόν ἐκπετάσῃς τὰς χεῖρας σου / ὦ Θεοῦ θύτα μνησθητα, κάμου τοῦ ἀμαρτωλοῦ / Ὀνουφρίου ἱερέος, ζωγράφου κ(αι) πρῶτοπαπα Νεοκάστρου.

Përktimi: Kur të ngresh duart e tuaja nga perëndia, o meshtar i Perëndisë, më përmend dhe mua mëkatarin, prift Onufrin, piktorin dhe protopapë (Kryeprift) të Neokastrës (Elbasanit).

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Onufrit dhe gjendet i pikturuar, në faqen e murit në vendin e prothesit, të kishës së shën e Premtes, në Valësh me gërma të mëdha, të zeza, me

shkurtime dhe me sigla. Mbishkrimi është botuar nga V. Puzanova [49] dhe Th. Popa [35] i transkriptuar dhe i përkthyer.

15.




Οὗτος ὁ ἅγιος ναὸς τῆς ἁγίας μεγαλομάρτυρος Παρασκευῆς / υῆς
πόθου τῆς αὐτῆς χώρας, εἰ λιθε / κ' ὁ ζωγράφος Ὀνούφριος.....

Përkthimi: Ky tempull i shenjtë i dëshmoresh së madhe shën e Premtes..... me dëshirë të këtij
katundi 26 piktor Onufri

Shënim: Ky mbishkrim, i dorës së Onufrit, në kishën e shën e Premtes në Valësh, gjendet në
pjesën jugore të faqes së murit perëndimor të kishës. Paraqitet shumë i dëmtuar. Shkruar me
germa të mëdha

16.



+ Ἀνεγερθη ἐκ βοθρον καὶ οἰκονογραφεῖθι ὁ θεὸς καὶ πα / νσεπτος νᾶός τῷ ἁγίου πα
ρὸς μιν Νηκολαου ἀρχιεπισκοπου Μηρον τοῦ θα / υμάτου-γου δια σήνδρομή(ς) κόπου
καὶ ἔξοδου τὸ(ν) ἐντημοτατον αρχοντων Βαλεσεῶν / μηκρι μεγαλι ἀρχιερατεβοντος τοῦ θ

εοφιλεστατοῦ ἐπισκοπου κέρου Λαβρε(ν)τίου κ(αί) ἱερατεβο(ν)τῶς / τοῦ ἐβλαβεστατο
ὁ Κολῖα Ταῦτα Λεκάμπε ἐπι ἔτους Ζ. Ρ. Ι. Β. (7112 = 1614).

Përkthimi: U ndërtua nga themeli dhe u pikturua me ikona, ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë shën Kollit, e kryepeshkopit të Mirës, çudibërës, me kontributin, përpjekjen dhe shpenzimet e arkondëve të shumënderuar të valshakëve të vegjël e të mëdhenj, në kohën e peshkopatit të peshkopit shumë perëndidashës, zotit Lavrentit dhe në kohën kur ishte famulltar i shumëdevotshmi, Kolë Tata Lekabe, në vitin 7112 (=1614).

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar, në anën veriore të faqes së murit perëndimor, brenda kishës së shën Kollit në Valësh, me gërma të rëndha e të zeza. Kisha, për të cilën flet mbishkrimi, është një paraklis i thjeshtë, me madhësi 10 x 3 m, me një apsidë cilindrike.

17.



Οὗτος ὁ ναός ὑπάρ(χει) τοῦ ἐν ἁγίοις π(α)τρός (ή)μων Νικολ(ά)ου ἐπησκόπησκοπου / Μύρων τοῖς Λι(κίας τοῦ θαυματ)ουργοῦ (ιστορήθη) διὰ ἐξόδου τοῦ τημιω(τά)του κ
(αί) εὐγενεστάτου ἀρχου / κύρ Γγίκα (γραμματέως ἐκ πόλεος Ἐλπασάνι κ(αί) ἔδωκεν
ἄσπρα χυληάδας ΣΤ! κ(αί) ὕ / διὰ ψυχ(ικὴν σωτηρίαν) καὶ σώματος κ(αί) ὁ Θε(ός) Ν
ικολάου δόσι αὐτόν μιρίωνα πλου / σιον (ἑάν) τῆς κατηγορίσι τὴν ὕστορίαν ἔλε(γ)χο
νάχι τῶν ἁγίων Νικόλαων / ἐν (ἡμέρα) κρίσαιος, ἐν ἐτι Ζ. Ρ. Α. Γ. (7133 = 1625).

Përkthimi: Ky tempull është i atit tonë ndër shenjtëro, shën Kollit, peshkopit të Mirës së Likisë, çudibërësit. U pikturua me shpenzimet e të shumënderuarit dhe shumë fisnikut arkond, zotit Gjika, sekretar nga qyteti i Elbasanit duke dhënë gjashtëmijë e katërqind aspra për shpëtimin e shpirtit dhe të trupit; dhe perëndia e Nikollës i dhëntë atij dhjetramijë pasuni (dhe), në se ndokush do të shajë pikturën, pastë akuzues shën Kollin, ditën e gjyqit. Në vitin 7133 (=1625).

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi portën perëndimore të kishës së shën Kollit, të Shelcanit, me gërma të mëdha, të zeza mbi sfond të bardhë. Suvaja, mbi të cilën është pikturuar mbishkrimi; ka plasur dhe është dëmtuar në disa pjesë të saj. Mbishkrimi bën fjalë për një pikturim të tretë në këtë tempull, mbas atij të Onufrit. Kisha ka madhësi 13. 53 x 6. 30 m.

18.

Φιλιστωρίθι οὗτος ὁ ναός ἐστώς διὰ τοῦ ἀρχωντος Κύρ Χατζί (Γ)Κύκα καὶ γραμματεῦ
ς (ἐκ πόλεος) Ἐλπασάνι.


Përkthimi: Ky tempull, që ekzistonte, u pikturua me dëshirë prej arkondit zotit Haxhi Gjika, sekretar nga qyteti i Elbasanit.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi ish-portën jugore, brenda kishës së shën Kollit, në Shelcan, me gërma të mëdha, të zeza e mbi sfond të bardhë. Piktori gabimisht e ka shkruar dy herë fjalën "εκ πολεος". Mendojmë që mbishkrimi të jetë i vitit 1625, mbasi përmend të njëjtin ktitor (për pikturën), të mbishkrimit Nr. 17, me datë 1625.

19.
ZPTIZ= 7187 (= 1679)

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në bazamentin e një kryqi prej argjendi, të kishës së shën Kollit, në Elbasan.

20.



ΑΝΕΓΕΡΘΗΚΑΝ ΕΣΟΡΗΘΗΘΗΣΟΣ ΕΠΑΝΣ ΕΠΙΣΤΑΘΟΣ ΤΧΕΝ
 ΓΙΗΣ ΠΑΤΡΟΣ ΗΜΟΝ ΑΘΑΝΑΣΙΟΥ ΤΟΥ ΜΕΓΑΛΟΥ ΠΑΤΡΗ ΑΡΧΟΝ
 ΑΛΕΞΑΝΔΡΗ ΑΣΔΗΝ ΔΡΟΜΗΤΗΣ ΚΥΚΟΝΟΜΟΥ ΝΙΚΟΛΑΟΥ
 ΗΡΕΕΣ Κ ΓΕΡΟΝΤΟΝ ΚΗΡ ΔΗΜΗΤΡΙΟΥ ΚΗΡ ΝΗΚΟΛΑΟΥ ΚΕΤΕ
 ΡΟΣ Κ Η ΛΑΖΑΡΟΥ ΚΕΤΕΡΟΥ ΚΗΡ ΚΥΝΟΝΑ ΚΟΠΟΥ Κ ΕΞ ΟΔΟΥ
 ΠΑΝΘΟΧΡΙΣΤΑΝΟΝ ΗΡΟΥΡΓΟΥΝΤΩΝ ΓΕΟΡΓΓΗ ΕΡΕΜΙΧΗ
 Η ΕΡΕΣ ΑΛΑΖΑΡΟΥ ΓΕΩΡΓΓΙΟΥ ΠΑΝΤΑΝΟ ΝΙΚΟ ΚΟΣΤΑ
 ΤΗΜΑ ΑΡΧΗΡΑΤΕ ΒΟΝΤΟΣ ΚΥΡΥΟΥ ΚΥΡΥΟΥ ΑΡΣΕΝΗΟΥ /
 ΒΑΚΟ ΔΗΧΗΡΟΣ ΚΑΜΟΥ ΖΟΓΡΑΦΟΥ ΤΑΠΗΝΟΣ ΔΗΜΗΤΡΙ
 ΟΣ ΗΟΣ ΝΗΚΟΛΑΟΥ ΕΚΟΜΗΣ ΧΟΡΑΣ ΛΗΝΟΤΟΠΗ Η
 ΠΕΡΕΤΟΥΝΤΟΝ ΖΟΝΟΒΙΑ ΜΟΝΑΧΙ:

Klisheja e transliterimit

Αναγερθη και ανεστορηθη ο θηος και πανσεπτος ναος του εν αγιης πατρος ημων Αθανασηου του Μεγαλου Πατρηαρχου Αλεξανδρηας / δηασηνδρομη(του) και υκονομου Νικολαου ηρεος και και Κηρ Δημητρι και Κηρ Νηκολα(ου) και και ετερος Κηρ / Λαζαρου και ετερος Γεργι Κηρ Κυονα, κοπου και εξοδοου παντων τον χριστηανον, ηερουργουντων Γεοργι

ου ηερεα Μιχαηλ ηερεος Α / αζαρ(ου) δε Γεοργιος, Ποστολη, Κοστα, Ταννο, Νικο, Κοστα, Τημα. Αρχηερατεβοντος κυρϑου κυρϑου Αρσενηου, / Βακο. Δηα χηρος καμου ζογραφου ταπηνϑος Δημητριος ηος Νηκολαου Ζογραφου εκ(κ) κομης χορ(ας) Ληνοτοπη, ηπερετουντον Ζονοβια(ας) μοναχι(ς).


Përkthimi: U ngrit dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë ndër shenjtorët, Athanasit të Madh, patrikut të Aleksandrisë, me kontributin dhe të ekonomit prift Nikollës dhe të pleqve, zotit Dhimitër, zotit Nikolla, zotit Llazar, dhe zotit Kiona, me përpjekjet dhe shpenzimet e të gjithë të krishterëve, të priftërinjve që kryejnë shërbesat e hirshme, prift Gjergjit, prift Mihalit dhe Llazarit, Gjergjit, Postolit, Kostës, Janos, Nikos, Kostës, Tinos. Në kohën e peshkopatit, të peshkopit zotit Arsen Vako. Me dorën time, të piktorit të përvuajtur, Dhimitrit, birit të Nikollë Zografit, nga katundi Linotopi, që i shërbeu murgeshës Zinovia.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar në portën perëndimore, brenda kishës së shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës, me germa të mëdha, të zeza e mbi sfond të bardhë. Sot figuron shumë i dëmtuar. Kisha është bazilikë njënefshe me tri apside anash, me madhësi 12x8.25 m.

Peshkop Arseni titullohet i Gorës dhe i Mokrës në aktet e Patriarkisë së Ohrit prej 1685-1699 [11], fakt ky që tregon se kisha në fjalë duhet të jetë pikturuar brenda asaj kohe.

Llagapi "Vako" i familjes së peshkop Arsenit, ruhet edhe sot, në Potgozhan të Mokrës. Po prej kësaj familje kanë dalë dhe piktorët e njohur si korçarë, Kostandin dhe Athanas Zografi me bijtë e tyre, në shek. XVIII e XIX.

21.



+ Ιῶ(αννης) Μιλιο, Κονουλας κ(αί) / Γ(γ)ικα κ(αί) Ρουσο, κ(αί) Πετ(ρ)ου / οι αδελφ
οι αυτου / ετους αχγ (1690) Ιουλιου ΙΕ.

Përkthimi: Jan Milió, konsull dhe Gjika dhe Ruso dhe Petro, vëllezërit e tij, viti 1690, korrik 15.

Shënim: Mbishkrimi, gjendet i gdhendur në një pllakë guri të jashtme, mbi portën perëndimore të kishës së shën e Premtes, në lindje të Kavajës. Mbishkrimin e plotëson një akt i Patriarkisë së Ohrit [11 f. 47-48], ku thuhet se kisha e oshënarës martires së Krishtit, shën e Premtes, në Kavajë të Durrësit, është rindërtuar dhe dhuruar si metoh⁹ Patriarkisë së Ohrit më 1691".

(=prej arkondëve të shumënderuar Jan Miliias, Konsullit të Francës, zotit Gjike dhe zotit Rosiut)".

Kisha, për të cilën flet mbishkrimi, është e stilit bazilikal njënefshe, me apsidë në formë paralelopipedi dhe me madhësi 16 x 8.25 m. Gojëdhëna e Kavajës thotë se ktitorët e kishës në fjalë kanë qenë tregtarë me origjinë bullgare. Shkrimi është me germa të mëdha.

22.

ΧΥΡΚΩΝΣ ΑΝΙΝΙΕΡΟ
ΕΣ ΑΠΟ ΧΥ ΑΧΥΦ

Klisheja e transliterimit

Χειρ Κῶνσταντίνου ἱερομ(ονά)χ(ου) / ἔτος ἀπὸ Χ
(ριστο)ύ αχγγ (= 1693).


Përkthimi: Dora e jeromonak Kostandinit, viti prej Krishtit 1693.

⁹ Metoh-është një manastir ose kishë që varet administrativisht dhe ekonomikisht nga një manastir i madh, peshkopatë ose kryekishë.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar në një ikonë të madhe të Krishtit, të kishës së Kosovës së madhe (Lushnjë). Ikona, këto vitet e fundit është transportuar, pranë kishës së Manastirit të shën Gjon Vladimirit mbas djegies së kësaj të fundit më 1944.

Emri "Κωνσταντίνου" (Kostandin), i shkruar këtu pa " " përpara "ι" (jotës), merr një shprehje simbas fonetikës së Shqipërisë së mesme. Ka të ngjarë që ky fenomen gjuhësor, sinjalizon origjinën e mundshme të piktorit.

23.




Χεῖρ Κωνσταντίνου ἱερομονάχου καὶ διὰ σηνδρωμῆ(ς) καὶ πόθου / Νικολάου ἱερέως ἱκονόμου Χ(ριστο) ὁ αχγδ (1694).

Përkthimi: Dora e jeromonak Kostandinit me kontributin dhe dëshirën e prift Nikollës. . . ekonomit. Prej Krishtit 1694.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e madhe të Krishtit, të ikonostasit të kishës së shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës. Tri fjalë të mbishkrimit janë prishur.

Emri i jeromonak Kostandinit, gjendet edhe në katër ikona të tjera të mëdha të ikonostasit të kësaj kishe, në ikonat e shën Mërisë, të shën Gjon Pagëzorit, të shën Thanasit dhe të shën Mitrit, me vitin (=1692).

24.



αχγστ (= 1696)

Përkthimi: (αχγστ = viti 1696).

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar në ikonën e shën Vlashit, të ikonostasit të kishës së Manastirit të shën Vlashit, pranë Durrësit. Po të dorës së këtij piktori anonim janë edhe ikonat e tjera të ikonostasit të kësaj kishe, sepse paraqiten identike në art. Kjo mendojmë se dëshmon për një rindërtim të kishës nga fundi i shek. XVII.

25.

αψιζ (= 1717)

Përkthimi: (αψιζ = viti 1717).

Shënim: Ky mbishkrim i dëmtuar, të cilit i ruhet vetëm data, gjendet në faqen e përparme të proshqinitarit të kishës së shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës. Proshqinitari është prej druri të gdhendur, si zakonisht, formë pirgu katror, me lartësi 1. 50 m, me gjysmën e sipërme prej katër kolonash me një mbulesë piramidale.

26.

Το παρον θημιατηριον ηνε της Παιραγης Θελο(τωκου) ης το / Νεοκαστρον - Ελμπασανη και το εδοσε ο Ηοανης ης του Μαρκου και / σε εγραψε στην παρουσια αυτος και η μητηρ του ο Θεος σιχορεσι - 1729.

Përkthimi:

Ky thimiaton është i së mbishenjtës Hyjëlindëses në Neokastër (Elbasan). E ka dhënë Jani, biri i Markut, dhe e ka shkruar me praninë ai dhe e ëma e tij, që perëndia i ndjeftë 1729.

Shënim: Mbishkrimi është i gdhendur rreth bazamentit të thimjatonit të madh prej argjendi, që ndodhet në kishën Lindja e shën Mërisë, në Kala të Elbasanit.

27.



+ ΑΓΙΟΝ ΕΒΑΓΓΕΛΙΟΝ ΑΦΙΕΡΟΣΕΝ Ο ΜΑ / ΣΤΟΡ
Α(Σ) ΤΟΤΟΣ, ΚΟΣΤΑ, ΠΑΙΚΟ (Ε)ΙΣ ΤΗΝ ΕΚ(Κ)ΛΙ /
ΣΙΑΝ ΤΗΣ ΧΟΡΑΣ ΛΟΥΝΚΑ ΝΑ ΜΙ / ΜΟΝΕΒΕΤΕ ΕΟΝΙΑ 16
ΠΟΡΓ, 1743 ΒΡΥΣΟ

Klisheja e transliterimit

+ Αγιον εβαγγελιον το αφιεροσεν ο μα / στορ
α(ς) Τοτος, Κοστα, Παικο (ε)ις τήν εκ(κ)λι /
σιαν της χορας Λουνκα να μι / μονεβετε εον
ια, σεπτ(ε)μ(βρίου) 16 / - 1743 Γεοργι Βρουσ
ο.

Përkthimi: [Këtë] ungjill të shenjtë e kanë
dhuruar mjeshtërit Toto, Kosta, Peko, për në
kishën e katundit Lungë¹⁰ që të përmendet
përjetësisht, 16 shtator 1743, Gjergj Vrusa.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gravuar mbi
copat prej argjendi dhe mbi kapakët e ungjillit
të kishës së shën Gjergjit në Llëngë të Mokdrës
nën skenën Kryqëzimi i Krishtit.

28.

1743 ΜΙΝΗ ΙΟΥΛΙΟΥ (= 1743 muaj korrik 6).

Shënim: Mbishkrimi gjendet i ngdhundur në një gur të jashtëm, mbi portën perëndimore të kishës
Fjetja e shën Mërisë, në Niçe të Gorës, pranë Pogradecit. Mendojmë se duhet të tregojë kohën e
ndërtimit ose të rindërtimit të kishës, gjë që rezulton nga struktura e ndërtimit të saj.
Kisha është bazilikë tri nefshme, tavane me madhësi 12. 80 x 8. 85 m.

29.

Το παρόν τμήρον σταυρον ηνε του Νικολαου ηρεος ηρος του Πρεντη / απο Πρατασεση-1748.

Përkthimi: Ky kryq i nderuar është i prift Nikollës, birit të Prendit, nga Brodosheshi, 1748.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gravuar rreth bazamentit të një kryqi prej argjendi të tryezës së
shenjtë të kishës Lindja e shën Mërisë, në Kala të Elbasanit.

30.

Δια χηρός και δεήσεος Νικολάου τού Γούγα από ΑΨΝ (= 1750).

Përkthimi: Me dorën dhe lutjen e Nikollë Gugës, nga 1750.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në një ikonë të madhe të shën Naunit, të kishës së Ungjillëzimit, në
Tiranë.

31.


Α Ψ Ν Β (= 1752).

¹⁰ Emri i vjetër i Llëngës.

Shënim: Këtë datë e kemi gjetur të pikturuar mbi suva, në faqen e brendshme të murit lindor, të hajatit jugor të kishës së shën Thanasit, në Llëngë të Mokrës, që simbas mendimit tonë i referohet pikturimit të hajatit nga Kostandin Shpataraku.

Kisha është bazilikë njënefshe me tavan. Muret e saj janë punuar prej gurësh lidhur me baltë. Kisha ka madhësi 12 x 25 m.

32.



'Απο Χ(ριστο)ῦ ΑΨΝΕ (= 1755). / Χε̄ιρ Κωνσταντίνου ἰ(ε)ροδιακόνου.

Përkthimi: Prej Krishtit 1755, dora e jerodiakon Kostandinit.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Kostandin Shpatarakut dhe gjendet i pikturuar në ikonën e madhe të Krishtit, në ikonostasin e kishës së Manastirit të shën Marinës, në Llëngë të Mokrës. Katër germa të fjalës së fundit janë zhdukur. Shkruar me germa të mëdha.

33.


Δέησις τοῦ δούλου τοῦ Θεοῦ Γεωργίου Μάνη.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, Gjergj Manit.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Kostandinit, nga Shpati, dhe gjendet i pikturuar pa datë në ikonën e shën Thanasit të ikonostasisit të kishës së Manastirit të shën Marinës, në Llëngë të Mokrës. Duhet t'i përkasë mesit të shek. XVIII, sepse në atë kohë piktori ka punuar edhe ikonat e tjera të kësaj kisha.

34.

+ Ἀνηστηρίθη ὁ θεῖος οὗτος καὶ πάνσεπτος ναὸς τῆς ἀγίας μεγάλωμάρτυρας τοῦ Χ(ριστο)ῦ Μα / ρίνις δια βοηθίας ὄλων τῶν / χρηστιανῶν καὶ ρουφετίων τῶν κτιστάδων καὶ ραυτά / δων καὶ μακελίων καὶ καρβανίων μικρῶν καὶ μεγάλων τῶν εὕρισκομῆνων ἐν τη πολητεία Λά / γκα. Κόπου δέ καὶ ἐξώδου τοῦ εὐλαβεστάτου Γέρασίμου ἱερεως καὶ ἐπιτηρητῆς τῆς ταγίας μον(ῆς) ταῦτης. Ἐπιστα / σία δὲ καὶ συνδρωμῆς τοῦ ἐντιμωτάτου προέδρου Γεωργίου τοῦ Νικόλα Μάνη ὁμοῦ καὶ τῶν σηνακου / λουθῶν αὐτῶν γερόντων ἐν ᾧ ἦσιν τὰ ὀνόματα ὁμοῦ καὶ τοῦ ἀρχιερατεύοντος καὶ τῶν ἱε / ρατευόντων θέμενα εἰς τὸν θεῖον ναὸν τοῦ ἀγίου Γεωργίου ἀνάμεσων τῆς πολιτείας εἰς δούλωσ / ιν τῶν ἀναγι(γ)ν(ω)σκόντων. Ἐτελ(ε)ιώθη ἐν ἔτη ἀπὸ Χ(ριστο)ῦ ΑΨΝΔ (= 1754) μηνῆ ὀκτωμβρίῳ Β.



Përktimi: U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i dëshmorese së madhe të Krishtit, shën Marinës, me ndihmën e të gjithë të krishterëve, të esnafëve, të mjeshtërve, të rrobaqepësve, të kasapëve dhe të karvaneve të vegjël e të mëdhenj, që gjenden në qytetin Lëngë; me përpjekjet dhe shpenzimet e të shumëdevotshmit prift Gerasimit dhe mbikqyrsit të këtij manastiri të shenjtë, me kujdesin dhe kontributin e të shumëndershmit, kryetarit Gjergj Nikollë Mani, së bashku me pleqtë që e pasonin atë, emrat e të cilëve së bashku dhe të peshkopit dhe të priftërinjve gjenden në tempullin hyjnor të shën Gjergjit, në mes të qytetit, si të ekspozuara për ata që do t'i lexojnë. U përfundua në vitin prej Krishtit 1754, muaj tetor 2.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i shkruar mbi portën perëndimore të naosit, brenda kishës së Manastirit të shën Marinës, në Lëngë të Mokrës, me gërma të mëdha, të zeza e mbi sfond të bardhë. Ruhet në gjendje mjaft të mirë. Kisha, e stilit bazilik njënefshe, për të cilën flet mbishkrimi, është e madhe 11. 85 x 6. 75 m. Mbishkrimi është botuar nga Th. Popa [46].

35.




+ Τοῦτω τῷ θεῖον καὶ ἱερὸν βύμα ἀνηστωρίθη δια δάπα / νις τοῦ Κώστη
εἰοῦ τοῦ Μάρκου Νήρρα εἰς ψυχικήν αὐτοῦ σωτηρίαν καὶ τῶν γοναίων.

Përktimi: Kjo kungë hyjnore dhe e hirshme e pikturuar me shpenzimet e Kostës, birit të Mark Nirrës, për shpëtimin e shpirtit të tij dhe të prindërve.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Kostandinit, nga Shpati dhe gjendet i pikturuar në faqen e murit lindor, mbi nikën e prothesit, në kungë të kishës së Manastirit të shën Marinës, në Llëngë të Mokrës, me gërma të mëdha, të zeza e mbi sfond të bardhë.

36.




+ Είσελεύσομαι εἰς τόν οἶκόν σου, προσκυνήσω πρὸς ναόν (τόν) ἅγιόν σου. / ἐν φόβῳ σου. Κύριε, ὀδήγησόν με ἐν τῇ δικαιοσύνῃ σου, ἔνε / κα τὸν ἐχθρῶν μου κατεύθυνον ἐνώπιόν σου τήν ὁδόν μου.

Përkthimi: Do të hyj në shtëpinë tënde, do të adhuroj në kishën e shenjtëruar tëndën, me frikën tënde, zot, më hiq udhën në drejtësinë tënde për punë të armiqëve të mi. Drejto përpara teje udhën time.

Shënim: Mbishkrimi është i dorës së piktor Kostandinit, nga Shpati, gjendet i pikturuar në portën perëndimore të narteksit të kishës së Manastirit të shën Marinës, në Llëngë të Mokrës, me gërma të mëdha, të zeza e mbi sfond të bardhë. Përkthimi shqip jepet simbas përkthimit të Kristoforidhit [47].

37.



α) + Χεῖρ Κωνσταντή(νου) (ἱερο) / διακόνου ἐκ Σπαθ(ίας).....
 β) + Χεῖρ Κωνσταντίνου ἱεροδιακόμου ἐκ Σπαθ(ίας)
 ἔτος ἀπὸ Χριστοῦ α ψ ξ ζ (= 1767).

Përkthimi:

a) Dora e jerodiakon Kostandinit, nga Shpati.

b) Dora e jerodiakon Kostandinit, nga Shpati, viti prej Krishtit 1767.

Shënim: Mbishkrimi me gërmën a) gjendet në një ikonë të Krishtit që ndodhet në fondin e Muzeut të Artit Mesjetar në Korçë, është tërhequr nga kisha e shën Prokopit, në Vërdovë të Pogradecit. Një gojëdhënë e vendit thotë se ikona ka ardhur nga Shpati i Elbasanit. Mbishkrimi është pa datë dhe i dëmtuar përgjysmë.

Mbishkrimi me gërmën b) gjendet në ikonën e Krishtit të ikonostasit të kishës së shën e Premtes, pranë Kavajës. Klisheja është e mbishkrimit me gërmën b).

38.



᾿Αφιερόθου + παρά + τῷ ἐντιμωτάτῳ + Κω(νσταντίνῳ) + ᾿Αναστασιῶ / Τρικούπα + λεγόμενος + Κοσμήσκ + ὡς μνιμώσινον / αὐτοῦ + ἐκ Μοσκοπόλεως + του καθηγουμένου + τοῦ ἁγίου / Ἰωάννου + τοῦ Βλαδημύρου + Κ(υρί)ου Θεοκλήτου + ἱερ(ο)μονάχου Α768 Μαΐου 22 +.

Përktimi: Ju dhurua nga i shumënderuari Anastas Trikupa, i mbiquajtur Kozmisk, nga Voskopoja, për kujtim të tij, igumenit të shën Gjon Vladimirit, jeromonakut zotit Theoklitit 1768, maj 22.

Shënim: Ky mbishkrim me germa të mëdha, është i gdhendur në një kuti prej argjendi me relikat të shën Gjon Vladimirit, dhe gjendet në kishën Lindja e shën Mërisë, në Kala të Elbasanit.

39.

Ἐν ἔτ(ε)ι – αψη (= 1778).

Përktimi: αψη = Në vitin 1778

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi një ikonë të vogël, me skenën e Krishtit, në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë.

40.

Το παρον ποτηριον υπαρχι της Παναγιας Νεοκαστρου, εκτισθη με τα ασπρα τις εκλισιας, επιτροπευοντος Παπα Στιλιαν(ος) (Ν)οσις. Χηρ Αποστολι του Λεγομενου Ιακοβου του Μικρου Ιουνηο 11 + εν 1780.

Përktimi: Ky potir, që u punua me asprat e kishës, është i së mbishenjtës së Neokastrës në kohën e epitropit Papa Stilian Nosit. Dora e Apostolit të mbiquajtur Jakovit të vogël, qershor më 1780.

Shënim: Mbishkrimi gjendet gravuar rreth bazamentit të potirit të kungatës në kishën Lindja e shën Mërisë, në Kala të Elbasanit. Potiri është prej argjendi dhe është punuar në mënyrë artistike të hollë. Nga kodiku i familjes Popa (Elbasan) [21] Jakovi i vogël rezulton si një nga stërgjyshërit e kësaj familje.

41.

1782

(Ἄνιστορίθη ὁ πάν)σεπτος ναος Ηπαπαντη του κυρηου ημων Ηυσου Χρι / στοῦ δυ α σινδρομικ κοπου τε δε κε εξοδου του πανοσιστατου καθυγου / μενου Αβακουμ ηερ ομοχανου αρχηερατευον ηπο θεοφηλεστατου Γαβρηηλ / Δρη(ι)νουπολεος κε Αργιρ οκαστρου επιτροπευον(τος) του τημοστατου Κηριο / Κηριο (Γι)αν(ν)η Θανασι εκ χο ρας Δροβηανης Δυα χυρος κ' αμου του / αμαρτολου Βασηλυ του Ηοανου εκ χορας Σηνκρηατη εν ετη 1799 / σεπτεβρηου 30.

Përkthimi: [U pikturua ky] tempull i gjithnderuar i zotit tonë Jezu Krisht me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e gjithoshënarit, igumen jeromonak Avakumit, në kohën e peshkopatit shumë perëndidashësit Gabrielit të Drinopojës dhe të Gjirokastrës, në kohën e kujdestarisë të shumënderuarit zoti, zotit Jan Thanasit nga katundi Dhrovjani. Me dorën time të mëkatar Vasilit të Janit, nga katundi Sikriati, në vitin 1799, shtator 30.

Shënim: Mbishkrimi gjendej i pikturuar mbi portën perëndimore, brenda kishës së Manastirit të Irapandisë, në Leshnicë të Sipërme të Sarandës. Sot nuk ekziston më, sepse ka rënë me gjithë suva.

861.

Δέησις τοῦ δούλου τοῦ Θεοῦ Παναγιότου 1799.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Panajotit 1799.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e shën Elefterit, në Kishën e Fjetjes së shën Mërisë, në Delvinë. Eshtë botuar nga Pulica [48, f.90].

862.

Η παρουσα θηκι τον αγιον ληψανον ηπαρχι του αγιου Νικολαου της / ιερας μονις Παλερμου. Δια εξοδου καθηγουμενου κηρ Χρισανθου (ι)ερομο / ναχου – 1800. Ναυι Χριεκοκας Θεοδορι.

Përkthimi: Kjo kuti e lipsanave të shenjta është e shën Kollit të Manastirit të hirshëm të Palermës. Me shpenzimet e igumenit, zotit, jeromonak Krisanthit 1800. Nano Kriekoka Theodori.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gravuar në një kuti lipsanash, në kishën e Manastirit të shën Mitrit, në Qiparo të Himarës.

863.



Ω πάτερ μέγιστε υἱέ κ(αὶ) πνεύμα όπου τό πᾶν διατηρεῖς με μόνον σου τὸν εν / το
 υς λατρευτὰς σ(ου) όπου τιμᾶς εἰς δόξαν μεγαλήνης κ(αὶ) δι' αὐτῶν ἁμαρτωλῶν τὰς
 αμαρτίας πλήνης / πρεσβίαις κ(αὶ) τοῦ δούλου σου πατρὸς ἄθανασίου μεγάλου Ἱερ
 ἄρχου τε δικαίου καὶ ὀσίου / ἁμαρτημάτων ἄφεσιν δανιήλ διακόνου δίδου αἰτούντι
 ση θερμῶς ἐν στεναγμῷ κ(αὶ) πονῶ / ὅτι ὄκωδόμησε λαμπρῶς εστολισεν μεγάλως κ(αὶ)
 αὶ) τοῦτον τὸν ἐνδοξον γάον μαζή κ(αὶ) μέ τούς ἄλλ(λ)ους / εἶη δεκτὸς ἀείμνηστε ὦ τ
 ριάς μακαρία αὐτῶν κ(αὶ) τῶν γονέων μας ψυχική σωτηρία / ὁ δανιήλ ἱεροδιάκονος
 ὁ σχολαρχοῦντι εἰς βουκου / ρέστι ὄντας ἀπο δῶ κ(αὶ) διὰ ἐξόδου κ(αὶ) δαπάνης αὐ
 τοῦ / θεμελίον κ(αὶ) ἡστορίας 1801 Ιουλίου 10:

Përkthimi: O at i shumëmadh, bir dhe shpirt që ruan gjithshka vetëm me.... adhuresit e tu që i nderon madhënoi me lavdi dhe nëpërmjet atyreve shlyej mëkatet e mëkatarëve dhe me ndërmjetësimet e shërbëtorit tënd, atit Athanasit të madh, jerarkut dhe të drejtit, dhe oshënarit jepi faljen e mëkateve diakon Danielit që të kërkon nxehtësisht me psherëtimë dhe dhimbje se ndërtoi në mënyrë të shkëlqyeshme dhe stolisi madhërisht këtë tempull të lavdishëm bashkë me të tjerët. Qoftë i pranuar o Trini e gjithmonhymnueme, qoftë i lumtur shpëtimi shpirtëror i atyreve dhe i prindërve tonë, jerodiakon Danieli, ai që është prej këndeje dhe që është drejtor i shkollës në Bukuresht, dhe me harxhet dhe shpenzimet e tij. [Data] e themelimit dhe e pikturimit, 1801 korrik 10.

Shënim: Mbishkrimi gjendet pranë kokës së portretit të jerodiakon Danielit, ktitorit, në faqen perëndimore në naos të kishës së Manastirit të shën Thanasit, në Leshnicë të Poshtme, rrethi i Sarandës.

864.

1811

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur mbi një gur në një nga harqet e konakëve të Manastirit të shën Mitrit, në Qiparo të Himarës. Duhet të tregoj kohën e ndërtimit të tyre.

865.



ΙΣ ΜΝΙΜΟΣΙΝΩΝ ΕΘΝΙΩΝ ΤΩΝ ΕΘΕΛ(Ο)ΥΣΙΩΝ ΣΤΡΑΤΙΟΤΩΝ ΑΛΒΑΝΙΤΩΝ Τ(Ο)Υ
ΒΑΣΙΛΕΥΣΑΤΩΝ ΔΙΟ ΣΙΚΕΛΙΩΝ ΑΠΟ ΧΟΡΙΩΝ Λ(Ο)ΥΚΟΒΟ, ΜΙΣΙΝΑ (= ΜΟΥΖΙΝΑ)
1813 ΑΙ ΕΤΩ (;) ΡΑΠΙΟΝΖΙΟ.

Përkthimi: Për kujtim të ushtarëve vullnetarë shqiptarë të mbretit të të dy Sicilive që ramë, nga katundi Lukovë, Muzinë 1813 prej meje Raponci.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i punuar në relief, rreth këmbanës së Manastirit të shën Mërisë së Krorzit, afër Sarandës. Është shkruar me gërma të përziera greke e latine. Dy fjalët e fundit (prej meje Rancit) i japim me rezerva. Nuk dihet nëse fjala Misinë e mbishkrimit i referohet një katundi të vogël, po me atë emër, që, simbas një gojëdhëne lokale të Shënvasisë, ka pasë ekzistuar dikur në bregdetin tonë, pranë Lukovës, apo qytetit italian Mesina. Mbishkrimi dokumenton faktin historik të njohur, simbas të cilit repartet shqiptare himariote, kanë shërbyer në ushtrinë e Ferdinandit të Napolit, mbretit të të dy Sicilive [7, f.151-157].

866.

Χειρος Πέτρου εκ χώρας Ποστενῶν Παλαιάς Πωγωνηανῆς, 1814 ὀκτομβρίου 27.

Përkthimi: Dora e Petros, nga katundi Postenan i Pogonianisë së vjetër, 1814, tetor 27.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e Krishtit të ikonostasit të kishës së shën Thanasit, në Selenicë të Vlorës. Edhe ikonat e tjera të ikonostasit të kësaj kisha rezultojnë punë të të njëjtit piktor. Postenani është katund i Kolonjës, por thënia e Pogomanisë tregon vartësinë kishtare të atëhershme.


867.

Τον κερρον που γινι το μαναστιρι ετος 1815 γεναρης / = 20 = ηταν προιγουμενος Παπα πανος απο Σοπικι κε ε(φη)μεριος Παπαβα / σιλις απο πινικι μαργαριτι Παπα απο κακοδικι κε ο / ηγουμενος τον αξιοσε η παναγια κετελιοσε με τι δυναμι τις π αναγης κε ηταν μαστορις Πρησιοινος νατις γκανη εξαρχος.

Përkthimi: Në kohën kur u ndërtua manastiri, viti 1815 janar 20, ishte igumen Papa Pano nga Sopiku dhe famulltar Papa Vasili nga Finiqi Margariti Papa nga Kakodhriqi dhe igumenin e meritoi e gjithë shenjta dhe e mbaroi... me fuqinë e shën Mërisë dhe mjeshtrit ishin nga Pirsojani

Shënim: Mbishkrimi gjendej në një pllakë guri të murosur në murin e konakëve të Manastirit të Kamenës, të cilat sot janë rënuar. Pllaka me mbishkrimin nuk dhet se ku gjendet. Mbishkrimin e kemi marrë nga Pulica [48, f.92].

868.



+ Οὗτος ὁ θῦος κ(αί) πάνσεπτος ναος τῆς Εἰπεραγίας Δεσποίνης ἡμῶν Θεοτόκου / κ(αί) Ἀείπαρθένου Μαρίας τῆς Κοιμήσεος τοῦ Πικλήν πυρρόου ἱστορίθ η μὲν διά / σηνδρομῆς κ(αί) δαπάνης τῶν ὀσιοτάτων ἱερομονάχων Ζακχαίου τοῦ ἐκ τῆς μο / νῆς Κατούνης κ(αί) Ζαχαρίου τοῦ ἐκ τῆς μονῆς Πεπέλεως, ἡγουμενεύοντος / τοῦ ὀσιωτάτου Βενιαμίν μοναχοῦ ἐκ Δενδροβιανῆς. Διὰ χειρός μὲν / ἐμοῦ τοῦ ταπεινοῦ Βασιλείου Ἀποστόλου ἐκ κόμης Φρασανᾶ / τῆς Παλαιᾶς Πωγωνιανῆς ἐν ἔτει 1820 ἰουνίου 10. / οἰκονόμος π(α)πα Κυριακὸς Εὐθυμιάδης.

Përkthimi: Ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i Fjetjes së mbishenjtës zonjës sonë Hyjëlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari i mbiquajtur Piruit u pikturua me kontributin, me shpenzimet e jeromonakëve të shumëdevotshëm Zakheut nga Manastiri i Katunës dhe Zaharisë nga Manastiti i Pepelit, në kohën kur ishte igumen i fortshënuari murg Veniamini nga

Dhendrovjani. Me dorën time të përvuajturit Vasil Apostolit nga katundi Frastana të Pogonianisë së vjetër. Në vitin 1820, qershor 10. Ikonom Papa Kiriako Efthimiadhi.

Shënim: Mbishkrimi ruhet brenda portës perëndimore të kishës së Manastirit, Fjetja e shën Mërisë, në Sirakot të Sarandës. Kisha ka madhësi 16.5x5.70 m.

869.

Παρθενιε 1820 Παισιος

Μαστορεις απο Πρισογιανη 1819

Përkthimi: Partheni 1820, Paisi. Mjeshtrit nga Pirsojani 1819.

Shënim: Mbishkrimi gjendet, mbi portën e Manastirit të Kamenës, pranë Delvinës. Është botuar nga Pulica [48, f.92].

870.

Ἀνεκενίσθησαν καὶ ἐστωρίθυσαν ἡ πάνσεμνες ἡκόνες καὶ ὁ τέμ(π)λος καὶ διὰ συνδρομῆς τοῦ κύρ Παπὰ Πάνου καὶ Κύρ Χρίστου Τζίκα ἐπιτρόπον / ἂν ἔτε: 1822 αὐγούστου 10 καὶ διὰ χ(ε)ιρὸς ἐμοῦ Δημητρίου ἐκ Στάρι / τσάνη.

Përkthimi: U përtërinë dhe u pikturuan ikonat e nderuara dhe ikonostasi me kontributin e zotit Papa Panos dhe zotit Kristo Çika, epitropëve, në vitin 1822 gusht 10. Me dorën time të Dhimitrit nga Stariçani.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar në ikonostas të kishës së shën Mërisë, në Malçan të Sarandës. Kisha është e stilit bizantin në formë kryqje me madhësi 12.10x7.23.

871.

1824

Ἰουνίου: 2

Χεῖρ δημητρίου

Στάριτσάνι Κόνιτσα

Përkthimi: 1824 qershor 2. Dora e Dhimitrit nga Stariçani. Konicë.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e Krishtit, në kishën e shën Kollit, në lagjen Kocati të Leshnicës së Poshtme të Sarandës.

872.

δέησις τοῦ δούλου τοῦ θεοῦ Τζάβο Ζίση διὰ πρεσβ(ε)ίης τοῦ 1825 (μαρ)τίου 6.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të perëndisë Çavo Zisi, me lutjet e tij, 1825 mars 6.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar në ikonën e Krishtit, në kishën e katundit Janicati të Sarandës.

873.


Ετου(το) (τό) πωτηρηον εφηαστη ης των γιερων τουτου Παπα Ζαχου /

χωρηον Κουδηση δεσποτε Βονγας πανη(ε)ροτατου – 1826 – Εκ χηρος εμου / του ταπηνου μαστορο Γηγοχα.

Përkthimi: Ky potir u bë për këtë kishë, Papa Zaho katundi Kudhëz, peshkopi i gjithhirshëm Vonga 1826. Nga dora ime e të përvuajturit, mjeshhtë Gjokës.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gravuar në potirin e kishës së shën Gjergjit të Kudhësit të bregdetit të Himarës. Me sa na ka komunikuar gojarisht nipi i tij, Papa Zaho ka qenë prifti i Kuçit. U burgos për dy vjet në Janinë nga Ali Pashë Tepelena në kohën e fushatës së këtij të fundit për islamizimin e popullsisë së krishterë. Kur u lirua nga burgu, prifti e gjeti Kuçin të islamizuar dhe u vendos pastaj në Kudhës, ku edhe vdiq më 1848.

874.



+ Ἰστορήθη ὁ θεῖος καὶ ἱερός ναὸς ἐπ' ὀνόματι / τῆς ἁγίας Τριάδος
 ἀρχιερατεύοντος τοῦ θεοφιλεστάτου / κυρίου Παΐσιου καὶ ἱγούμενος
 Ἰω(άννης), ἱερεὺς ἐπιτροπευοντο(v) / τῶν ἐντιμοτάτων Κωνσταντίνου
 καὶ Γεωργίου Χριστοῦ Κανάτζη / καὶ Νικολάου καὶ Γεωργίου Παν(α)
 γιότου Κανάτζι καὶ οἱ εὕρισκομ / ενοὶ χωριανοὶ Γιότι Ντεμῆρας, Λιολι
 Λαμπρα, Κωντι Κυ / Θανο Ἴνος Γιανη Τάσης, Ναση, Λαμπρος. / ἱστορήθη διὰ χε
 ἰρός Γεωργίου καὶ Ζήκου υἱοῦ αὐτοῦ χιοναδιτῶν ἐκ
 τῆς ἐπαρχίας τοῦ ἁγίου Βελ(λ)ᾶς - / 1827 Ἰουλίου 5.

Përktimi: U pikturua ky tempull hyjnor dhe i hirshëm me emrin e shën Triadhës, në kohën e peshkopit shumë perëndidashës, zotit Paisit dhe igumen Janit, priftërinjtë kujdestarë ishin të shumënderuarit Kostandin dhe Gjergj Kristo Kanaçi dhe Nikolla dhe Gjergj Panajoti dhe katundarët që ndodheshin: Joti, Demira, Loli, Llambro, Kondiko... Thano, Inos (?), Jani, Tasi, Nasi, Llambro. U pikturua me dorën e Gjergjit dhe Zikos, birit të tij fjonatas nga eparkia e shenjtit të Vellasë - 1827 korrik 5.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi portën perëndimore brenda kishës së Manastirit të shën Triadhës, mbi Kardhikaq të Sarandës.

875.

Διὰ συνδρομῆς καὶ (ἔ)ξοδον Χρισανθοῦ μοναχοῦ τοῦ προσκυνίτου, Ευγε / νίου, καλ
λινίχου, τον ιερομοναχον, μοναστηριου Ιωαννου του Θεολογου / Μαλτζανη α ω κ θ
(= 1829) μαρτιου ιε.

Përkthimi: Me kontributin dhe shpenzimet e murgut Krisanth Pelagrinit, Evgjenit dhe Kalinikut jeromonakëve të Manastirit të Jan Theologut të Malçanit, 1829, mars 15.

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi kryqin e madh prej argjendi në k shën e Manastirit të shën Gjjon Theologut, Cerkovicë të Sarandës.

876.

1831

Shënim: Kjo datë është e gdhendur mbi një gur, mbi portën perëndimore, jashtë kishës së shën Illiut, që gjendet mbi një kodër, në fushën e Vrinës, rreth 2 km, në lindje të Butrintit. Simbas një gojëdhëne lokale data duhet të tregojë ndonjë ndreqje të kishës, mbasi kisha mbahet si shumë e vjetër.

877.

Η παρουσα θηκη του αγηου κε πανσεβαζμηου μοναστηριου Θεολογου / ηπαρχια(ς)
Δελβι(ν)ου δ(ι)α χ(ε)ιρος καβιγουμενου Κυρ Καλ(α)θη(ν)ικου, Κιρ / Ευγεν(ι)ου ηερομ
αναχη 1832.

Përkthimi: Kjo kuti [është] e Manastirit të shënjtë e të gjithnderuar të Theologut, eparkia e Delvinës. Me doren e jeromonakëve igurjent, zotit Kalinik, zotit Evgjenit, 1832.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gravuar mbi një kuti të vogël lipsanash, në Manastirin e shën Gjjon Theologut në Cerkovë të Sarandës.

878.

Η παρουσα θηκη περι του τιμιου και παιπανσεπτου μοναστηριου /
Ιωαννου του Θεολογου η τις επαρχιας Δαιλβη(ν)ου η τις εκατασκεβαστη / παρα του
Κιρ Καλ(α)θη(ν)ικου ηερομον(ά)χου, εν ετη 1837: 10 απριληου.

Përkthimi: Kjo kuti është e manastirit të nderuar dhe të gjithnderuar të Jan Theologut, të eparkisë së Delvinës. Është punuar prej jeromonakut, zotit Kalinik, në vitin 1837 prill 10.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur mbi një kuti argjendi lipsanash të manastirit të shën Gjjon Theologut, në Cerkovicë të Sarandës.

879.




1847

Shënim: Data gjendet në ikonostas të kishës së shën Kollit, në Dhrovjan të Sarandës.

880.

1851 Μαΐου 10 / Λέησις τοῦ δούλου τοῦ / Θεο
ῦ Σπύρου ἱερέος. / Ἀφιέροσε διὰ τὴν ψυ / χὴν
τοῦ πατρός του / 2000 (γρόσια) διὰ τὸ τέ(μ)πλ

ο / εἰς μνημόσυνον / αὐτοῦ καὶ τῶν γο / νέων.



Përkthimi: 1851, maj 10.

Lutje e shërbëtorit të perëndisë, prift Spiros i cili dhuroi për shpirtin e tet 2000 grosh për tempullin (ikonostas), për kujtim të tij dhe të prindërve.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i shkruar në ikonostas, nën ikonën e shën Mërisë, në kishën e shën Mërisë, në Qiparo të Himarës. Simbas një gojëdhëne lokale 2000 groshët që prift Spirja i dha për ndërtimin e ikonostasit të kishës, i kishte marrë si zhdëmtim për vrasjen e të birit.

881.

ΔΕΗΣΙΣ ΤΩ ΔΑΔΑ ΤΩ ΘΕΩ
ΣΟΚΡΑΤΩ ΛΕΚΑ 1859

Klisheja e transliterimit

Δέησις τοῦ δούλου τοῦ Θεοῦ / Σοκράτου
(ς) Λεκά 1859.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Sokrat Lekës 1859.

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi ikonën e shën Spiridhonit, në kishën e shën Spiridhonit, mbi Qiparo të Himarës. Shifrën e dhjetësheve që ne e kemi dhënë 5, nuk lexohet shumë qartë.

882.

Ωκοδομηθη 1867

Përkthimi: U ndërtua më 1867

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur në një gur, mbi portën e kambanarisë së kishës së shën Mërisë (27 m. e lartë), në Qiparo të Himarës.

883.

Δια σινδρομης και εξοδον Χρισανθου μοναχου του προσκυνιτου,
Ευγενιου, Καλλινικου, τον ιερομοναχον. Μοναστηριου Ιωαννου, του
Θεολογου, Μαλτσανη α ω χ θ (= 1869) μαρτιου ΙΕ.

Përkthimi: Me kontributin dhe shpenzimet e murgut Krisanth pelegrinit, Evgjenit, Kalinikut, jeromonakëve të Manastirit të shën Gjon Theologut, Malçan 1869, mars 15.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur mbi bazamentin e një kryqi të madh argjendi të Manastirit të shën Jan Thologut, në Malçan të Sarandës.

884.

Χειρ Γεωργίου Καλημερη κατά τὸ 1870, ἐν Δελβίνῳ.

Përkthimi: Dora e Gjergj Kalimerit, më 1870, në Delvinë.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e shën Mërisë, në kishën e shën Thanasit, në Lukovë të Sarandës.

885.

1871

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në gur, mbi portën perëndimore të kishës së katundit Çoraj të Kurveleshit dhe tregon kohën e ndërtimit të saj.

886.

1876

Shënim: Kjo datë gjendet në ikonën e Irapandisë, në kishën e Irapandisë, në Dhivër të Sarandës.

887.

Ἔργον Δημητρίου

Κεφαλλῆνος

Ἐν Πάτρα(ι)ς

– 1878 –

Përkthimi: Punë e Dhimitrit Qefaliniasit, në Patras 1878.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e shën Spiridhonit, në kishën e shën e Premtes, në lagjen Koçati të Leshnicës së Poshtme të Sarandës. Të dorës së piktor Dhimitrit janë edhe shtatë ikonat e mëdha si edhe të gjitha ikonat e vogla të kësaj kishe.

888.

1878

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur mbi një gur të portës perëndimore, të kishës së shën Triadhës, në Dhivër të Sarandës. Duhet të tregojë kohën e ndërtimit të kishës.

889.

Δια χειρός Διμη(τρίου) τοῦ Νικ(ολάου) καὶ Ἀναστασίου Μιχαήλ

Ζωγράφου ἀπὸ χωρίον Χιονάδες ἐκ τῆς ἐπαρχίας Κονίτσης 1882.

Përkthimi: Me dorën e Dhimitrit të Nikollës dhe Anastasit të Mihail Zografit, nga katundi Fjonjati, eparkia e Konicës, 1882.


Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi faqen e murit verior në kishën e Manastirit të shën Todhrit, në Dhërmi të Himarës. Mbishkrimi i referohet pikturës së vonë, kurse nën këtë dallohen edhe dy shtresa të tjera me piktura të vjetra.

890.

1882

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në një gur, mbi portën e kishës së Vrionit të Vurgut. Duhet të tregojë kohën e ndërtimit ose rindërtimit të kishës.

891.



Ὁ κτήτωρ τῆς Ἐκκλησίας ταύτης Οἰκονόμος λαμπρέων Παπ(ὰ) Ἀναστασιος. / 1883 ἄπρ(ιλίου) 13. / Ἱστορίθη διὰ χειρὸς Δη(μητρίου), Νι(κολάου) καὶ Ἀν(τωνίου) Μι(χαήλ) Χιοναδίτες.

Përkthimi: Ktitori i kësaj kishe është ekonomi i Llambrejve, Papa Anastasi, 1883 prill 13. U pikturua me dorën e Dhimitrit të Nikollës dhe Andon Mihalit, fjonjatsve.

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi nikën veriore, në kungë të kishës së shën Gjon Pagëzorit, në Vuno të Himarës.

892.

1883

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në një gur, mbi portën perëndimore, jashtë kishës së Manastirit të shën Gjon Theologut, në Cerkovicë të Sarandës. Tregon kohën e rindërtimit të kishës.

893.

1883 μαστορας Κολα Κον(σταντῖνος) – ζααπο πο.... στονανι

Përkthimi: 1883 Mjeshtri Kola Kon(standin) Zhapo (?).....

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur në një gur, mbi murin perëndimor të kishës së Manastirit të shën Gjon Theologut në Cerkovicë të Sarandës. Për mungesë të disa gërmave fjalët e fundit nuk i lexojmë dot.


894.

1885

Shënim: Kjo datë ruhet mbi portën e kishës së Finiqit të Vurgut. Duhet të tregojë kohën e ndërtimit ose të rindërtimit të kishës.

895.

+ Στερεωσον (Κύριε) την αγιαν μονην ταυτην τ / ου επηφενοντως εργον ηγουμενο(υ) / Ανθημου Παπανικολαου Μουζηνα / ετος 1892 Σταυρο(υ) και Νικολα Μαρα, Κοῦζ τα.



Përkthimi: Forcoje këtë Manastir të shenjtë, vepër e të shquarit igumen Efthim Papanikollës. Muzinë 1892. Stavro dhe Nikollë Mara, Kosta.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur në dru në ikonostasin e kishës së Manastirit të shën Kollit, në Mesopotam të Sarandës.

896.

Χεῖρ Καλλινίκου Ἱερομονάχου Βασιλάκη – 1892

Përkthimi: Dora e jeromonak Kalinikut, Vasillaqit 1892.

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi ikonat e reja të paraklisit të shën Spiridhonit, në Dhivër të Sarandës.

897.

Χεῖρ Χρυσάνθου ἱερέως Πλατσέου – 1896.

Përkthimi: Dora e Krisanthit, priftit të Placeut 1896.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e shën Spiridhonit, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Senicë të Sarandës.

898.

Χεῖρ Ἀθ(ανασίου) Κ. Βυζαντίου εἰς 1899.

Përkthimi: Dora e Athanas K.Bizantit 1899.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonë të Krishtit e të shën Mërisë, në kishën Fjetja e shën Mërisë, në Senicë të Sarandës. E këtij autori është edhe ikona e shën Mërisë që ndodhet në këtë kishë.


899.

Δέησις καὶ ἐξώδου τοῦ δούλου τοῦ Θεοῦ Θανάσι κύκα 18 / μαΐου 30.

Përkthimi: Lutje dhe me shpenzimet e shërbëtorit të perëndisë, Thanas Kikës 1811, maj 30.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në një ikonë të Krishtit, marrë nga kisha e çiflikut të Konispolit e që sot ruhet, pranë Muzeut të Artit Mesjetar, Korçë. Ikona paraqitet e dëmtuar rëndë nga tenja.

900.



Ι Γ Σ


Shënim: Këto tri shifra (10, 3, 200), për ne të padeshifruara, gjenden të gdhendura mbi gurin arkitra të portës jugore të kishës së vjetër të shën e Premtes, në Lukovë të Sarandës. Kisha është njënefshe me mbulesë prej qemeri dhe me një kube cilindrike, me madhësi 9x3.50 m.

901.

+ βοήθη τῷ δούλῳ σου Κυριάκ(ο)ς τ.....

Përktimi: ... ndihmo shërbëtorin tënd Qiriako...**Shënim:** Mbishkrimi gjendet i shkruar me tulla gjatë faqes së murit perëndimor në gërmadhat e kishës së Manastirit të dyzetë shenjtorëve, mbi qytetin e Sarandës. Gërmat kanë lartësi 20 cm.

902.

**ECOLE S-te CATHERINE****Përktimi:** Shkolla e shën Katerinës**Shënim:** Mbishkrimi gjendet mbi një potir prej argjendi, në kishën e Manastirit të shën Mërisë së Krimarovës, mbi Piqeras të Sarandës.

903.

διὰ χειρὸς καμοῦ
 τοῦ ἀναξίου Λαζάρου
 ἐξ ἄνο σουδενὰ Ζαγόρη
 διὰ σινδρομῆς παρθενίου ἡγουμένου.

Përktimi: Me dorën time të pamerituarit Blazar nga Ano Sudhena e Zagorisë, me kontributin e igumen Parthenit.**Shënim:** Mbishkrimi gjendet në ikonën e madhe të Krishtit, në ikonostas të kishës së Manastirit të shën Thanasit, në Leshnicë të Poshtme të Sarandës, Delvinës.

904.

Ὁ ἡγούμενος τῆς μονῆς κάλ(λ)εστρος ἱερομονάχος
 Ὁ ἡγούμενος τοῦ Θεολόγου Στέφανος ἱερομονάχος

Përktimi: Igumeni i manastirit, jeromonak Kalestri
 Igumeni i Theologut, jeromonak Stefani**Shënim:** Këto mbishkrime gjenden pranë portreteve të igumenëve të pikturuar, mbi faqen e murit jugor të kishës së Manastirit të shën Kollit, në Dhivër të Sarandës. Portretet mbajnë ndër duar maketin e kishës së Manastirit.

905.

Ἰστορίθη ὁ θεῖος οὗτος καὶ ἱερός ναὸς εἰς ὀνόματα τοῦ ἀγίου Στε /
 φάνου Προτομάρτυρος καὶ ἐπιστάτη συνδρομητῆς κύριος Πάνο χιομάρα. / Ἰστορίθη
 ἡ διὰ χειρῶς μηχαήλ καὶ Κωνστα(ντίνου) τοῦ ἀγίου βελ(λ)ᾶς...

Përktimi: U pikturua ky tempull hyjnor dhe i hirshëm në emër të shën Stefanit, dëshmorit të parë, dhe me kujdesin e kontribuesit, zotit Pano Gjomara. U pikturua me dorën e Mihalit dhe të Kostandinit nga eparkia e shenjtit të Vellasë.**Shënim:** Mbishkrimi gjendet pa datë në ikonostasin prej muri të kishës së shën Stefanit, në Dhërmi të Himarës.

906.

Δέησης τοῦ δούλου τοῦ Θεοῦ Κυρίου Χρηστοφόρου Μπτζήλη καὶ τοῦ ἀδελφοῦ αὐτοῦ Δημητρήου σὴν τὰ τέκνα αὐτοῦ.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të perëndisë, zotit Kristofor Bëxhili dhe të vëllait të tij Dhimitrit, bashkë me fëmijët e tij.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i shkruar mbi faqen e brendshme të timbanit të kubesë, ndërmjet pikturave të profetëve Mojsiut dhe Ilisë, në kishën e Manastirit të shën Mërisë, në Dhërmi të Himarës.

907.

Ἀνιγέρθη τὸ καλλοπίσθη ὁ θεῖος καὶ πάνσεπτος οὗτος ναὸς τῆς Ὑπεραγίας Δεσποίνης ἡμῶν Θεοτόκου καὶ Ἀοιπαρθένου Μαρίας, διὰ σηνδρ(ο)μῆς κόπου τὸ τοῦ Κυρίου Δημητρίου Γγίκα Νάκου, ἀρχιερατείας οντος τοῦ θεοφιλεστάτου καὶ λογιωτάτου ἐπισκόπου Χιμάρας καὶ ἀελοβήνου Ἰωαν(ν)ίκι(ου).....

Përkthimi: U ndërtua e u stolis ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuem i së mbishenjtes, zonjës sonë Hyjëlidëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin, përpjekjet e zotit Dhimitër Gjikä Nakut, në kohën e peshkopatit të shumë perëndidikshësit dhe të shumëditurit peshkopit të Himarës dhe Delvinës Joaniqit nga qyteti Janinës. Me dorën e

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi portën brenda kishës në shpellë të shën Mërisë, në Kostar të Sarandës. Fjalët e fundit në mbishkrim janë dëmtuar dhe nuk lexohen.


908.

Τὰ περισ(σ)εύματα Χρυστέ κλασμάτων νὰ βλογήσης ξένοι, πτοχοὶ νὰ τρώ / γωσι, πεινῶντα(ς) μὴν ἀφήσης.

Përkthimi: Mbeturinat e copave të [bukëve] ti bekosh që të hanë të huajt, të vobegtit, të uritur mos lerë.

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi një faqe muri, pranë skenës darka mistike, në godinën veriore pa çati të Manastirit të Kamenos, mbi Delvinë.


909.



δέησης του / δουλου σου / μανασης / ιερομο να / χου κε / ιγουμε / νου.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit tënd Manasit jeromonak dhe igumen

Shënim: Mbishkrimi gjendet në ikonën e kryeengjëljeve, në kishën e Apostujve Pjetrit e Pavlit, në Dhrovjan të Sarandës.



910. →

δέησις τες δού / λες του Θεοῦ δα / μηανι μοναχίς / κ(αί) στασινίς / μόναχίς / κ(αί) Χριστινας μοναχίς.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorëve të perëndisë murgeshës Damjanisë dhe Stasinisë dhe murgeshës Kristinës.

Shënim: Mbishkrimi gjendet në një ikonë të ikonostasit të kishës së Manastirit të Dhivrovunit të Sarandës.

911.



Δεισις του δουλ /
ου του Θεου λεκα, /
ζαφिरα, / ζαφिरα /
Χιλα, Γικα, / χιλα Γικ
(α) / Γιοκα / Λεκα /
Δουκα / Γουγκα /
Θοδο / ρα, Μαρα.

Përkthimi: Lutje e shërbëtorit të perëndisë Leka, Zafira, Zafira....
Hila, Gjika, Hila, Gjike Gjoka, Leka, Duka, Guga, Theodora, Mara.

Shënim: Mbishkrimi gjendet pa datë, në faqen e murit lindor, ndërmjet prothesit dhe apsidës, pranë pikturës së shën Stefanit, në kishën e shën e Premtes, në Dhërmi të Himarës.

Κατά την εξέταση των αποτελεσμάτων της έρευνας, οι ερευνητές διαπίστωσαν ότι η χρήση των μέσων μαζικής ενημέρωσης...

Η έρευνα πραγματοποιήθηκε σε διάφορα σημεία της χώρας...

Τα αποτελέσματα της έρευνας δείχνουν ότι...

Οι ερευνητές προτείνουν να ληφθούν μέτρα...

Η έρευνα χρηματοδοτήθηκε από το Υπουργείο...

Το κείμενο αποτελεί μέρος της έκθεσης...

Η έρευνα πραγματοποιήθηκε από τον...

Τα αποτελέσματα της έρευνας...

Οι ερευνητές προτείνουν να...

Η έρευνα χρηματοδοτήθηκε...

Το κείμενο αποτελεί μέρος...

Η έρευνα πραγματοποιήθηκε...

Τα αποτελέσματα της έρευνας...

Οι ερευνητές προτείνουν να...

Η έρευνα χρηματοδοτήθηκε...

Το κείμενο αποτελεί μέρος...

Η έρευνα πραγματοποιήθηκε...

Τα αποτελέσματα της έρευνας...

Οι ερευνητές προτείνουν να...

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

VI. MBISHKRIMET E ZONËS SË SHKODRËS

912.

HOCTEMPLVMFRATRVMMINORVM
AEDIFICATVMESTANNODOMINI MCC40

Klisheja e transliterimit

HOC TEMPLUM FRATRUM MINORUM
AEDIFICATUM EST ANNO DOMINI MCC40

Përkthimi: Ky tempull i fetënve të vegjël u ndërtua në vitin e zotit 1240.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur në gurin arkivua të portës perëndimore të kishës së shna Ndout, në Lezh, me shkrim të vonë. Me shumë probabilitet duhet të regjistrojë ndonjë gojëdhënë të vjetër, mbi origjinën e kishës, që është bazilikë njëefshe me mbulesë gjysmë cilindrike, pa penxhere. Ka të ngjarë të jetë rindëruar simbas stilit të saj të vjetër. Është botuar nga Th.Ippen [52].

913.

† ΠΕΜΤΟΧΟΝΕ ΦΑΝΥΛΕΤΕ
Η ΕΛΕΝΕ ΡΕΓΙΝΕ ΣΕΡΒΙΕ ΔΥΟ
ΚΛΙΕ ΑΛΒΑΝΙΕ ΧΙΛΣΙΕ ΤΟ ΑΛΜ
ΑΚΙ ΕΤ ΜΑΡΙΤΙΜΕ ΡΕΓΙΟΝΙ
Ο ΒΕΥΗΑ CΥ ΦΙΛΙΙΣ ΣΒΙΣ ΡΕΓ
Ι ΒΥΡΟΣΙΟ ΕΤ ΣΕΡΗΑΟ ΕΔΙΦΙCΑ
ΒΙΤΟ ΗΟΒΟ ΙΝΑ ΕCΚΛΙΑ ΡΟΗΟΝΟ
ΡΕ ΒΕΑΤΟ Ζ ΜΡΤΙΡ Β ΣΕΡΓΙΙ ΕΤ
ΒΥΑΝΙ ΕΤ ΡΟ ΦΙ Η Ε Β Σ Φ CΟ ΡΙ Ε Β
ΙΤΑ ΗΝ Θ Η Ι Μ C C Ι Χ Χ Χ Χ


† ΠΕΜΤΟΧΟΝΕ ΦΑΝΥΛΕΤΕ
Η ΕΛΕΝΕ ΡΕΓΙΝΕ ΣΕΡΒΙΕ ΔΥΟ
ΚΛΙΕ ΑΛΒΑΝΙΕ ΧΙΛΣΙΕ ΤΟ ΑΛΜ
ΑΚΙ ΕΤ ΜΑΡΙΤΙΜΕ ΡΕΓΙΟΝΙ
Ο ΒΕΥΗΑ CΥ ΦΙΛΙΙΣ ΣΒΙΣ ΡΕΓ
Ι ΒΥΡΟΣΙΟ ΕΤ ΣΕΡΗΑΟ ΕΔΙΦΙCΑ
ΒΙΤΟ ΗΟΒΟ ΙΝΑ ΕCΚΛΙΑ ΡΟΗΟΝΟ
ΡΕ ΒΕΑΤΟ Ζ ΜΡΤΙΡ Β ΣΕΡΓΙΙ ΕΤ
ΒΥΑΝΙ ΕΤ ΡΟ ΦΙ Η Ε Β Σ Φ CΟ ΡΙ Ε Β
ΙΤΑ ΗΝ Θ Η Ι Μ C C Ι Χ Χ Χ Χ

Klisheja e transliterimit

Mem(en)to D(omi)ne famule tue / Helene Regine Servie, Dyo / clie, Albanie, Chilmie, Dalm / acie et Maritime Regionis, que una cu(m) filiis suis reg / ib(us) Urosio et Step(ha)n(o) edifica / vit de novo istam eccl(es)ia(m) ad hono / re(m) beatoru(m) m(a)rtiru(m) Sergii et / Bachi et ad fine(m) usq(ue) co(m)plev / it ann(o) D(omi)ni MCCLXXX (= 1290).

Përkthimi: Kujto o zot, shërbëtoren tënde Helenën, mbretëreshën e Serbisë Dioklesë, Shqipërisë, Hilmës dhe krahinës detare, e cila bashkë me të bijtë e vet mbretërit Uroshin dhe Stefanin ndërtoi përsëri këtë kishë për nder të martirëve të lumtur Sergiut dhe Bakut, dhe e kreu plotësisht në vitin e zotit 1290.

914.



In No(m)i(n)e D(omi)ni Am(en). Eximie Virginis Filii anno M.X.V.I.I.I. magnific(us) D(omi)n(u)s D(omi)n(u)s Urosi(us) D(e)i g(r)at(ia) / Basie rex illustris magnifici regis Urosii natus(atque) D(omi)ne Helene regine edificavit ha(n)c eccl(es)iam / in (h)onore(m) s(anc)t(oru)m m(artiru)m (Ser)gii et Bacchi a fundam(en)tis u(s)que adfin(em), (asis) tente Abbate Petro Dochne Scutare(n)si.

Përkthimi: Në emrin e zotit amin. Në vitin e të birit të virgjines së lartë 1318 zoti i madhërueshëm Uroshi, për hir të perëndisë, mbret i Rashës, djalë i të madhërueshmit dhe të shkëlqyeshmit mbret Uroshit dhe i zonjës mbretëreshë Helenë, ndërtoi këtë kishë për nder të shenjtorëve martirë Sergiut e Bakut që prej themelesh deri në fund, me ndihmën e Abatit Pjetër Dohn Shkodranit.

Shënim: Këto dy mbishkrime janë gdhendur mbi gurë të mëdhenj me gërma latine të mëdha, të vjetra. I pari me madhësi 1.45x0.64 x0.28 m. dhe i dyti 2.40x0.32x0.38 m. Guri i parë ka qenë murosuar në anën veriore të portës perëndimore të kishës së shën Sergiut e Bakut, në Shirq të Shkodrës, kurse i dyti në mënyrë horizontale si arkitra i portës. Guri me mbishkrimin e dytë është i thyer në mes në dy pjesë dhe është dëmtuar në vendin e datës aq sa kjo sot nuk lexohet. Në vitin 1953 gurët me mbishkrime i gjetëm të rënë në lumin Bunë, i nxorrëm nga ujët dhe i vendosëm në Muzeun e Shkodrës. Tani gjenden në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.

Këto mbishkrime janë botuar:

Më 1875 nga Augustino Theiner [59, f.13-17] me rastin e botimit të një materiali arkival mbi gjendjen e kishave në Shqipëri këtë material (relacion) ai e konsideron si të Pjetër Bogdanit. Mbishkrimet në relacion janë dhënë vetëm të transkriptuara. Mbishkrimi i gurit të thyer në botimin e Theinerit rezulton me datën 1318, e cila mendojmë të jetë e saktë, mbasi në relacionin e supozuar të P.Bogdanit, nuk bëhet fjalë për thyerje guri aso kohe.

Më 1899 nga Th.Ippen [17, f.93-94], i cili datën e gurit të thyer e jep me hamëndje 1293.

Më 1901 nga A.Degrad [8, f.82-83] ashtu siç ruhen sot, pa komente.

Më 1930 nga M.Sirdani [54, f.14] me komente.

Më 1939 nga Serxhio Betini [6, f.93-146].

Kisha e Shirgjit (Serguit), së cilës i referohen mbishkrimet, në popull quhet edhe shna Prendes. Ka mundësi që rindërtimi i dytë i kishës (1318) vetëm nga Uroshi, për arsye të dëmtimit nga lumi (Buna), të mos jetë bërë në vendin, ku ndodhej kisha e parë, por pak më brenda, eventualisht në vendin e ndonjë kapele të vogël paraekzistuese të shën e Premtes. Kështu

ndoshta do të mund të shpjegohej më drejt shprehja "e ndërtoi" e mbishkrimit të Uroshit dhe fakti i ekzistencës së dy mbishkrimeve të ndryshme në të njëjtën ndërtesë.

915.

Ano D(omini) M(C)CCCLXII
- Mem(en)to D(omi)ne famul(or)um
tu(or)u(m) Perlatarum cum
o(mn)ib(us) suis am(icis).

Përkthimi: Në vitin e zotit 1462

Kujto o zot shërbëtorët e tu

Perlatët së bashku

me të gjithë miqtë e tyre

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur mbi një rrasë gurë të murosur në apsidë jashtë kishës së Baldresë, në bregun e djathtë të Drinit, një orë larg nga Lezha. Mbishkrimi është botuar më 1903 nga Th.Ippen [17, f.183], i transliteruar, i transkriptuar e me komente.

Sipas Ippenit rrasa me mbishkrimin duhet të ketë qenë gur varri mbi varr të familjes së Perlatajve, të dëgjuar në historinë e Skënderbeut dhe se shprehja Perlataj ose duhet të jetë gdhendur gabimisht nga gurgdhëndësi ose duhet të ketë pasë lexim të ndryshëm në gjuhën e asaj kohe.

916.

1447. a. di 7 Augustus questa croci fecie fare il Senor Polo Ducagin in tempo di Pr(oto) Sigeli Pilo Duca e mi Niesa Adamovic feci.

Përkthimi: 1447 më 7 gusht. Këtë kryq e porositi, zoti Polo Dukagjini, në kohën e Pr(oto)singjel Pilo Dukës dhe e bëra, unë Nikola Adamoviçi.

Shënim: Mbishkrimi ishte i gravuar në një kryq argjendi të kishës së Abacisë së shën Aleksandrit të Oroshit. Kryqi u dogj me altarin e kishës më 1896. Mbishkrimi është botuar i fotografuar me kryqin më 1901, nga A.Degradand [8, f.144] dhe pa fotografi më 1902 nga Th.Ippeni [17, f.188]. Ne e kemi marrë nga Th.Ippeni.

917.

1465

Shënim: Data, me shifra arabe, gjendet e gdhendur në një gur, mbi portën e kishës së shën Markut, në Kala të Vaut të Dejës. Mendojmë të jetë e një kohe të vonë e të regjistrojë ndonjë gojëdhënë më të lashtë, mbi kohën e ndërtimit të kishës.

918.

Protege Domine
indignum
famulum A
bat: Inocen-
t: cum oib: fra
treb: ecclesie

Mbroje o zot,
shërbëtorin e
padenjë A-
bat Inocentin
me të gjithë vëllezë
rit e kishës

Shënim: Mbishkrimi gjendet ndërmjet figurës së shën Mërisë dhe figurës së një peshkopi, në kishën e shën Salvadorit, në Rubik. Mbishkrimi është diktuar e lexuar për herë të parë, nga P.Fabian Varcatta, transliterimin e të cilit e botoi për herë të parë Th.Ippen [17, f.23].

Më 1964 mbishkrimi është botuar nga Dh.S.Shuteriqi [58, f.24] dhe Dh.Dhamo [9, f....] me interpretime të ndryshme.

919.

a) Accipite et manducate ex hoc omnes

Hoc est enim corpus neum

b) Accipite et bibite ex hoc omnes

Hic est enim calix sanguinis mei.

Përkthimi:

a) Merrni, hani prej këtij të gjithë

Ky është trupi im

b) Merrni e pini prej këtij të gjithë

Ky është gjaku im

Shënim: Mbishkrimi a) gjendet mbi krerët e tre apostujve, Simon Kananaut Llukajt dhe Pjetrit, ai b) gjendet mbi krerët e tre apostujve të tjerë, Matisë, Janit dhe Andresë, në faqen e murit lindor të kishës së Salvadorit (Shpëtimtarit), në Rubik. Mbishkrimi është tekst ungjillor. Është botuar më 1899 nga Th.Ippen [17, f.23].

920.

Hoc templum consecravit R(everendus) D(ominus) Joannes Brunnus Archiepiscopus Antivarensis Anno incarnationis D(omi)ni M D LV I I D(ie) Secundo DIM (= Decembris).

Përkthimi: Këtë tempull e shpëtoi i ndershmi Jan Bruno, Kryepeshkop i Tivarit, në vitin e mëshërimit të zotit 1557 ditën e dytë të dhjetorit.

Shënim: Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi faqen e brendshme të murit perëndimor të kishës së Kuvendit të shna Ndout në Laç. Simbas një gojëdhëne kjo kishë në kohëra të vjetra quhesh e Evangjelizmosë (Ungjillëzimit).

Mbishkrimi është botuar më 1900, nga Th.Ippen [17, f.521] me komente.

921.

MDLXII

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në gur, mbi një altar në perëndim të kishës së dom Lleshit (shna Ndujt), në Lezhë. Duhet të tregojë kohën e ndërtimit të tij.

922.

Anno D(omi)ni MDCV hoc templum ruinam minuebat idcirco A.

R(everendo) D(omino) PF Joanne Coellession tunc temporein hoc sacro

mpnas President(e) (ab)eo repar... tum fuit.

Përkthimi: Në vitin e zotit 1605 ky tempull ishte në rrezik rrënimi, prandaj duke qenë i nderuari Jan Kalesio, në atë kohë, kryetar në këtë manastir të shenjtë.... prej tij u rindërtua...

Shënim: Mbishkrimi gjendet mbi faqen e murit jugor të kishës së shna Ndout, në Laç të Milotit. Është botuar më 1900, nga Th.Ippen [17, f.521].

923.


Lano 1672 fubrigiato Pedana la cella.

Përkthimi: Në vitin 1672 u dogj qelija Pedana.**Shënim:** Mbishkrimi gjendet pranë freskës së shën Gjergjit, në faqen e murit perëndimor jashtë kishës së shën e Premtes, në Pllanë të Milotit.

924.

Originali mungon.**Përkthimi:** Themeluar më 7.IV.1859.**Shënim:** Mbishkrimi gjendet i pikturuar mbi një gur në anën veriore të altarit të kishës së zonjës së këshillit të mirë, në Shkodër. Mbishkrimi është shkruar vonë me shumë probabilitet, në bazë të ndonjë dokumenti të hershëm.

925.

**Përkthimi:**

(Tem) poribus

Rex Uros

Abas Jobo

.....

Cum universo

suo clero

fecerunt(t)

Në kohën e

Mbretit Urosh

abat Jovo

.....

me të gjithë

klerin e vet

e ndërtuan,

Shënim: Mbishkrimi gjendet i gdhendur në një gur të altarit të kishës së rrëzuar të shën Kollit të Nënshatit, një orë afër kishës së Mazarekut, në lindje të Shkodrës. Mbishkrimi është botuar më 1900 nga Th.Ippen [17, f.83-97], nga i cili e kemi marrë edhe ne.

925 / 1

Originali dhe përkthimi mungojnë.

Shënim: Kjo datë gjendet e gdhendur në një gur që ishte i murosur mbi murin e kishës së shën Aleksandër Nevskit, në Shkodër. Simbas një gojëdhëne lokale kisha kishte për t'u ndërtuar në emër të shën Gjergjit, por mbasi pushteti turk e pengonte ndërtimin, u kërkua ndërhyrja e konsullit

rus në Shkodër, pranë pashës, gjë që siguroi mbrojtjen e ndërtimit deri në përfundim të objektit. Më vonë kisha u konsakrua në emër të shën Aleksandër Nevskit.

926.

Meca Ep(i)s(copi) Stepha(nensis) et Be(ndensis).

Përkthimi: Meka e peshkop Stefaniakës dhe Bendës.**Shënim:** Mbishkrimi gjendet rreth një vule të gjetur nga fshatarët në fshatin Skuraj të Kurbinut, afër Krujës. Është botuar më 1902 nga Th.Ippen [17, f.367], nga i cili po e marrim edhe ne. Në


"Illyricum Sacrum" të Farlatit përmenden Stephanum ose Stephaniacum dhe Benda si peshkopata sufragante të kryepeshkopatës së Durrësit. Gjithashtu simbas Ippenit në arkivin e Vatikanit Nunciatura Graeca, vol.75, gjenden gjurmë mbi peshkopin Meca, në Stephanum.

927.

Përkthimi: O perëndi
perëndia e
jonë (ti) që
(bukën)
qiellore

Shënim: Mbishkrimi gjendej mbi apsidën, në kungë të kishës së zonjës, në Vau të Dejës, sot nuk ekziston më. Eshtë botuar nga Th.Ippen më 1899 [17, f.609], nga i cili e kemi marrë edhe ne.

928.



..... XXXXX adi
primo di Setembrio, Ser
..... Marg Paboni nga
Navilio.

Përkthimi: XXXXX më datën 1 shtator zoti Marg Pabonsi nga Navilio.

Shënim: Ky mbishkrim i fragmentuar gjendet në një gur të gjatë, vendosur mbi portën jugore të kishës së shna Ndojt, në Lezhë.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κοινότητας

PASTHËNIE E REDAKTORËVE

Më sa fundi korpusi i mbishkrimeve të kishave në Shqipëri ka arritur fazën e botimit. Botuesit e këtij libri kanë nderin t'i paraqesin botës shkencore dhe lexuesit të thjeshtë këtë libër të vetëm referimi, të vetëm sepse një vepër e tillë e përpiluar me kaq hollësi, me sa dimë ne, nuk është realizuar kurrë më parë në Shqipëri ose nga studiues të tjerë në ndonjë vend tjetër të Ballkanit ose dhe jashtë tij dhe se ai përfaqëson një kontribut madhor në dijen shkencore. Megjithëse joshterues, ky vëllim përfshin shumicën e mbishkrimeve të kishave në Shqipëri. Autori nuk e ka kufizuar katalogun e tij të mbishkrimit në faqet e jashtme dhe të brendshme të ndërtesave kishtare në fjalë. Ai ka zgjeruar detyrën e tij edhe të mbishkrimit e pikturuara, ose të gdhendura në objekte ose në enë të shenjta siç janë ikonostaset, ikonat, amvonat, katedrat, veladonet, enët liturgjike dhe të shënimet e shkruara përkujtimore në skajet e librave liturgjike si lutjet e Ungjillit, librat e predikimit etj.

Në këtë libër lexuesi, historiani, arkeologu, arkitekti, historiani i artit, filologu ose edhe teologu do të gjejë burime për emrat, veprimtaritë dhe jetët e klerikëve dhe laikëve si dhe të mjeshtërive zejtarë si muratorë, guratues, piktorë, gdhendës të drurit, arpunues, argjendarë, punues metalesh edhe të punishteve të tyre, të sponsorizuesve e dhuruesve, për ndikime kulturore, trajta të vjetra gjuhësore, për qarkullimin e pasurive përpos ngjarjeve politike siç janë kryengritjet lokale që nga periudha e hershme bizantine deri në periudhën e vonë otomane.

Në të njëjtën kohë ky libër është edhe një homazh për kujtimin e të ndjerit Theofan Popa i cili nuk arriti të ndjejë kënaqësinë e botimit dhe vlerësimit të veprës së tij madhore sa që gjallë Theofan Popa ka lindur në Elbasan në 1913 dhe ka vdekur në 1985. Ai i përkiste një familjeje të vjetër me emër nga zona më e vjetër e Elbasanit, lagjja Kala. Ai ka studiuar në Seminarin teologjik në Manastir gjatë viteve 1926-1936 dhe ka ndjekur për dy vjet studimet e larta në Athinë po në degën teologjike.

Ai ia kushtoi tërë jetën e tij studimit të kishave, kishëzave e manastireve në Shqipëri të cilat i kishte vizituar personalisht pavarësisht nga vështirësitë e rreziqet e paparashikuara që shpjegohen me kushtet e kohës kur feja dhe institucionet fetare ishin nën goditjen e shtetit. Shumë artikuj të tij janë botuar në shtypin periodik kombëtar e ndërkombëtar (kryesisht "Buletini i Universitetit të Tiranës", seria e shkencave shoqërore, "Studime historike", "Nëndori" etj.) ndërsa përmbledhje të referateve të tij janë botuar në Aktet e kongreseve a simpoziumeve ku ka marrë pjesë. Monografite e studimet e tij më të njohura janë "Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike, Bul. i shk. shoq., 1, 1958; "Piktorët mesjetarë shqiptarë", Tiranë, 1961, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", "Disa konsiderata të përgjithshme rreth pikturës pas-bizantine, "Studime historike", 2, 1967; "Onufri - ikonograf i madh shqiptar", Bul. shk. shoq., 1962; "Ikona e miniatura të mesjetës në Shqipëri", Tiranë, 1974 etj. etj. Në 1957 në konferencën ndërkombëtare që u mbajt në Bullgari mori pjesë me referatin "Divergjencat dhe konvergjenat e artit mesjetar në

Ballkan". Është treguar shumë aktiv në ruajtjen, dokumentimin dhe arkivimin e një numri shumë të madh ikonash në të gjitha kishat e vendit. Është meritë e tij personale që sot e kësaj dite kanë mbetur pa u dëmtuar një pjesë e veprave më të arrira të artit tonë mesjetar. Ai ka qenë gjithashtu ndër ideatorët e nismëtarët e themelimit të Muzeumit të Ikonave në Korçë.

Mbasi Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave vendosën të botonin këtë libër botuesit patën detyrën e vështirë që të interpretonin dhe të përgatishnin për botim një dorëshkrim të shtypur me makinë shkrimi, të dëmtuar e që vetëm pjesërisht mund të lexohej qartë. Kjo vepër (origjinali mungonte) gjendej së bashku me materialin mbështetës në gjendje të çorganizuar, me fotografitë e mbishkrimeve (jo të plota) si dhe me një numër riprodhimesh të tjera në letër kalk (letër-pëlhurë). Në këtë gjendje Theofan Popa transkriptoi mbishkrimet, i përktheu ato në shqip dhe bëri komentin e tyre.

Por disa mostra, sidoqoftë, treguan se edhe kopja që ne patëm në dispozicion nuk ishte as ajo përfundimtarja e as gati për botim derisa me sa duket, autori dëshironte të vazhdonte punën mbi këtë vepër dhe ta sistemonte atë. Në shumë faqe ai kishte bërë ndërhyrje të shumta të shkruara me dorë që nuk janë gjithmonë të kuptueshme. Megjithë ndërhyrjet e tij ai kishte bërë disa gabime në transkriptimin e mbishkrimeve, dhe pikërisht në shenjat e pikësimit duke ngatërruar theksat ose edhe në drejtshkrim (për shembull "ἀρχιερατεύουτος" në vend të "ἀρχιερατεύουτος" të mbishkrimit origjinal, në plotësimin e disa fjalëve për shembull "συμ(βίου)" në vend të trajtës së drejtë "συμβίου", në kthimin e datave nga Anno Mundi në erën e krishtere si dhe në interpretimin e disa shkurtimeve (për shembull ai nuk ka qenë në gjendje të interpretonte "Κ:Α:Μ" si "ΚΑ(ή)μ(ε)υ(ί)ος", kështu që e kishte lënë të pashpjeguar. Disa nga këto gabime ishin çuditërisht të papritura nga një dijetar i kalibrit të tij dhe ato mund të kenë vetëm një shpjegim: duhet supozuar se ai nuk qe në gjendje të bënte ndreqjet e tij përfundimtare duke krahasuar kopjen që na u dha me fotografitë e stampat e tij. Disa përkthime në shqip ishin të gabuara ose jo shumë besnike ndaj origjinalit e, në ndonjë rast kishte përdorur trajta të vjetra gjuhësore që sot nuk kanë kuptim (për shembull ai ka përkthyer në shqip fjalën "κτίτορ" me termin e pakuptueshëm për kohën tonë "ktitor" dhe jo me fjalën e kuptueshme "themelues"). Treguesi i fundit, por më i forti që na detyron të mendojmë se ne nuk kemi patur në dorë tekstin si dhe rishikimet e tij të fundit është pjesa që kishte lidhje me komentet e tij rreth mbishkrimeve ku ai jepte referime duke dhënë vetëm emrin e autorit, një numër që përfaqësonite një artikull a libër specifik të atij autori dhe një numër tjetër që i referohej faqeve të artikullit a librit ku ai bënte komentin (për shembull Pulica P., 48, 53) pa përfshirë një bibliografi me titujt e vendvendosjet e tyre. Duke dashur të bënte krahasime transkriptimeve të tija me variante të propozuara nga autorë të tjerë ai kishte lënë për këtë qëllim zbrazëti të pambushura. Duhet supozuar se ai mendonte t'i mbushte ato në një datë të mëvonshme. Përveç këtyre, Theofan Popa nuk ka përpiluar tregues të sistematizuar mirë për fazat e fundit të përgatitjes për botim. Këto ishin disa nga problemet kryesore që kanë ndeshur botuesit.

Ne u përpoqëm t'i zgjidhim këto probleme duke respektuar mendimin fillestar të autorit. Ne krahasuam transkriptimet e përshkruara të prototipit që kishim në dispozicion me fotografitë e tij dhe, atje ku mungonin fotografitë, me stampat e tij të mbishkrimeve duke bërë të gjitha ndreqjet e domosdoshme dhe atje ku mungonin edhe stampat, duke qendruar sa më afër që të ishte e mundshme ndaj prototipit të Theofan Popës. Kemi ndërhyrë edhe në disa përkthime jo të sakta. U përpoqëm gjithashtu t'i konformoheshim logjikës së qëllimit të tij duke mbushur disa nga zbrazëtitë e lëna prej tij atje ku ishim absolutisht të sigurt e duke lënë të pambushura zbrazëti të tjera ku nuk ishte i qartë qëllimi. Mjerisht, për mungesë kohe dhe të mundësive të kufizuara të punës në biblioteka nuk qamë në gjendje të gjejmë referimet e Theofan Popës me qëllim që t'i krahasonim ato me transkriptimet e tij për të plotësuar pikat që mungonin dhe të krijonim një bibliografi. Për këto arsye komentet në ndonjë rast janë problematike dhe të vështira për t'u përdorur.

Kjo është e meta më serioze e veprës. Mungesa të tjera të këtij botimi janë mungesa e hartave tëpër të veprës se ku janë të vendosur monumentet e referuar) dhe ajo e integritetit sistematik.

Si përfundim, mund të themi se megjithë të metat e lartpërmendura ne jemi të bindur se ofrojmë një veprë me vlerë referimi të sigurt për ndihmesën e saj në studimin e një aspekti të rëndësishëm të historisë dhe kulturës shqiptare.

Së fundi, ne duam të falenderojmë Fondacionin SCORIS për shpenzimet për letër dhe botimin e kësaj vepre, si dhe të gjithë ata që në mënyra të ndryshme kanë ndihmuar për këtë botim.

Redaktorët



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



TREGUESI I EMRAVE TE VENDEVE

A

Albania (Arbëria) Shqipëria, nr.3, 913
 Alvani, Arbëria, nr.2, 90.
 Apollonia, qytet i lashtë pranë Fierit në Shqipëri, nr.89.
 Arbëria, shih Alvan, Raban Albania.
 Arzë, Argo katund në Kolonjë nr.463, 466, në Zagori, nr.626.
 Agrafta krahinë në Akarriani të Greqisë - 326, 408, 400.
 Aidhonohori, katund pranë Serës në Greqi - nr.350, 351, 354.
 Athosi, mal i shenjtë në Greqi - nr.465, 487.

B

Baburi, katund i Filatit të Çamërisë - nr.751
 Badilonjë - 469.
 Berati, qytet - nr.90, 123, 130, 138, 148, 155, 179, 171, 174, 176, 177, 180, 182, 185, 193, 194, 197, 201, 206, 212, 217, 218, 225, 241, 246, 251, 256, 261, 265, 274, 558.
 Bodrista, katund në Dropull - nr.660, 724
 Brezhan, katund i Përmetit - 470
 Brodashë, katund pranë Elbasanit - nr.29
 Buzulima, katund në Myzeqe - nr.115, 123 ose 144, 181, 193.
 Bukureshti, kryeqytet i Rumanisë - nr.767, 863.
 Bullgaria - nr.82
 Buzmadh, katund në Mallakastër - nr.271

Ç

Çatistë, katund në Pogon të Gjirokastrës - nr.761
 Çerembul, katund në periferinë e Sarës, në Maqedoni të Greqisë - nr.101
 Çifliku i madh, katund në Myzeqe - nr.184

D

Dardhë, katund i Korçës - nr. 425, 438, 450, 477, 481.
 Delvinë, qytet i Shqipërisë së Jugut - nr.799, 802, 834, 837, 848, 877, 878, 884, 907.
 Dibra, qytet në Maqedoninë Perëndimore - nr.274
 Dioklea, Mali i Zi - 913
 Drenova, katund i Korçës - nr.364
 Driano, emri i Manastirit mbi Zervat të Dropullit - nr.785, 795, 800

